

BIBLIOTEKA

E

81H-32

F.96

SHTETI

GJIROKAST

BIBLIOTEKA E PIONIER

**Fushata
e shamisë
së kuqe**

891.983-32

BIBLIOTEKA E PIONIERIT

5

F. 96

FUSHATA E SHAMISE SE KUQE

(Tregime)

~~53763~~

845

~~SHKURIM E SHKURIM~~
~~SHKURIM E SHKURIM~~

SHTEPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

NJË COPE MISHI

Tom Kingu kishte mbaruar së ngrëni darkën. Asgjë s'i pat mbetur më në pjatë, po ndjente se kishte ende uri. Të dy fëmijët e tij kishin rënë pa ngrënë. Me gjumë ata harronin urinë. Vetëm ai kishte ngrënë.

U ngrit nga tryeza, u ul në një karrige pranë dritares dhe nxori llullën. Po, kur futi dorën në xhep për duhan, pa se nuk kishte më. U vrëjt dhe e hodhi llullën mënjane.

Tom Kingu ishte një burrë i ngadalshëm dhe i rëndë. Vërtet rrobat i kishte të vjetra dhe të zhubrosura, po fytyra ishte ajo që të tregonte qartë se ç'ishte ai. Ajo ishte fytyra e një boksieri tipik. Grushtet që kishin rënë mbi të, kishin lënë shumë gjurmë, e kishin shtrembëruar dhe shëmtuar. Mund të trembeshe po të takoje një njeri me një fytyrë të tillë në një vend të vetmuar. Po Tom Kingu nuk qe kriminel. Jashtë ringut ai ishte një njeri me një natyrë të mirë, të ngadalshme. Atij nuk i pëlqente të zihej dhe kishte pak armiq. Boksi ishte profesioni i tij. Në ring qëndronte rëndë. Ai qëllonte për ta mundur kundërshtarin, po nuk e urrente. Boksi ishte puna e tij, dhe njerëzia paguante për të parë se si dy burra qëllonin njëri tjetrin. Kush fitonte, merrte të hollat. Kur Tom Kingu pati një ndeshje me Gougerin, e dinte që ai kishte thyer nofullën, katër muaj më parë, në një ndeshje në Niukestëll. Po Tom Kingu ja theu prapë dhe e fitoi ndeshjen. Këtë nuk e bëri sepse Gougeri ishte armiku i tij, po sepse ishte mënyra më e mirë për

të fituar dhe për të marrë të hollat. Edhe pas kësaj Gougeri nuk u bë armik. Kështu ishte lodra dhe që të dy e dinin ta loznin lodrën.

Uria ju ngjall prapë.

— Lizi, — i thirri së shoqes, — a nuk ka ndonjë copë mish për mua?

— U përpoqa të merrja pak, po në asnjë dyqan nuk më dhanë, — tha e shoqja.

— Pse, ç'të thanë?

— Nuk kanë besim që ti të fitosh sonte dhe u kemi mjaft borxh gjer tani.

Tom Kingu nuk u përgjegj. Po mendonte qenin e tij kur ishte i ri, të cilit i jepte copa mishi pa hesap. Atëhere ai mund të merrte mish borxh sa të donte. Po kohët kishin ndërruar. Tom Kingu po plakej dhe pleqtë nuk mund të merrnin gjë borxh ndër dyqane.

— Sa është ora, Lizi? — pyeti.

E shoqja doli nga dhoma për të pyetur fqinjët dhe u kthye prapë.

— Tetë pa një çerek.

— Për pak do të fillojnë ndeshjen e parë, — tha ai. Pastaj do të bëhet një ndeshje me katër raunde në mes Uellsit dhe Griedlleit, dhe një me dhjetë raunde në mes Staralajtit dhe një marinari. Ndeshja ime do të fillojë për ndonjë orë.

Pas dhjetë minutash u ngrit. Mori kapelën dhe u drejtua nga dera. Lizi e përqafoi.

— Paç fatin e mirë, Tom. — tha ajo. — Duhet të fitosh!

Ai, duke shikuar përmbi kokën e saj, i hodhi një vështrim dhomës së zhveshur — ajo për të ishte gjithçka në botë, përveç gruas dhe fëmijëve. Dhe tani ai duhej të shkonte të gjente ushqim për ta.

— Duhet të fitoj! — tha ai. — Do të fitoj, do të marr tridhjetë sterlina, kështu do të paguaj gjithë borxhin. Po të humbas. nuk do të marr gjë, as edhe një grosh për të paguar tramin. Lamtumirë, Lizi, — dhe doli jashtë. Rruga për në klub ishte e gjatë. Duke ecur, mendonte ditët e mira të së kaluarës. Dikur kishte qenë kampion

i Niu Sauth Uellsit. Atëhere shkante në ndeshje me maqinë, të cilën ja paguante ndonjë nga admiruesit e shumë. Tani ishte plak dhe i harruar. Duhej të ecte më këmbë gjer në klub. Dhe një udhë kaq e gjatë nuk ishte e mirë përpara një ndeshjeje të rëndësishme.

Tani kishte të tjerë, të rinj dhe të fortë, që ishin më të mirë se ai. Dikur kishte qenë i ri dhe fitonte me lehtësi. Po të gjitha këto kishin kaluar. Ishte ndeshur shumë herë dhe trupi i tij qe goditur shumë herë.

I kujtohej se si kishte mundur Billin plak shumë kohë më parë. Billi luftoi me shpirt ndër dhembë. Po Billi qe plak dhe humbi. Tom Kingu i ri e kishte nxjerrë nokaut në të tetëmbëdhjetin raund. Kur ndeshja mbaroi, Billi plak kishte qarë si një foshnje në dhomën e veshjes. Ndoshta Billi plak nuk kishte para. Ndoshta atë ditë edhe ai kishte pasur uri dhe kishte dëshëruar vetëm një copë mish.

Tani, pas njëzetë vjetësh, Tom Kingu kuptoi pse kishte qarë Billi plak pas ndeshjes në dhomën ku vishe-shin, dhe se Billi plak kishte humbur më tepër nga ç'kish fituar ai, Tom Kingu.

I kujtoheshin edhe burra të tjerë pleq që i kishte mundur dhe që qanin në dhomën e veshjes, ndërsa ai qeshte.

Tani i erdhi radha atij. Ja ku ishte Sendëlli i ri. Ai kishte ardhur nga Zelanda e Re, pas shumë ndeshjesh. Në Australi nuk e njihte njeri, kështuqë e vunë kundra Tom Kingut. Po të fitonte Sendëlli, atëhere do të ndeshesh me burra të tjerë më të mirë dhe do të fitonte më shumë të holla.

Kur Tom Kingu arriti në klub, një shumicë njerëzish ishte jashtë. Ata i hapën udhën dhe ai dëgjoi që dikush tha:

— Ky është! Ky është Tom Kingu!

Kur po shkante në dhomën e veshjes, takoi një burrë të ri, që i dha dorën.

— Si dukesh, Tom? — e pyeti ai.

— Mirë, — u përgjegj Kingu, megjithëse e dinte se po gënjente.

ndërshtarit. Sendëlli u rrëzua dhe mundi të ngrihej në këmbë vetëm në të nëntën sekondë.

Në raundin e shtatë Sendëlli nuk mundi të sulmonte si më parë. Ishte i lodhur. Ai e dinte se kjo ishte ndeshja më e vështirë e jetës së tij dhe Tom Kingu ishte boksieri më i mirë që kishte parë

Tek po rrinte në këndin e tij duke vështruar kundërshtarin, Kingu mendonte se, po të bashkohej mençuria e tij me rininë e Sendëllit, do të dilte kampioni botëror i peshës së rëndë. Po këtu qëndronte puna, se Sendëlli kurrë nuk do të mund të bëhej kampion botëror. I mungonte mençuria, dhe e vetmja rrugë për ta fituar, ishte ta blinte me rininë e tij, po kur të fitonte mençurinë, rinia do t'i kishte kaluar.

Në raundin e dhjetë, Tom Kingu filloi të sulmojë. Nuk e la Sendëllin të qetë për asnjë çast. Grusht pas grushti, gjersa turma u ngrit në këmbë dhe filloi të thërrasë. Nokauti dukej i sigurtë. Po Sendëlli ishte i ri dhe i fortë. Kur ra gongu, ai qëndronte ende në këmbë. Tani kishte një minutë për t'u çlodhur, këstu do të mund ta merrte veten. Që të dy shkuan në këndet e tyre dhe qëndruan aty duke marrë frymë rëndë. Tom Kingu e pa se kjo minutë ishte pikërisht ajo që i nevojitej Sendëllit. Trupi i Sendëllit ishte i ri dhe çlodhej shpejt. Kur mbaroi minuta, Sendëlli ishte në gjëndje të fillonte prapë luftimin, kurse Tom Kingu ishte i dëshpëruar që arbitri nuk e ndaloi ndeshjen. Ishte shumë i lodhur për shkak të sulmit që kishte bërë. Atij nuk i mjaftonte një minutë për t'u çlodhur. Ai kishte nevojë për më tepër kohë. I ndjente këmbët të rënda. Nuk duhej të kishte ecur ato dy mila. I kujtohej edhe copa e mishit, që e shoqja nuk mundi t'ja gjente.

Një urrejtje e madhe ju ngjall për kasapët, që nuk i kishin dhënë borxh. Ishte gjë e rëndë për një burrë plak të shkonte në ndeshje pa ngrënë aq sa duhej. Copa e mishit ishte një gjë aq e vogël, kushtonte

vetëm ca peni 1), po tani i vllente sa për tridhjetë stër-
lina.

Kur gongu ra për të hapur raundin e njëmbëdhjetë, Sendëlli u hodh në sulm. Ai donte të tregonte se ishte çlodhur. Po Tom Kingu e kuptoi, e kuptoi se ky sulm i ri ishte një manevër, dhe menjëherë kundërsulmoi. E qëllloi njëpasnjë, gjersa Sendëlli ishte gati për të rënë. Po Kingu nuk desh që të binte, se aty, për tokë, do të çlodhej. Ai e shtyu Sendëllin te litarët e anëve, ku të mbështetej për të mos u rrëzuar. Salla u tërbua. Thuajse të gjithë i thërrisnin Tom Kingut:

— Tom, jepi fund!

— Jepi fund!

— E munde, Tom!

— E munde!

Dhe Tom Kingu, që për gjysmë ore i kishte kurr-
syer fuqitë e tij, tani i harxhoi menjëherë. Ishte rasti,
o tani, o kurrë. Ndjeu që forcat po e linin. Vetëm një
shpresë i mbetej, që ta nxirrte Sendëllin shpejt nokaut.

Më në fund i lëshoi dy grushte të fortë, njërin
në kraharor, tjetrin në nofull. Sendëlli ra përtokë dhe
arbitri filloi të numëronte. Tom Kingu nuk mund të
shikonte më. Ai ishte aq i lodhur, sa mezi mbahej në
këmbë, fytyrat përçark i rrotulloheshin. Ishte i sigurtë
që kishte fituar. Po qe gabuar.

Sendëlli ishte i ri, kishte aq fuqi sa të ngrihej në
gjunjë dhe të çlodhej mbi ta. Kur arbitri numëroi se-
kondën e nëntë pranë Kingut, duke e sulmuar nga
afër, që kështu ai mos të mund t'i pëgjigjej, Tomi e
shtyu dhe e sulmoi prapë; e dinte sa shpejt e merrnin
veten të rinjtë, prandaj Sendëlli nuk duhej lënë të
çlodhej.

Një grusht i mirë do ta nxirrte nokaut. Tom
Kingu lëshoi grushtin me tërë fuqinë e tij, po ai nuk
qe as shumë i rëndë as shumë i fortë. Sendëlli u lë-
kund në litarët, po nuk ra. Kingu lëvizi pas tij dhe i
lëshoi edhe një tjetër. Po forcat e kishin lënë tani.
Grushti nuk qëlloi më lart nga supet. Deshi t'i binte

1) Peni — njëqinta pjesë e stërlinës.

më lart, po krahu i tij i lodhur nuk ju bind. Vetë Tom Kingu u lëkund për të rënë. Edhe një herë provoi të qëllojë. Këtë herë, i dobësuar fare, ra kundrejt Sendëllit dhe u përleshën.

Kingu nuk u përpoq të çlirohej. Nuk kishte më fuqi. Kishte mbaruar. Sendëlli po fillonte të çlodhej. Grushti i tij, më parë i dobët, bëhej gjithnjë e më i fortë. Sytë e Tom Kingut panë grushtin e mbuluar me dorezë që po lëvizte drejt nofullës, e kuptoi rrezikun dhe deshi ta mbante me dorë, po ajo ishte shumë e rëndë. Nuk mundi ta ngrerë. Sendëlli qëlloi nofullën, dhe Kingu çdo gjë ju errësua.

Kur hapi sytë, pa se ishte në këndin e tij, ndërsa njerëzit thërrisnin rrotull ringut. Masagjatorët i hodhën ujë të ftohtë në fytyrë. Dorezat ja kishin hequr dhe Sendëlli i shtrëngonte dorën. Pastaj Sendëlli shkoi në mes të ringut dhe të gjithë heshtën që të mund të dëgjonin se ai pranonte ftesën e një boksiери tjetër për një ndeshje të re.

Tërë këto nuk kishin më rëndësi për Tom Kingun, Ai kishte uri. Ju kujtua çasti kur Sendëlli u lëkund dhe qe gati për të rënë.

Ah, sikur të kishte ngrënë një copë mish përpara ndeshjes! Ja se ç'i kishte munguar për të dhënë grushtin vendimtar! Ai kishte humbur për shkak të një copë mishi.

Kur po dilte nga dhoma e veshjes, një burrë i ri i tha:

— Pse nuk e nxore nokaut kur pate mundësinë!

— Ikë, në djall! — tha Tom Kingu dhe zbriti shkallët për në rrugë.

Dyert e kafenesë që ishte në cep të rrugës qenë hapur fare dhe ai mund të shikonte dritat e shkëlqyera dhe të dëgjonte zërat që flisnin për ndeshjen e boksit. S'kishte të holla në xhep dhe ato dy mila që duhej t'i bënte këmbë gjer në shtëpi, i dukeshin shumë të gjata. U ul në një karrige dhe befas u kujtua se e shoqja po e priste. Kjo ishte më e tmerrshme nga çdo nokaut. E

ndjeu veten shumë të dobët. Uria e mori përsëri, po këtë herë më shumë. Atëhere sytë ju mbushën me lot. Vuri duart mbi fytyrë dhe, duke qarë, mendoi Billin plak, që e kishte mundur atë natë, shumë kohë përpara. I shkreti Bill plak! Tani mund ta kuptonte pse kishte qarë Billi në dhomën e veshjes.

RENEGATI

— Xhoni, çohu, po të them, se do të mbetesh pa ngrënë!

Po djali s'deshi t'ja dijë. Atij s'i vinte aspak mirë që të zgjohej.

— Lermë!

Kjo britmë e ngjirur, që lëshoi djali në mes të gjumit, u shua midis një vajtimi, ku fjalët nuk kuptohe-shin më.

Po nëna bënte sikur s'e dëgjonte. Kjo grua me sy të trishtuar dhe me fytyrë të lodhur ishte mësuar me punët që duhej të bënte në mëngjez, sepse këto punë përsëriteshin ditë për ditë në jetën e saj. Ajo u mundua t'ja hiqte batanien po ai u mbështoll fort me të. U mblodh kruspull në shtrat, u mbulua kokë e këmbë dhe s'deshi të ngrihet.

Djali ishte ndanë shtratit dhe dukej sikur do të binte. Po kishte filluar të vinte në vete: drejtoi trupin, duke mbajtur pak a shumë ekuilibrin, pastaj zbriti dhe qëndroi në këmbë. Nëna e zuri atë çast për supi dhe e tundi.

— Mirë, — murmuriti.

Nëna mori llambën dhe doli shpejt, duke e lënë në errësi.

Megjithëse kishte mbetur në terr, veshi pantallonat dhe xhaketën e shkoi në kuzhinë. Kur ecte, ecte rëndë, ndonëse ishte mjaft i dobët nga trupi. Këmbët mezi i

tërhiqte dhe të vinte çudi: pse i hiqte zvarrë, kur i kishte aq të holla? Afroi karrigen te tryeza.

— Xhoni! — e thirri atë çast e ëma.

Ai u ngrit përnjëherësh dhe shkoi pa folur te lavamani, që ishte i fëlliqur dhe si me lyrë: nga vrima vinte një erë e keqe. Atij s'i bëri përshtypje era e qelbur e lavamanit, ashtu siç nuk i bëri përshtypje sapuni që ishte ndotur nga enët dhe që s'lante mirë. Po as që u mundua të lahej shumë, shplau vetëm fytyrën me ujët e ftohtë që binte nga muslluku. Dhëmbët s'i lante. Ai as që kishte parë ndonjëherë furcë dhëmbësh dhe s'dinte të kishte në botë njerëz aq budallenj sa të lanin dhëmbët.

— Si s'kujtohe të lahesh vetë qoftë edhe një herë ditën? — e qërtoi e ëma.

Duke mbajtur me dorë kapakun e thyer të ibrikut, ajo mbushi dy filxhanë me kafe. Xhoni s'ju përgjegj këtij qërtimi, sepse këtu e kishin burimin grindjet e përhershme: nëna ngulte këmbë që ai ta lante fytyrën qoftë edhe vetëm një herë në ditë. Ai u fshi me rizën e ndotur dhe të grisur, që i linte fije në fytyrë.

— Banojmë shumë larg.—tha nëna kur Xhoni u ul në tryezë. — Edhe ti vetë e di se sa përpiqem unë. Po këtu kemi shumë vend dhe paguajmë një dollar me pak. Një dollar për ne është shumë, edhe ti vetë e di.

— Me një dollar mund të blesh shumë ushqime, — tha ai pasi u mendua një copë herë. — Le të jetë ca më larg, veç të hamë më shumë.

Ai i hante shpejt e shpejt copat e bukës, pothuajse pa i përtypur, duke pirë edhe kafënë e nxehtë. Kështu e quanin ata këtë lëng të përvëlur dhe pa shije, po Xhoni ishte i mendimit se kjo kafe ishte shumë e mirë. Ky ishte një nga iluzionet e paka që i kishin mbetur. Kafënë e vërtetë ai s'e kishte vënë kurrë në gojë.

Përveç bukës kishte edhe një copë mish derri të ftohtë. Nëna i mbushi djalit edhe një filxhan tjetër me kafe. Kur e mbaroi bukën, vështroi se mos i jepte edhe një copë tjetër. Nëna kuptoi se ç'kërkonte ai.

— Ti s'ke të ngopur, — i tha ajo. — Thelën tënde e more, po i vogli ç'të hajë?

Xhoni s'foli. Zakonisht ai nuk fliste shumë. Po vështrimi i tij i uritur nuk kërkonte më një thelë tjetër. Djali nuk u ankua dhe kjo bindje ishte po aq e tmerrshme sa edhe shkolla ku e kishte mësuar. Si e piu kafënë, fshiu buzët me dorë dhe u bë gati të ngrihej.

— Dale, — i tha atë çast e ëma, — të të jap edhe një thelë të hollë.

Ajo bëri sikur preu një thelë, kurse, në të vërtetë, mori nga arka një nga dy copat e saj dhe ja dha atij. Duart i kishte shumë të shkathta dhe këtë gjë e bëri shpejt. Ajo pandehi se e gënjeu të birin, po ky e pa se ç'bëri ajo. Megjithatë e mori.

Ai bënte këtë arësyetim të thjeshtë: nëna ishte gjithnjë e sëmurë dhe s'i hahej shumë.

Kur pa se ai përtypte copën e bukës së thatë, nëna zgjati dorën sipër tryezës dhe i hodhi kafe nga filxhani i saj.

— Më vjen për të vjellë kur e pi, — tha ajo.

Sirena që buçiste larg, i detyroi të ngriheshin më këmbë. Nëna vështrroi sahatin që ishte në raft. Ora ishte pesë e gjysmë. Punëtorët e fabrikës posa ishin zgjuar nga gjumi. Ajo hodhi në krah shallin dhe vuri në kokë kapelën e vjetër dhe pa formë.

— Duhet të ecim shpejt, — tha ajo pasi uli fitilin e llambës dhe i fryu flakës.

Dolën jashtë duke ecur si të verbërit dhe zbritën nga shkallët. Në oborr kishte dritë, frynte thëllimi dhe Xhoni u struk nga të ftohtit. Yjet s'kishin filluar ende të veniteshin dhe qyteti ishte mbuluar me mjergull. Xhoni dhe nëna ecnin pa folur dhe mezi i hidhnin këmbët. S'kishin fuqi të ngrinin këpucët nga toka. Pas pesëmbëdhjetë minutash nëna u kthye nga e djathta.

— Shiko mos u vono! — tha ajo kur po ndaheshin dhe u zhduk në errësirë.

Ai s'foli dhe vazhdoi rrugën. Në lagjen e fabrikës kudo hapeshin portat dhe, pas një copë here, Xhoni u fut midis turmës së punëtorëve, që ecnin në errësirë. Kur ishte duke hyrë nga porta e fabrikës, sirena buçiti dhe një herë. Xhoni ktheu kokën nga lindja. Nga vija

e pjerrët e çatisë shkisnin rreze të zbeta. Kaq dritë die-lli i binte atij në pjesë. I ktheu kurrizin kësaj drite dhe hyri në repart bashkë me të tjerët.

U ul në vendin e tij në radhën e gjatë të maqinave. Përpara tij, mbi arkën ku kishte çikrikë të vegjël, vërtiteshin me shpejtësi çikrikë më të mëdhenj. Te ata ai pësthillte perin e çikrikëve të vegjël. S'ishte ndonjë punë e vështirë, po kërkonte shpejtësi të madhe. Peri pësthilltej kaq shpejt në çikrikët e mëdhenj nga çikrikët e vegjël, sa s'kishte kohë të rrije duarlidhur.

Xhoni punonte në mënyrë mekanike Kur zbrazej një nga çikrikët e vegjël, ai ndalte me dorën e majtë çikrikun e madh dhe, atë kohë, me gishtin e madh dhe treguesin kapte anën e perit. Me dorën e djathtë kapte anën e perit të çikrikut tjetër të vogël. Këtë punë e bënte shpejt dhe me saktësi, duke punuar përnjëherësh me të dy duart. Pastaj me një lëvizje shumë të shpejtë Xhoni bënte nyjen dhe lëshonte çikrikun. Ishte gjë e thjeshtë t'i bëje këto nyje. Një ditë ai ishte mburrur e kishte thënë se këto nyje mund t'i bënte edhe në gjumë. Dhe vërtet ashtu ishte: shumë herë Xhoni edhe në ëndërr shihte sikur bënte nyje.

Ndonjë nga djemtë e vegjël shkëputej nga puna, linte të punonte bosh maqinën dhe nuk i zëvendësonte çikrikët e vegjël kur mbaroheshin. Po ustait s'i shpëtonte asgjë. Një ditë ai vuri re se djaloshi që punonte pranë Xhonit, s'e kishte mëndjen aty dhe e tërhoqi për veshi.

— Të punosh si Xhoni, dëgjon? — tha ustai me zëmërim.

Çikrikët e Xhonit vërtiteshin me shpejtësi shumë të madhe, po ai nuk u gëzua nga kjo lëvdatë. As kënaqësia më e vogël nuk shprehej në fytyrën e djalit kur dëgjonte se e lavdëronin dhe e tregonin si shembull. Ai ishte një punëtor shumë i mirë dhe këtë gjë e dinte edhe ai vetë. Shumë herë i kishin thënë se punonte me zell, lëvdatat që dëgjonte, ishin bërë për të një gjë e zakonshme dhe s'kishin asnjë rëndësi. Nga një punëtor shëmbullor u kthye e u bë një maqinë shëmbullore. Në-

qoftëse puna s'i shkonte mirë, fajin s'e kishte as ai dhe as maqina, po materiali i keq. Nuk ishte e mundur që të gabonte, ashtu siç nuk është e mundur të gabojë maqina e përsosur që prodhon gozhda.

Dhe s'ishte për t'u habitur. Gjithë jetën e tij ai kishte patur të bënte me maqina. Mund të themi se ai ishte lidhur me maqinat si mishi me thuan, ishte rritur me to. Dymbëdhjetë vjet më parë në repartin e tirazhit të kësaj fabrike kishte ndodhur një trazirë. Nënës së Xhonit i kishte rënë zali. Atë e kishin shtrirë në dyshe-me, midis maqinave që punonin duke kërcitur. Kishin thirrur dy endës pleq. Këtyre u kishte ndihmuar ustai. Pas disa minutash, në repartin e tirazhit kishte lindur një foshnjë: kjo foshnjë ishte Xhoni. Ai kishte lindur midis zhurmës së maqinave dhe me frymën e parë që kishte marrë, kishte thithur ajrin e ngrohtë, gjithë lagështirë dhe pluhur pambuku. Ai ishte kollur që në orët e para të jetës së tij për ta nxjerrë nga mushkëritë këtë pluhur dhe, po për këtë arsye, kollejt edhe sot e kësaj dite.

Djali i vogël, që punonte pranë Xhonit, ankohej dhe rufiste hundët. Fytyra i shtrembërohej nga urrejtja që kishte për ustanë, i cili herë pas here e vëshronte me zemërim: po çikrik të zbrazët s'kishte. Djali i vogël mallkoi rëndë çikrikët që vërtiteshin para tij, po zëri i tij nuk shkoi larg: atë e mbyti zhurma e maqinave të repartit.

Po Xhoni shikonte punën e tij, atij s'i bëhej vonë për asgjë. Ishte mërzitur me këto gjëra dhe raste të tilla përsëriteshin shpesh. Kot që t'i kundërshtojë ustait, ashtu siç është e kotë t'i kundërshtosh maqinës. Maqinat janë ndërtuar që të punojnë në një mënyrë të caktuar dhe të kryejnë një punë të caktuar. Ashtu edhe ustai.

Mëngjezi i gjatë dhe sidomos dita e gjatë e punës mori fund dhe sirena e fabrikës lajmëroi se turni kishte mbaruar. Ishte ngrysur kur Xhoni doli nga porta e fabrikës. Gjatë kësaj kohe, dielli ishte ngritur nëpër shkallët e arta të qiellit, kishte ngrohur botën me rrezet e tij,

kishte zbritur nga ana e perëndimit dhe pastaj ishte zhdukur përtej vijës së pjerrët të çatisë.

Vetëm në darkë Xhoni mblidhej në shtëpi me motrat dhe vëllezërit e tij më të vegjël. Kjo ishte si një ndeshje e vërtetë, sepse ai ishte shumë plak dhe ata shumë të rinj, aq të rinj, sa i dukej sikur ata e fyenin me rini në e tyre. Ai nuk e kuptonte këtë rini. Vogëlia e tij kishte mbetur shumë pas. Xhoni, si ndonjë plak grindavec, rrinte tërë hundë e buzë përpara këtyre të rinjve çapkënë, që i dukeshin si budallenj. Ai rrinte i zymtë dhe pa folur përpara pjatës, duke ngushëlluar veten me mendimin se edhe ata për së shpejti do të shkonin në punë. Puna do t'i bënte ata, siç e kishte bërë edhe atë vetë, seriozë dhe të fortë. Ashtu si gjithë njerëzit, edhe Xhoni i maste të tjerët me kutin e tij.

Duke ngrënë bukë, nëna tha e përsëriti po ato që kishte thënë sa e sa herë: se lodhej e mundohej shumë... dhe, për këtë arsye, me të mbaruar darkën, Xhoni ndjeu sikur ishte lehtësuar nga një barrë e rëndë, largoi karrigen dhe u ngrit. U mendua një copë herë, se s'dinte ç'të bënte: të shtrihej për të fjetur apo të dilte në rrugë dhe, më në fund, vendosi të dilte. Po nuk shkoi larg: u ul në krye të shkallëve, kërrusi shpatullat e ngushta, mbështeti brrylat te gjunjët dhe vuri mjekrën në pëllëmbët e duarve.

Rrinte ashtu pa menduar asgjë. Çlodhej. Ndërgjegjja e tij po dremiste. Vëllezërit dhe motrat e tij dolën vrap nga shtëpia dhe zunë të loznin e të bënin zhurmë me fëmijët e tjerë. Feneri i udhës lëshonte dritë sipër fëmijëve që loznin. Ata e dinin fare mirë se Xhoni rrinte përherë gjithë inat dhe sikur i shtynte njeri që ta ngacmonin. U kapën dorë më dorë dhe, duke mbajtur tempon me këmbë, kënduan përpara tij ca këngë pa kuptim. Në fillim Xhoni shtrëngoi dhëmbët dhe i shau ashtu siç shante mjeshtri, po kur pa se një gjë e tillë ishte e kotë, mbylli gojën dhe ndenji i zymtë.

Vëllai dhjetëvjeçar, Villi, që vinte pas Xhonit, ishte një djalë i gjallë. Xhoni nuk e donte shumë të vë-

llanë; ai kishte qenë shumë i detyruar që në vogëli që t'ja bënte qejfin, që të sakrifikohej për të. Xhonit i qe mbushur mendja se vëllai i vogël i detyrohej shumë, po ky nuk e ndjente veten mirënjohës kundrejt tij. Në ato kohëra të largëta, kur Xhoni mund të lozte vetë, nevoja për t'u kujdesur për Villin i kishte rrëmbyer një pjesë të madhe të kohës së bukur të vogëlisë së tij. Villi atëhere ishte foshnjë dhe nëna, si edhe tani, gjithë ditën e ditës punonte në fabrikë. Xhoni kujdesej për të edhe si baba, edhe si nënë.

Villi, me sa dukej, kishte përfituar nga kujdeset dhe sakrificat e vëllait të madh. Ai kishte një trup të gjatë sa Xhoni, bile edhe më i mbushur. Gjithë gjaku i njerit sikur derdhej në dejt e tjetrit. Xhoni dukej i rraskapitur, apatik, i fishkur, kurse i vëllai ishte plot gjallëri e jetë.

Fëmijët këndonin këngën e tyre të mërzitshme me një zë gjithnjë më të lartë. Villi, duke kërcyer, u afrua më shumë se të tjerët dhe nxori gjuhën. Befas Xhoni e kapi me dorën e majtë të vëllanë për zverku dhe me grushtin e dorës së djathtë e goditi në hundë. Grushti i Xhonit ishte i fortë dhe Villi bërtiti fort. Fëmijët e trembur ulërinë dhe Xheni, motra e Xhonit dhe e Villit, u fut brenda në shtëpi.

Atë çast erdhi nëna e shqetësuar dhe e inatosur.

— Pse më bie në qafë? — u pergjegj Xhoni kur e shau e ëma. — A s'e sheh se jam i lodhur?

— Unë jam i madh sa ti! — bërtiti Villi në krahët e nënës. — Unë jam i madh sa ti dhe për së shpeji do të rritem edhe më shumë dhe atëhere e sheh se ç'të bëj!

— Pse s'punon kur qenke rritur sa unë? — tha Xhoni duke shtrënguar dhëmbët. — E di ç'ke ti? Për-vishju punës. Le të të dërgojë nëna në fabrikë.

— Është i vogël ende, — kundërshtoi ajo.

— Unë isha më i vogël kur fillova.

Xhoni deshi të vazhdonte për të shfryrë zemërimin e tij, po papritmas ndërroi mendje. Ktheu kurrizin gjithë inat dhe hyri brenda. Dera e dhomës së tij ishte e hapët që të futej atje të ngrohtit e kuzhinës. Kur po

zhvishej në gjysmë errësirën e dhomës, dëgjoi të jëmën që bisedonte me fqinjën. Nëna qante dhe fjalët e saj dëgjoheshin midis ngashërimeve.

— S'kuptohet se ç'ka pësuar Xhoni, — tha ajo. — S'e kam parë kurrë kështu. Ishte i urtë e i bindur si ndonjë qengj, po edhe tani është i mirë, — tha që të mos i vinte faj të birit. — Në punë vete gjithnjë, punën e ka filluar që i vogël. Po se mos e kam fajin unë? A nuk përpqem edhe unë?

Dhe qau me ngashërim. Xhoni murmurti duke mbylluar sytë:

— Mirë thua, në punë vete gjithmonë.

Të nesërmen, nëna e zgjoi përsëri. Dhe përsëri ai mëngjezi i varfër që hëngri, rruga e gjatë në errësirë dhe pastaj drita e zbetë e mëngjezit, së cilës i ktheu kurrizin duke hyrë nga porta e fabrikës. Kaloi edhe një ditë tjetër si shumë ditë të tjera.

Po edhe në jetën e Xhonit ndodhnin gjëra të ndryshme: kur e vinin në një punë tjetër ose kur sëmurej. Kur ishte gjashtë vjeç, kujdesej për Villin dhe për fëmijët e tjerë. Kur u bë shtatë vjeç, shkoi për të punuar në një vend tjetër. Puna e re ishte shumë e lehtë: mjaftonte të rrije me shkop në dorë dhe të drejtoje rripin e pëlurës, që të kalonte përpara. Kjo pëlhurë derdhej si një përrua nga nofullat e maqinës, vinte në një cilindër dhe pastaj shkonte më tutje. Xhoni s'lëvizte nga vendi, rrinte aty nën dritën verbuese të fenerit, pa parë dritën e diellit, kështuqë edhe ai ishte bërë një pjesë e maqinës.

Në këtë punë Xhoni e ndjente veten të gëzuar, megjithëse në repart bënte vapë dhe ajri ish plot lagështirë, se atëhere Xhoni ishte i ri ende dhe mund të ëndërronte dhe ta ngushëllonte veten me iluzione. Ai thurte ëndërra të bukura duke parë pëlhurën që kalonte pa u ndalur përpara tij. Po kjo punë nuk kërkonte asnjë lëvizje, asnjë përpjekje, kështuqë ai zuri të ëndërrojë më pak dhe mendja e tij sikur u mpi. Megjithatë fitonte dy dollarë në javë dhe dy dollarë përbënin ndryshimin midis urisë dhe ushqimit të pakët.

Po, kur u bë nëntë vjeç, e humbi këtë punë. Fajin e pat fruthi. Kur u shërua, hyri në fabrikën e xhamave. Këtu paguanin më shumë dhe puna kërkonte zotësi. Punonin me copë dhe, sa më shumë të punonte, aq më i madh ishte edhe fitimi. Këtu e vllente barra qeranë të punoje dhe Xhoni punoi e u bë një punëtor i dalluar.

Puna nuk ishte e vështirë: tapat prej xhami duheshin lidhur te shishet e vogla. Xhoni mbante në brez një tufë me spango dhe shishet i shtrëngonte midis gju-njëve, që të mund të punonte me të dy duart. Duke ndenjtur kështu dhjetë orë me radhë, i dilte kurrizi dhe i futej kraharori. Kjo ishte shumë e dëmshme për mushkëritë, po ai lidhte me spango treqind duzina shishe në ditë.

Drejtori mburrej që kishte një punëtor të tillë, dhe sillte pranë tij vizitorët që ta shikonin. Brenda dhjetë orëve, nga duart e Xhonit kalonin treqind duzina shishe. Domethënë se ai kishte arritur të punonte sa një maqinë e përsosur. Nuk bënte asnjë lëvizje të kotë! Çdo lëvizje e duarve të tij të dobëta, çdo lëvizje e gishtrinjve të tij të hollë ishte e shpejtë dhe e përpiktë. Një punë e tillë kërkonte një vëmendje të madhe dhe nervat e Xhonit kishin filluar të dobësoheshin. Natën ai dridhej në gjumë dhe ditën nuk ishte e mundur të çlodhej. Fytyra e tij kishte marrë një ngjyrë balte dhe kolla i qe shtuar. Ai erdhi e u dobësua shumë dhe, më në fund, u sëmur nga mushkëritë dhe humbi punën në fabrikën e xhamave.

Dhe ja ku u kthye prapë në fabrikën e tisazhit, ku kishte filluar nga puna për herë të parë. Këtu priste që t'i jepnin një punë më të mirë. Ai ishte punëtor i zellshëm. Me kohë do ta transferonin në raportin e kollit dhe pastaj në atë të endjes. Pastaj s'mbetej gjë tjetër, veçse të shtonte prodhimin e tij.

Maqinat punonin tani shumë më shpejt dhe mendja e Xhonit më ngadalë. Tani ai nuk ëndërronte më si përpara.

Xhoni ishte rritur shumë shpejt. Ai kishte ndjerë se ishte rritur atë ditë që i kishin dhënë mëditjen e pa-

rë, kur ishte shtatë vjeç. Filloi ta ndjente veten të pavarur dhe sjellja e tij kundrejt s'ëmës u ndryshua. Meqenëse punonte dhe ushqente familjen, kishte fituar po ato të drejta që kishte edhe e ëma. Ai e ndjeu veten të rritur në kuptimin e plotë të fjalës kur u bë njëmbëdhjetë vjeç, pasi kishte punuar gjashtë muaj në turnin e natës. Asnjë fëmijë nuk mund të punojë në turnin e natës dhe të mbetet fëmijë.

Në jetën e tij kishte disa ngjarje me rëndësi. Një ditë, nëna kishte blerë ca kumbulla Kalifornie. Ajo kishte bërë dy herë reçel. Po kjo ishte ngjarje me rëndësi në jetën e tyre. Atij i kujtohej me mall ajo ditë. Atëhere nëna kishte folur për një gjellë të çuditshme — ajo e quante këtë gjellë «ishulli që ludron» — dhe i kishte thënë se një ditë do t'ja gatuate. «Kjo gjellë është shumë më e mirë se reçeli me kumbulla», — kishte thënë nëna. Xhoni e kishte pritur vite me radhë këtë ditë kur do të ulej në tryezë dhe do të hante «ishullin që lundron», gjersa dhe kjo shpresë u shua, ashtu siç ishin shuar gjithë të tjerat.

Një ditë, ai gjeti në rrugë një monedhë njëzet e pesë sencash. Edhe kjo kishte qenë një ngjarje me rëndësi, bile edhe tragjike në jetën e tij. Ai dinte se si të vepronte para se ta merrte monedhën. Në shtëpi, siç ndodhte gjithmonë, s'kishte asgjë për të ngrënë; ai duhej ta shpinte në shtëpi këtë monedhë, ashtu siç shpinte mëditjet që merrte të shtunave. Ai e dinte fare mirë se ç'duhej të bënte, po ja që s'i mbeteshin kurrë të holla për të prishur për qejfin e tij; e kishte marrë malli të hante ca karamete, që i vinte në gojë vetëm ditët e shënuara.

Nuk u mundua ta gënjente veten. Ai e dinte se bënte një faj të rëndë kur prishi për qejfin e tij pesëmbëdhjetë senca. Dhjetë sencat e tjerë i hoqi mënjanë për t'i prishur një herë tjetër, po, meqë s'ishte mësuar të ruante të holla, i humbi.

Xhoni e sillte gjithmonë ndërmend këtë ngjarje, që i dukej si i vetmi faj i rëndë që kishte bërë dhe, sa herë që e kujtonte, e vriste ndërgjegjja. Kjo ishte mëkata e

tij, e fshehta e tij. Përveç kësaj, i vinte edhe keq, i vinte keq që i kishte humbur këto të holla. Do të kishte qenë më mirë sikur të njëzet e pesë sencat'i kishte prishur menjëherë. Në përfytyrimin e tij këto të holla ai kishte prishur njëmijë herë dhe, sa herë që i prishte, dilte më i fituar.

Kujtimet e hershme ruheshin ende në mendjen e tij, po ato të mëvonshmet ishin fshirë. Të gjitha ditët i ngjisnin njëra tjetrës. Dita e djeshme ose viti i kaluar ishin sa njëmijë vjet ose sa një minutë. Kurrë s'ndodhte ndonjë gjë. Nuk kishte asnjë ngjarje që të caktonte kalimin e kohës. Koha nuk shkonte, po qëndronte në vend. Lëviznin vetëm maqinat e potershme, po edhe ato nuk shkonin asgjekundi, ndonëse lëvizja e tyre bëhej gjithnjë më e shpejtë.

Kur u bë katërmbëdhjetë vjeç, hyri në repartin e kollit.

Kjo ishte një ngjarje me rëndësi. Ndodhi më në fund diçka që do të mbetej një kohë më të gjatë në kujtesën e tij, se sa ngjarja e asaj dite kur kishte marrë mëditjen e parë. Kishte filluar një epokë e re. Kjo ishte për Xhonin si një olimpiadë, si fillim i një epoke të re. «Kur fillova të punoj në repartin e kollit», ose «gjer atëhere», ose «pasi kalova në repartin e kollit» — ja, me këto fjalë fillonte ai pothuajse çdo frazë.

Kur u bë gjashtëmbëdhjetë vjeç, Xhoni kaloi në maqinën endëse. Edhe këtu e vlente barra qeranë që të punoje, sepse paguanin me copë. Edhe këtu ai u dallua, sepse fabrika e kishte shndërruar me kohë në një maqinë ideale. Pas tre muajsh, ai punonte në dy maquina. pastaj në tri dhe në katër.

Kishte dy vjet që kishte kaluar në këtë repart dhe nxirrte nga duart e tij më shumë jardë pëlhurë, se sa çdo endës tjetër, dhe dy herë më tepër se shumë nga shokët e tij më pak të shkathët se ai. Rendimenti i tij pothuajse kishte arritur kulmin dhe familja e tij tani jetonte më mirë. Po nuk mund të thuhet se paga e tij u bënte ballë kërkesave të familjes. Fëmijët po rriteshin. Ata hanin më shumë, shkonin në shkollë dhe lib-

rat kushtonin shtrenjtë. Dhe, për çudi, sa më shpejt që punonte Xhoni, aq më shpejt ngriheshin çmimet. U ngrit edhe qeraja e shtëpisë, megjithëse kjo sa vinte po shkatërrohej më tepër.

Xhoni zgjatej, kështuqë dukej edhe më thatanik. Ai bëhej gjithnjë më tepër nervoz, i zyrtë dhe zemërohej për gjënë më të vogël. Përvoja e hidhur i kishte mësuar fëmijët që të mos i afroheshin vëllait të madh. Nëna e respektonte, sepse ai mbante shtëpinë, po edhe ja kishte frikën.

Xhoni s'kishte gëzime në jetë. Ditën punonte në fabrikë dhe s'shihte dritën e diellit. Natën e kalonte me një gjumë të shqetësuar. Ishte bërë si në maqinë. Tani vetëm një iluzion i kishte mbetur: se do të pinte një kafe shumë të mirë. Ai ishte si një kafshë pune, që nuk di se ç'është jeta shpirtërore. Po diku, atje thellë në ndërgjegjen e tij, pa e kuptuar as edhe vetë, shënohej çdo orë pune, çdo lëvizje dore, çdo tkurrje muskuli dhe të gjitha këto përgatitnin zgjidhjen e dramës, që do ta habiste si atë vetë, ashtu edhe botën e tij të vogël.

Një ditë, më të hyrë të verës, Xhoni u kthye nga puna më i lodhur se ditët e tjera. U ulën në tryezë dhe ai filloi të hante pa folur dhe i zyrtë, duke fshirë shpejt e shpejt ç'gjente përpara. Fëmijët bërtisnin duke ngrënë dhe përplasin buzët. Po ai as që i dëgjonte.

— A e di se ç'je duke ngrënë? — pyeti më në fund nëna.

Ai vështroi pjatën pa e patur mendjen aty dhe pastaj nënën.

— «Ishullin që lundron», — tha ajo me një ton madhështor.

— A - a, — tha Xhoni.

— «Ishullin që lundron»! — bërtitën fëmijët.

— A - a, — përsëriti ai dhe, pasi hëngri dy a tri lugë, shtoi: — Sot s'kam edhe aq uri. — La lugën, shtyu karrigen dhe u ngrit i lodhur. — Po shtrihem pak.

Duke kaluar nga kuzhina, Xhoni mezi i tërhiqte këmbët. Aq shumë ishte lodhur, sa s'kishte fuqi të zhvi-shej, u shtri në shtrat pa hequr këpucët. Mesi i dhimbe

shumë, i dhimbnin të gjitha kockat, gjithë trupi. Në trutë e tij filluan goditjet, fërshëllimat dhe buçimat e miliona maqinave endëse. Hapësira ishte mbushur me sovajka, që lëviznin pareshtur. Xhoni punonte në mijëra maqina dhe ato lëviznin gjithnjë më shpejt, më shpejt dhe truri i tij shpëstillej gjithnjë më shpejt, më shpejt dhe shndërrohej në pe, të cilin e tërhiqnin me mijëra sovajka.

Të nesërmen nuk shkoi në punë. Ai ishte shumë i zënë me ato mijëra maqina endëse, që buçisnin në koken e tij. Para se të nisej për në fabrikë, nëna dërgoi e thirri doktorin. Ky tha se ishte një formë e rëndë gripi. Xhoni u kujdesua për të vëllanë dhe i bëri ato që kishte thënë mjeku.

Sëmundja që e rëndë dhe vetëm në krye të javës Xhoni mundi të vishej dhe të shkonte me mundim poshtë e lart nëpër dhomë. Duhej të kalonte edhe një javë që të shkonte në punë, kishte thënë mjeku.

Në oborr ishte ngrohtë dhe, pas buke, doli për të ndenjur në krye të shkallëve. Nganjëherë i lëviznin buzët. Të dukej sikur ishte zhytur në disa llogari të pambaruara.

Të nesërmen, kur zuri e u ngroh koha, ai doli e u ul përsëri në krye të shkallëve. Në duar kishte një kalem dhe një fije letër dhe bënte ca hesape me vëmendje të madhe.

— Ç'vjen pas milionave? — pyeti Xhoni në drekë, kur u kthye Villi nga shkolla. — Dhe si i numërojnë?

Në mbrëmje llogaritë muarën fund. Çdo ditë, Xhoni dilte në krye të shkallëve pa kalem dhe pa letër. Ai s'i hiqte sytë nga pema që ishte nga ana tjetër e rrugës. Rrinte dhe e shikonte me orë atë pemë, ajo tërhiqte vëmendjen e tij sidomos atëhere kur era i tundte degët dhe gjethet e saj. Gjithë asaj jave Xhoni sikur bënte një bisedim të gjatë me vetëveten. Të dielën, kur po rrinte në krye të shkallëve, qeshi disa herë me zë të lartë dhe nëna u shqetësua, sepse kishte shumë vjet që s'e kishte dëgjuar të qeshurit e tij.

Të nesërmen në mëngjez, para se të gdhihej, ajo ju

afrua shtratit që ta zgjonte. Gjatë javës ai kishte patur kohë të ngopej me gjumë dhe u zgjua pa mundim. Nuk kundërshoi, nuk u mbulua kokë e këmbë me batanien, siç mbulohej më parë, po rrinte shtrirë i qetë dhe i tha nënës ngadalë:

— Mos u mundo, nënë.

— Do të bëhesh vonë, — tha ajo, duke kujtuar se s'i kishte dalë gjumi.

— Nuk fle, nënë, po sidoqoftë mos u mundo. Shko më mirë, se nuk ngrihem.

— Kërkon të humbasësh punën? — tha ajo.

— Të thashë që s'ngrihem, — përsëriti ai ftohtë.

Atë ditë as nëna nuk shkoi në punë. Kjo sëmundje ishte më e rëndë se të gjitha ato që kishte njohur ajo. Ethet dhe kllapia ishin një gjë e zakonshme. Ajo e mbuloi djalin me batanie dhe dërgoi Xhenin për të marrë doktorin.

Kur erdhi ky, Xhoni flinte i qetë, u zgjua gjithash-tu i qetë dhe zgjati dorën që t'ja prekte pulsën.

— Asgjë me rëndësi, — tha doktorin, — vetëm se është lodhur shumë. Ka mbetur kockë e lëkurë.

— Kështu ka qenë gjithnjë, — tha nëna.

— Shko tani nënë, lemë të fle.

Xhoni i tha këto fjalë me një zë të qetë, pastaj u kthye nga ana tjetër dhe fjeti.

Më ora dhjetë u zgjua, u ngrit dhe shkoi në kuzhinë. Nëna e vështroi me frikë.

— Po shkoj, moj nënë, — tha ai. — Po të le shëndë.

Ajo mbuloi fytyrën me përparëse, u ul në karrige dhe zuri të qajë. Xhoni priti me durim.

— Sikur ta dija, — tha ajo me lot në sy. — Ku do të shkosh? — dhe, duke zbuluar fytyrën, e vështroi Xhonin me ata sytë e saj plot habi, ku nuk shprehej as kureshtja.

— S'e di... Kudo që të jetë.

Përpara syve të mendjes së Xhonit u çfaq vegimi i shkëlqyer i pemës që ishte nga ana tjetër e rrugës.

Ajo kishte lënë një gjurmë kaq të thellë në ndërgjegjen e tij, sa ai e shikonte orë e çast.

— Po puna? — tha nëna me zë të dredhur.

— Nuk do të punoj më.

— Xhoni! — thirri ajo. — Ç'thua kështu?

Kjo i dukej si një faj shumë i rëndë. Fjalët e Xhoni e tronditën nënën aq shumë, sa ç'mund të tronditet çdo nënë kur dëgjon se i biri kërkon të largohet nga shtëpia.

— Ç'pate? — pyeti ajo, duke u munduar që të dukej e repte.

— Shifrat, — u përgjeggj ai. — Shifrat dhe asgjë tjetër. Gjatë kësaj jave bëra llogari dhe u habita edhe vetë.

— S'kuptoje se në ç'punë hyjnë shifrat këtu, — tha ajo.

Xhoni bëri buzën në gaz dhe nëna e vështroi si me frikë: ku ishte zhdukur vallë zemërimi i tij?

— Po ta shpjegoj tani, — tha ai. — Jam rraskapitur. Po pse? Nga lëvizjet. Këto lëvizje i kam bërë që ditën që kam lindur. Mjaft kam lëvizur. A të kujtohet kur punoja në uzinën e xhameve? Lidhja treqind dyzhina shishe në ditë. Për çdo shishe bëja të pakën dhjetë lëvizje. Domethënë tridhjetë e gjashtëmijë lëvizje në ditë. Në dhjetë ditë treqind e gjashtëdhjetëmijë. Në një muaj një milion e tetëdhjetëmijë. Le të heqim të tetëdhjetë mijat, — tha ai me dashamirësinë e një filantropi bujar, — le të heqim të tetëdhjetë mijat, prapëseprapë na mbeten një milion në muaj, dymbëdhjetë milion në vit!

— Në maqinën endëse unë bëj lëvizje dy herë më tepër, domethënë njëzet e pesë milionë në vit dhe më duket sikur këto lëvizje i bëj prej miliona vjetësh. Këtë javë unë s'bëra asnjë lëvizje, asnjë lëvizje në ditë. Sa mirë që ishte të rrije pa bërë gjë! Unë s'kam qenë kurrë i lumtur, s'kam patur kurrë kohë të lirë. Gjithë kohën kam bërë lëvizje. E ç'gëzim mund të kisha? Tani s'do të bëj asgjë. Do të rri të çlodhem e të kënaqem.

— Po Villi dhe fëmijët, ç'të bëhen? — pyeti ajo me dëshpërim.

—Po, vërtet, Villi dhe fëmijët.. — përsëriti ai.

Po zëri i tij nuk dridhej nga hidhërimi. Ai e dinte me kohë se çfarë ëndërra të bukura thurte nëna për djalin e dytë, po s'i erdhi rëndë. Tani s'donte t'ja dinte për asgjë. As edhe për këtë. — Unë e di, moj nënë, se ç'ke menduar ti për Villin: ke menduar të mbarojë shkollën dhe të bëhet llogaritar. Mjaft kam punuar unë, tani le të punojë edhe ai.

— Po unë të kam rritur, — tha ajo duke qarë dhe ngriti prapë përparësen, po s'e shpuri gjer te fytyra.

— Unë u rrita vetë, moj nënë, unë e rrita edhe atë. Villi është më i fortë se unë, më i mbushur dhe ma kalon nga shtati. Unë s'e kam ngopur barkun me bukë kur isha i vogël, kam punuar edhe për të. Po tani kjo gjë ka marrë fund. Le të punojë vetë tani Villi, ashtu siç kam punuar unë. Jam i lodhur. Po shkoj... Po si, s'po më thua udhë e mbarë?

Nëna s'foli, mbuloi përsëri fytyrën me përparëse dhe zuri të qajë. Xhoni qëndroi një copë herë te dera.

—Unë jam munduar gjithë jetën, — tha nëna duke qarë me ngashërim.

Xhoni doli nga shtëpia dhe shkoi udhës. Një buzëqeshje e lehtë ndriti në fytyrën e tij kur vështroi pëmën matanë rrugës.

— Tani s'do të bëj asgjë, — tha me vete me zë të ulët. Pastaj vështroi si i menduar qiellin dhe kapsalliti sytë nga drita verbuese e diellit.

Kishte një rrugë të gjatë për të bërë, po ecte pa u ngutur. Ja fabrika e tisazhit. Dëgjoi gumëzhitjen shurdhuese të repartit të endjes dhe bëri buzën në gaz.

Sa më larg që shkonte, aq më të rralla bëheshin shtëpitë dhe fabrikat, aq më shumë shtriheshin hapësirat e fushave të gjera. Më në fund qyteti mbeti nga pas dhe Xhoni doli në një rrugë plot hije, që shkonte gjatë vijës hekurudhore. Ai nuk ecte si njeri dhe as që i ngjante njeriut. Ai ishte parodia e njeriut — një qenje e rraskapitur, e dobët, që ecte duke çaluar, me krahë të varur, i kërrusur, si një majmun i sëmurë.

Kaloi stacionin e vogël dhe u shtri mbi bar në hijen

e një peme. Gjithë ditën e ditës qëndroi kështu i shtrirë. Nganjëherë e kapiste gjumi dhe muskujt i lëviznin në gjumë. Kur zgjohej, rrinte përsëri shtrirë pa lëvizur, vështronte zogjtë ose qiellin përmes degëve që i vareshin sipër kokës. Dy herë qeshi me zë të lartë, kushedi për ç'arësye.

Kur u ngrys e u bë natë, një tren mallrash erdhi duke buçitur në stacion. Në kohën që lokomotiva shpinte një pjesë të vagonave në linjën rezervë, Xhoni i hipi trenit. Hapi derën e një vagoni të zbrazët dhe mezi u fut atje. Pastaj e mbylli. Lokomotiva vërshëlleu. Xhoni u shtri në errësirë.

NËNË E BIJË

Në agun e thellë, qielli ishte ende i zi pisë. Në skelën Huang-kia, në bregun perëndimor të lumit Huang-pu, një grua ndonja njëzet vjeçe zbriti me të shpejtë nga lundra. Kishte një pako të vogël, dhe fytyra e saj e bukur dukej e shqetësuar. Kush të ishte vallë?

Li San - meja. Ajo vinte nga fshati i saj, që ndodhej në bregun lindor të Huang - pusë. Huang Çuen - - paoja, i shoqi, punonte në një uzinë të Shangait. Ai s'ishte bërë i gjallë qysh prej vizitës së tij të fundit në shtëpi, aty e dy muaj më parë. Në fshat kishin ndodhur përmbytje katastrofike, dhe çifligari i kërkonte San - - mejës qëranë e tokës dhe borxhet. Ajo vendosi të shkojë te i shoqi.

Kur arriti San-meja në uzinë, turni i natës kishte ikur, po ajo pa një burrë që po ecte drejt saj. Vrapoi menjëherë te ai që ta pyeste për Çuen-paon, dhe burri ju përgjegj se ai kishte vdekur një javë më parë. Ky lajm i ra si një bombë dhe ndjeu se po i merreshin mentë. Po, duke e mposhtur dhëmbjen, e mblodhi veten dhe pyeti me ankth:

— Si ndodhi?

Burri u përgjegj pa i dhënë rëndësi:

— Një aksident në punë. Kjo ndodh shpesh në uzinë.

San-meja ja plasi vajit. Ajo tha se donte të vinte te padroni e t'i kërkonte llogari. Burri e kuptoi menjëherë se ajo do të ishte e shoqja e të vdekurit. Vështroi rreth e rrotull me kujdes dhe pa se ishin vetëm. Një

mendim i beftë i shkrepri në kokë. Me zë të ëmbël dhe plot përzemërsi i tha:

— Padroni ynë nuk banon këtu. Po ju çoj unë te ai.

E shpuri në një oborr të madh, të rrethuar me mure të larta. Dy roje ruanin te porta. Burri hyri bashkë me San-mejën. Kur arritën përpara shtëpisë së ndërtuar në një stil të huaj, ai qëndroi dhe ju lut të priste: do t'i bënë të zë padronit të vinte të takohej me të. Pas pak doli një grua e shkuar, nja pesëdhjetë vjeçe, që, me sa dukej, do të ishte shërbyese. Ishte veshur me një setër mavi prej pambuku dhe me pantallona të zeza. Kishte lidhur në bel një përparëse të bardhë.

— Motër, është vonë. Hyrë brenda të hash diçka, — i tha ajo San-mejës.

— Faleminderit, teto Ahma, po pres këtu një njeri.

— Cilin?

— Padronin.

— Vërtet? Ç'e deshe?.. Motër, më thuaj shpejt nga vjen dhe si arrite këtu!

Si ja tregoi të gjitha San-meja, gruaja thirri e trembur:

— Obobo, moj motër... ti... ti paske rënë në një kurth! Ai burri që të solli këtu, është një kryepunëtor i fabrikës, ai maskara është një tregëtar sklleverish. Ai të ka shitur këtu!

— Teto Ahma! Unë... dua të dal që këtej!

— Ah, moj e shkretë! Për të hyrë, hyre, po për të dalë s'del dot nga kjo shtëpi! Nuk i sheh ato dy roje? Edhe krahë për të fluturuar sikur të kishe, nuk do të mund të shpëtoje dot. E vetmja gjë që të mbetet është të tregohesh e bindur tani për tani, pastajshohim e bëjmë.

Gjendja ishte e dëshpëruar. San-meja s'mund të bënte asgjë tjetër, veçse të ndiqte këshillën që i jepej.

Çfarë njeriu ishte i zoti i shtëpisë? Një komprador i përmundur, që punonte për një firmë të huaj në Shangai. Në marrëveshje të fshehtë me reaksionarët e Gomindanit, ai pinte gjakun e popullit kinez në fitim të padronit të tij të huaj. San-mejën e bleu njëra nga gratë

e tij të shumta, e teta. Rregullorja e shtëpisë ishte shumë e rreptë, dhe asnjë shërbëtor s'kishte të drejtë të dilte pa treguar një pllakëz prej bakri, që i ishte dhënë; po skllaveve nuk u jepeshin të tilla pllakëza; ato ishin, pra, edhe më poshtë se shërbëtorët. Me një fjalë, kur ato kapërcenin për herën e parë prakun e portës së oborrit, hynin në një burg përjetë.

Kur u largua San-meja nga fshati, ishte shtatzënë. Ditët kalonin dhe ajo e ndjente veten përherë e më të rëndë dhe s'ishte në gjendje të kryente punët e vështira dhe të panumërta që i ngarkoheshin. Megjithatë, i duhej të vazhdonte, se s'bënte dot ndryshe.

Një ditë mori urdhër të pastronte dyshtemenë në dhomën e së zonjës. Si e lau dhe e fërkoji me tel, e leu me dyllë, pastaj e bëri të shkëlqente si pasqyrë duke e fërkuar fort me një copë të leshtë. Tani ishte në muajin e nëntë të barrës dhe s'e përballonte dot punën. Pas një copë here, u detyrua të pushonte e të shtrinte këmbët që të çlodhej. Pikërisht në çastin kur do të ngrihej, ja behu zonja, duke ecur rëndë-rëndë, me ato këpucët me taka të larta, që i kërcisnin mbi dyshtemenë. Kur e pa San-mejën ashtu të shtrirë, i ra disa herë me këmbë mu në bark. Gruan e re e zunë dhëmbjet. Duke luftuar me sa i që e mundur, ajo u përpoq të përvishte pantallonat dhe të vazhdonte punën. Kur mbaroi nga puna, e pa që nuk do t'i duronte dot më tutje dhëmbjet, zbriti shkallët me të shpejtë dhe i ra të fikët.

Teto Ahma kishte dëgjuar një klithmë dhe ishte sulur menjëherë. Aty, përtokë, dergjeshin nëna dhe fëmija: një vajzë!

Gjellbërësja plakë e vuri sakaq San-mejën në shtrat, pastaj shkoi të kërkonte disa rroba të vjetra, që i rregulloi aty për aty; më në fund ja solli fëmijën s'ëmës të larë mirë e bukur e të mbështjellë. Në mjekrën e foshnjes San-meja pa një nishan, pikërisht si atë që kishte pasur Çuen-paoja. Gruaja e re u ngushëllua e sikur mori zemër: «Jeta ime ka qenë e hidhur, po tani kam një fëmijë, që më mbush me shpresë. E ardhmja ndoshta do të jetë e tmerrshme, po unë do ta rris këtë

vogëlushe.» Ajo ja vuri emrin Siao-pao, në kujtim të të shoqit.

Një ditë, si mbaroi punët e rënda të mëngjezit, San-meja shkoi në dhomën e vet t'i jepte gji foshnjës së saj. Po nuk e gjeti atje. Kërkoi nëpër tërë shtëpinë, po më kot. Befas erdhi teto Ahma dhe e pyeti:

— Ku e ke Siao-paon?

— Nuk e di. Atë po kërkoj dhe unë!

— Obobo! Unë po vij nga jashtë dhe pashë shërbëtorët e zonjës që po rendnin drejt jetimores me një foshnje të mbështjellë me batanie. Sigurisht, Siao-paoja do të ishte!

Gruaja plakë mori pllakëzën e saj të bakërt dhe e futi në duart e San-mejës.

— Dil shpejt dhe shko nga lindja! Pas tri blloqesh ktheu nga e majta. Do të shohësh dy kodra në të dy anët e një shtëpie: ajo është jetimorja. Kur i lënë njerëzia foshnjët e tyre, i futin në disa arkëza në hyrjen e ndëtesës. Aty nga dreka, njerëzit e jetimores vinë e i marrin. Po arrite vonë, s'ke për të mundur kurrë ta gjesh fëmijën tënde. Tani është dymbëdhjetë pa njëzet, ikë shpejt!

Si e prishur nga mentë, San-meja u vërsul jashtë, kapërceu portën e shtëpisë dhe vrapoi gjatë rrugës. Ashtu siç i kishte thënë gjellëbërësja, ajo ktheu nga e majta dhe pa dy kodrat. Në dyqanet, gjatë rrugës, sahatët binin dymbëdhjetë. San-mejës sikur i ra një thikë në zemër. Kërceu drejt jetimores, zuri të shikonte arkëzat, po s'po e gjente të bijën. Me gjak të ngrirë po kërkonte gjithnjë. Më në fund pa një foshnjë të mavijosur nga të ftohtët, me një nishan në mjekër. Siao-paoja, s'kish asnjë dyshim! Duke shkopsitur setrën e vet, San-meja e shtrëngoi fëmijën në gji. Befas kuptoi se ishte i vetmi rast për të ikur. Po ajo dinte gjithashtu se ikja e saj do t'i sillte shumë andralla teto Ahmës. Po rrinte ashtu, e kredhur në mendime, duke mos ditur si të bënte, kur dy duar e kapën nga supet. Ajo ktheu kokën. Dy shërbëtorë të zonjës! Pa i thënë asnjë fjalë, ata e kthyen në shtëpi.

Disa muaj më parë, edhe zonja kishte lindur një vajzë, që ja kishte vënë emrin Li-li e që e përkëdhelte në një mënyrë fare të tepëruar dhe egoiste. Foshnja ishte ushqyer nga më shumë se një dyzinë tajash, po prapë kishte mbetur e dobët sa më s'bëhej. Kur zonja pa Siao-paon aq të mbushur e faqebuqë, falë cilësisë së qumështit të s'ëmës, ajo vendosi ta hiqte qafe, me qëllim që San-meja të mund të mëndte Li-linë. Prandaj kishte urdhëruar dy shërbëtorët e vet ta marrnin tinës e ta çonin në jetimore. As që i kishte shkuar ndërmend se vogëlushja mund të shpëtonte ashtu sikundër shpëtoi.

Po kjo punë nuk mori fund me kaq. Ajo shtrigë përdori një taktikë tjetër. I tha San-mejës me të egër:

— Ti do ta lësh foshnjën tënde poshtë dhe nuk do të shkosh ta shohësh pa lejën time.

* * *

San-meja e gjeti një herë zonjën e saj mizore në gjumë. Duke përfiturar nga rasti, ajo u sul në heshtje te e bija. Shtyu derën. Ah! Sia-paoja po tundte këmbët duke u dredhur, sytë i kishte të zgurdulluar, gojën të hapur krejt dhe fytyrën të mavijosur. Foshnjës i dilte gjak nga goja. E lebetitur vrapoi në kuzhinë duke thirrur:

— Teto Ahma, eja! Siao-paoja po përpëlitet!

Gjellëbërësja vuri dorën në ballin e foshnjes. S'kish-te ethe. Këto nuk ishin të dredhura e përpëlitje ethesh. Duke e shpënë foshnjen në dritë, ajo i vështroi grykën dhe vuri re diçka të bardhë. Ç'të ishte kjo? Me kujdes të madh futi dy grishtrinjtë në gojën e vogëlushes dhe nxori që andej një shami të vogël duarsh tërë gjak. S'mbetej asnjë dyshim. Kishin dashur ta mbysnin atë foshnje!

Siao-paoja shpëtoi mirë e bukur edhe kësaj here nga zgjuarësia dhe shkathtësia e teto Ahmës.

— Kush mund ta ketë bërë këtë! Ç'mizori! — thirri San-meja.

Me mendje të prishur vrapoi në dhomën e zonjës dhe bërtiti, duke zgjatur shaminë tërë gjak:

— Si s'të vret pak ndërgjegjja? Li-lija jote jeton me qumështin tim dhe ti kërkon të mbysësh time bijë? Ajo është jeta ime, ajo është gjithçka për mua! Pa atë, unë s'mund të rroj!

Duke folur kështu, San-meja ju hodh gruas në grykë. E tmerruar, kjo thirri për ndihmë, dhe dy shërbëtore erdhën dhe e shkëputën nga duart e San-mejës.

Zonja do të kishte dhënë urdhër ta rrihnin skllaven e saj. Po ajo u mendua. Nëqoftëse e rrihte, San-mejës mund t'i ikte qumështi dhe vajza e vet, Li-lija e saj e shtrenjtë dhe e përkëdhelur, do të vuante. Se, ç'është e vërteta, që kur kishte filluar t'i jepte gjii San-meja, Li-lija e kishte marrë mirë veten. Nga ana tjetër, foshnja kërkonte gjithë ditën që ta mbante taja në duar. Po t'i ndodhte gjë kësaj të fundit, si do t'i vinte filli Lilisë? E mblodhi, pra, se e vetmja gjë që i mbetej të bënte ishte ta mbante hëpërhë zemërimin e saj. Ishte e kredhur pikërisht në këto mendime, kur teto Ahma hyri dhe e mori San-mejën me vete jashtë dhomës.

Paskësaj San-meja e mbylli gjithnjë me çelës dhomën ku ishte e bija, dhe vetëm teto Ahma, që i jepte ushqim, kishte të drejtë të hynte brenda. Falë këtyre masave, Siao-paoja mundi të arrinte moshën tri vjeç, pa i ndodhur ndonjë dramë tjetër.

Një ditë, ajo doli vetë nga dhoma për t'u endur nëpër shtëpi. Arriti gjer te shkallët dhe qëlloi që zonjusha Li-li të ndodhej pikërisht atje, duke ngrënë një pastë. Kur kjo pa Siao-paon, e shtyu tutje. Po Siao-paoja, që ishte më e fortë, s'e la hakën pa marrë, i dha një të shtyrë, saqë zonjusha Li-li u rrukullis tatëpjetë shkallëve. Ajo zuri të ulërinte.

Kur dëgjoi britmat, San-meja vrapoi menjëherë dhe, kur pa ç'kishte bërë Siao-paoja, mënt i ngriu zemra nga frika, Zonja ishte në dhomën e saj duke rregulluar thonjtë me një palë gërshërë të vogla... Një minutë më vonë, gruaja ja behu aty. Kur pa vajzën e saj të përkëdhelur tek ulërinte me sy të zgurdulluar, ja vërviti gër-

shërët Siao-paos në fytyrë. San-meja u përpoq ta mbro-
nte të bijën, po ishte tepër vonë, gërshërët i ranë mu në
faqe dhe gjaku i rrodhi çurk. Zonja u dha menjëherë
urdhër shërbëtorëve të vet t'i mbyllnin nënë e bijë në
një kaush, ndërsa ajo vetë u sul në spital me Li-linë.

Teto Ahma i mori vesh të gjitha, kur u kthye nga
jashtë. Ajo e kuptoi menjëherë se ishte keq puna, sepse
Li-lija ishte e rritur tani dhe s'kishte më nevojë për
qumështin e San-mejës; kjo e fundit, duke mos qenë
më e domosdoshme, mund ta pësonte në ç'do çast. Ishte
e sigurtë që zonja nuk do t'ja falte kurrë rrëzimin e Li-
-lisë. Mbyllja në kaush ishte vetëm fillimi. Ishte në rre-
zik vetë jeta e nënës dhe fëmijës. Teto Ahma e ndjen-
te veten shumë të shqetësuar e të tronditur.

Atë mbrëmje, duke u kthyer nga spitali, zonja
shkoi në një dasmë në Hotel - Internacional. Të dy
rojet, te porta, e dinin se në këto raste ajo kthehej vonë
e se mund të përfitonin për t'u çlodhur e për t'u kënaqur.
Blenë verë dhe mish dhe erdhën e ja shtruan në kuzhinë.

Duke dashur ta shfrytëzonte rastin, teto Ahma bëri
çmos për të shtënë në dorë çelsin e qelisë, ku ishin
mbyllur San-meja dhe Siao-paoja. Hapi derën e kau-
shit dhe pëshpëriti:

— Eja pas meje! Shpejt!

— Ç'ke ndërmend të bësh?

— Pusho dhe eja pas meje! Shpejt!

San-meja doli me të bijën në krah dhe teto Ahma
e shoqëroi gjer jashtë në rrugë. Atje, ajo i tha:

— Dhe tani ikë!

— Po ti, teto Ahma? Po të zhdukemi ne, faji do të
hjerë mbi ty dhe mund ta pësosh keq.

Këto fjalë e bënë teto Ahmën të mendohej.

— Ke të drejtë, — tha më në fund. — Po qëndrova
këtu, e di që do ta paguaj me kokë. Prandaj më mirë
po ikim së bashku, pa le të dalë ku të dalë!

San-meja u prek shumë nga sjellja e plakës zemër-
mirë. Vendosën të lypnin e të shkonin në Nankin, qyteti
ku kishte lindur teto Ahma.

Kur arritën në Hsia-kuan, stacioni i Nankinit, rru-

gët ishin plot me njerëz të tronditur shumë: sapo kishin marrë vesh se ushtria japoneze po i afrohej qytetit. Befas u dëgjua një buri. Dy kamionë bosh po vinin nga lindja. Pa pyetur fare, shumë nga refugjatët i rrethuan dhe zunë t'i hipnin brenda. Hipi edhe teto Ahma dhe thirri:

— San-mej, nëma foshnjen dhe eja!

San-meja ja zgjati Siao-paon teto Ahmës. Në mes të rrëmujës e të të shtyrave, njëra nga këpucët e vogla të Siao-paos ra. Nëna u përkul ta merrte. Në çastin kur po matej të hipte në kamion, ja behu një grup dezertorësh të Gomindanit dhe zuri të grabiste turmën. Në atë panik e pështjellim që u krijua, San-mejën e shtynë tutje. Tek përpiquej të kthehej prapë te kamioni, ky i fundit u nis. Ajo e futi këpucën e vogël në xhep dhe vrapoi me të gjitha forcat e saj për të arritur kamionin, i cili po shtonte shpejtësinë përherë e më shumë. Mundimi i vajti kot. Tani që humbi Siao-paon, i dukej sikur i kishin shkukur zemrën. Po ç'do të fitonte po të qante e të vajtonte? E vetmja gjë që i mbetej të bënte ishte të përpiquej të gjente fëmijën dhe teto Ahmën.

Më 1949, si një diell pranveror arriti çlirimi. Për San-mejën fillonte një jetë e re dhe e ndjeu veten se po përtërihej.

Në kohën e krijimit të kooperativave, në fshatin e San-mejës entuziazmi për ta shtuar prodhimin u rrit edhe më shumë. Në valën e punës, sidomos në stinën e të mbjellave, s'pushonin as ditë as natë. Atëhere shtëpia e San-mejës shndërrohej përkohësisht në çerdhe. Shumë fëmijë që vinin të luanin në shtëpinë e saj gjatë dites, rrinin aty për të fjetur dhe shtatë-tetë vogëlushë binin kështu në të njëjtin shtrat. Së shpejti shtuan edhe një shtrat tjetër. San-meja i mbulonte fëmijët me bataniet që i kishin dhënë gjatë reformës agrare, kur ishin ndarë pasuritë e çifligarëve. Edhe të sajta të kishin qenë këta fëmijë, ajo s'do të kishte si t'i trajtonte më mirë. Po ata i kujtonin gjithashtu të kaluarën, Siao-paon, që kishte vuajtur nga mungesa e ushqimit sa kohë që ishte në barkun e s'ëmës dhe që, edhe si lindi, kishte hequr aq të këqija. Ku ndodhej vallë tani?

Në vjeshtën e vitit 1956, San-meja mori një letër nga Federata e Grave, që e ftonte të mernte pjesë në një konferencë të përfaqësuesve të Grave të Kiangusë, krahinës së saj.

— Cila është qendra e krahinës? — pyeti San-meja.

— Nankini.

— Nankini? — San-meja mbajti frymën pezull dhe mendoi: «Atje ku Siao-paoja m'u shkëput nga duart!»

Asaj nate, ajo u kthye e u vërtit sa andej këtej në shtrat, pa mundur të mbyllte sy. Të nesërmen në mëngjes herët, ajo nxitoi të shkonte në qendrën e rrethit dhe, që aty, vajti në Shangai për të marrë trenin e Nankinit. Para se të nisej, ajo futi në xhep këpucën e vogël të Siao-paos. Nuk e harronte kurrë.

Ditën e tretë të konferencës, përfaqësueset e grave muarën fjalën. Që nga tribuna, San-meja tregoi historinë e vet, dhe çdo fjalë e saj ishte një akuzë kundër shoqërisë së vjetër, kundër kapitalistëve, kundër ci-fligarëve. Kur arriti në ngjarjen e Hsia-kuanit ku ajo kishte humbur të bijën, zëri ju drodh nga mallëngjimi i thellë. Befas nxori këpucën e vogël nga xhepi dhe tha:

— Ja këpuca e sime bije. E kam ruajtur me kujdes gjatë këtyre nëntëmbëdhjetë vjetëve. Nëntëmbëdhjetë vjet me radhë i kam thirrur shpesh «Siao-pao», po kurrë s'më është përgjegjur «Nënë!»

San-meja heshti. Nuk ishte në gjendje të vazhonte.

— Nënë! — thirri një zë, për çudi të të gjithëve.

San-meja ktheu kokën dhe pa një vajzë të re me dy gërsheta të gjatë, me një fytyrë të rrumbullaktë, që vetëtimte nga lotët. Kishte një nishan të bukur në mjekër. San-meja u sul menjëherë. Largësia midis tyre që e shkurtër, se edhe vajza po rendte në drejtim të saj. San-meja dalloi qartë mbresën e plagës në faqen e së bijës: vajza e re mbante në dorë një këpucë të vogël, të ngjashme me atë që shtrëngonte San-meja.

— Oh, Siao... Siao-pao!

— Oh, Nënë... Nënë!

Ranë në krahët e njëra tjetrës, me fytyrën të mbytur nga lotët, lot dhembjeje dhe gëzimi përzier.

— Bija ime!

Në shtratin e vdekjes, teto Ahma i kishte dhënë këpucën e vogël vajzës së re dhe i kishte thënë:

— Siao-pao... e dashura ime Siao-pao. Jot ëmë ka hequr shumë. Kur të rritesh, ti duhet të bësh çmos që ta gjesh. Jeta juaj ka qenë e hidhur, duhet të luftoni të dyja së bashku.

San-meja i lëmoi flokët me përkëdhelje dhe i tha:

— Siao-pao! Partia dhe kryetari Mao na çliruan nga e kaluara e hidhur. Ti duhet të ndjekësh udhëzimet e partisë dhe të kryetarit Mao dhe të jesh një vazhduese e zjarritë e kauzën revolucionare!

— Nënë, betohem se do të dëgjoj gjithnjë partinë dhe kryetarin Mao. Do të eci gjithnjë në drejtimin e treguar nga partia dhe do të jem një vazhduese e vendosur revolucionare.

PIONIERI TI

Ti është një fshatar i vogël që jeton në një krahinë të Vietnamit të Veriut. Prindërit, vëllezërit dhe motrat i kanë vdekur nga uria që në vitin 1945. Djalë i vogël e ka marrë për të rritur xhaxhai, i cili punon si lundërtar në lumë.

Ti i urren kolonizatorët francezë, të cilët i kanë sulmuar atdheun.

Pionieri Ti e di se në ç'mënyrë mizore sillen pushuesit kundrejt vietnamezëve. Në fshatin e afërt armiku futi një ditë shtatëdhjetë e tre veta brenda në një gropë të madhe, që ishte e rrethuar me shkarpa, i lagën shkarpat me benzinë dhe i vunë zjarrin. Ishte një pamje e tmerrshme. Po francezët e bënë një gjë të tillë, që t'u kallnin tmerrin banorëve të fshatit, që këta të shihnin se me sa vuajtje vdisnin bashkëfshatarët e tyre. Atë që nuk shkonte në vendin e zjarrit, e rrihnin me egërsi..

Një ditë, Ti dhe djemtë e xhaxhait të tij, Igo dhe Tin, ishin duke ruajtur arën e misrit. Tini u fut në ujë dhe filloi të lante këmbët. Po, në këtë çast, nga ana tjetër e lumit u dëgjua një pushkë. Tini u plagos dhe ra përdhe. Atë e kishte qëlluar me pushkë një ushtar francez, i cili kërkonte të zbavitej duke vrarë një djalë të pambrojtur...

Tani Ti jo vetëm e urrente armikun, po vendosi të hakmerrej, të hakmerrej pa mëshirë. Djali i vogël filloi ta ndihmonte xhaxhanë të shpinte luftëtarët e

ushtrisë popullore nga ana tjetër e lumit me lundrën e tij; xhaxhai kryente detyrën që i kishte ngarkuar Komiteti i rezistencës së fshatit.

Armiku e dinte se fshatarët i ndihmonin partizanët dhe rrethoi fshatin e tyre, Banorët e fshatit mezi arritën të fshiheshin në një gufë mali. Atëhere francezët ndezën zjarr te gryka e gufës: nuk ua mbante të hynin brenda.

Fshatarët që ishin në gufë po i mbyste tymi, jeta e tyre ishte në rrezik. Ti ishte brenda në gufë, edhe ai vuante nga tymi, që i kishte zënë frymën: sytë i lëshonin lot. I dukej sikur s'kishte as durim dhe as fuqi për të duruar më gjatë... Po ja, i erdhi pranë një grua që mbante një kalama në duar. Fëmija qante e bërtiste.

— Mos ka ndonjë vend nga ku mund të dilet nga kjo gufë? — pyeti ajo. — Ti je një djalë guximtar dhe i shkathët. Kërko!

Dhe Ti shkoi e kërkoi. Ai u suall poshtë e përpjetë nëpër ato shtigje të ngushta dhe të errëta të gufës së malit dhe u pengua, u rrëzua, pastaj u ngrit e shkoi përpara. Sipër kokës i fluturonin lakuriqët e natës. Kur djali i vogël ishte lodhur dhe rraskapitur fare, përpara tij u duk një rrip i hollë drite, që mezi dukej në errësirë. Ti e gjeti të çarën e vogël që të shpinte te lumi. Dhe, kur u ngrys dhe ra nata e ngrohtë tropikale, njerëzit e gufës dolën jashtë njëri pas tjetrit.

... Ushtria Popullore e Vietnamit ishte hedhur në sulm. Lufta bëhej pranë fshatit ku jetonte Ti... Dëgjoheshin plumbat e mitralozit. Shtëpitë lëkundeshin nga bombat që pëlcisnin. Fshatarët gëzoheshin se ushtarët e tyre po afroheshin!

Pushtuesi, duke hedhur forca të reja në betejë, hapi pranë fshatit një shteg për të kaluar. Dy varka të mëdha dhe dy rimorkio i transportuan ushtarët dhe rezervat e municionit.

Në këtë kohë e sipër Tiun e thirrën në Komitetin e rezistencës. Partizanët tani e njihnin se Ti ishte një djalë i vendosur dhe guximtar, ndonëse ishte i vogël në moshë. Pionierit i ngarkuan si detyrë të shikonte me vërejtje shtegun e armikut.

— Ti ke për detyrë jo vetëm që të përgjigjesh se nga dhe ku drejtohet armiku, po nuk duhet të harrosh se ne kemi shumë nevojë për varka dhe rimorkio, — i tha në pionierit Ti. — Shiko se mos t'i marrin!

— Do të bëj çdo gjë që duhet bërë, — u përgjegj thjesht, po në një mënyrë të vendosur, Ti.

Ishte dimër. Ti kaloi matanë lumit natën, ju afua armikut dhe mori informata të rëndësishme. Nganjëherë djali i vogël i afrohej varkës, prekte zinxhirët e rëndë. Sa donte ai që t'i mbytte këto varka! Po varkat u duheshin partizanëve. Pionieri Ti solli ndërmend fjalët që i kishin thënë, dhe priti rastin e volitshëm.

Dhe ky çast erdhi.

Natën e Vitit të Ri, ushtarët që ruanin shtegun, shkuan në kamp. Andej vinin zëra të dehurish. Ti e dëgjonte fare mirë këtë gjë, sepse ishte ulur në breg, «mu në hundën e armikut».

Një të kërcyer brënda në ujë pa zhurmë, nja dy pash me not, edhe një... edhe një... Më shpejt, më shpejt! Se ndryshe do të jetë vonë!... Dhe ja, Ti hidhet në bregun e partizanëve. Raporton shkurt se si ishte gjen-dja. Tre burra hipin në varkë e bashkë me ta Ti dhe Igo

Në mes të errësirës, nën shiun e furishëm që ishte duke rënë, partizanët kalojnë lumin dhe fshihen në drizat. Tiun e dërgojnë për informata. Dhe prapë djali i vogël raporton se të gjitha janë në rregull.

Partizanët i zgjidhin varkat dhe rimorkiot...

— Harruam varkën tonë, — tha Ti papritur dhe pakujtuar, kur po lundronin në lumë. — Nuk duhet t'ja lëmë armikut.

Në ujë, bashkë me Ti, u hodh edhe Igo...

Ata shkuan me not edhe një herë pranë armikut, i arritën të tyre dhe e lidhën varkën prapa flotiljes. Kishin me të vërtetë një flotilje të tërë: dhjetë varka dhe dy rimorkio.

Të pesë trimat lundrojnë natën nëpër lumë! Era e ftohtë u rreh fytyrën, ua mpin duart. Po ata kanë dëshirë të këndojnë, se kryen një detyrë të madhe.

Të nesërmen, aeroplanët e armikut erdhën një kohë

të gjatë rrotull në qiell, sipër lumit. Po varkat nuk i panë. Ushtarët francezë, që po tërhiqeshin, u grumbulluan te shtegu i kalimit. Partizanët përfituan nga hutimi i tyre dhe u dhanë goditje të forta. Shumë pushtues gjatën varrin në bregun e lumit, atje thellë në ujë.

Ti mori hakun ndaj armikut shumë herë. Në kraharorin e pionierit trim shkëlqen urdhëri «Për merita lufte».

KARROCËZAT E VOGLA QË KUSHTOJNË NGA PESË SOLDA

Gjatë mbrëmjeve, kur rrugët e qytetit mbushen me njerëz, në një kënd, pranë magazinës së madhe, vinte një grua me një fëmijë.

Gruaja mbulohej mirë me çarçaf dhe linte hapur vetëm sytë.

Pasi ulej këmbëkryq, nxirrte lodrat prej thesit. Ato s'ishin gjë tjetër veçse disa karrocëza të vogla me katër rrota dhe me një kafaz përsipër, të punuar me katër copa dërrasash dhe me një karton të rrumbullaktë, që i mbulonte nga lart. Kur fëmijët e vegjël e nisin këtë karrocëzë të vogël, kafazi sipër rrotullohet dhe rrotullohet shpejt...

Kur gruaja i nxirrte karrocëzat nga thesi, fëmija merrte një nga ato dhe ecte me të nëpër trotuar, sa para prapa, duke thirrur me një zë të hollë:

— Karroca të mira, nga pesë solda! Karroca!..Pesë solda!...

Gruaja me çarçaf të zi dhe fëmija rrinin aty në rrugë deri vonë dhe nuk largoheshin pa u boshatisur rrugët.

Fëmija ishte plot tetë vjeç, po, kur e shikoje për herë të parë, nuk i jepje as gjashtë, pasi ishte trup-shkurtër dhe i dobët.

Aty afër, në trotuarin e fëlliqur me baltë dhe me letra, ku qëndronin tregëtarët e karrocëzave të vogla,

shndrisnin vitrinat e një magazine të madhe veshmbathjeje.

Ato ishin të mbushura me kravata gjithfarësh dhe gjithfarë ngjyrash, që të binin në sy, me rripa të mrekullueshëm, me triko, dorëza dhe lodra të ndryshme; me një fjalë, me sende të nevojshme dhe të panevojshme për njeriun, që tërhiqnin menjëherë vëmendjen e udhëtarëve.

Kur shikonin vitrinat e magazinës, njerëzit që kalonin, as që e shkonin mendjen për karrocëzat prej druri.

Po shitësi i vogël vazhdonte të thërriste:

— Karroca të mira, nga pesë solda!.. Nga pesë solda!.. Urdhëroni myshteri!

* * *

Përpara magazinës u ndal një automobil. Prej tij zbriti një grua e trashë, e veshur shumë bukur, me një fëmijë nja tetë e nëntë vjeç, me beretë të bardhë dhe me pallto ngjyrë qielli të mbyllur.

Ata u futën në magazinë.

Mbas pak, djali doli në rrugë dhe filloi të shikojë vitrinën me lodra. Në këtë kohë u dëgjua zëri i shitësit të vogël:

— Karroca nga pesë solda!..

Djali me pallto ngjyrë qielli të mbyllur ktheu kokën, pa shitësin e vogël dhe u drejtua me vrap te ai.

— Ej!... Këtu i shet karrocën?!

Shitësi i vogël u kthye nga ai.

— Nëna nuk mund të vijë vetëm këtu..., pastaj ajo nuk ka fuqi të thërresë... prandaj vij edhe unë...

Djali me pallto ngjyrë qielli futi dorën në xhep, nxori një kaush të mbushur me rrush të thatë, mbushi gojën e vet dhe i dha një kokërr edhe shitësit të vogël të karrocave.

— Po mësimet, kur i mëson? — e pyeti shitësin e vogël.

— Kur kthehem nga shkolla... mësoj nja dy orë. Pastaj

vijmë këtu. Ti e di që në mbrëmje unë nuk mund të mësoj, sepse nuk kemi para për të blerë vajguri.

— A e pe mësuesin tonë? Ai sapo kaloi këtej!...

— Ai e di që unë shes karroca.

Në rrugë u duk një grua me disa fëmijë. Shitësi i vogël e preu bisedën dhe nisi të thërresë:

— Karroca të mira, nga pesë solda!

Po ata nuk blenë gjë. E ëma e shitësit të vogël u mërzit shumë nga kjo.

— A e mësove arithmetikën? — e pyeti përsëri djali me pallto ngjyrë qielli. — Unë sot në shtëpi u mundova shumë! .. Po e lashë që të pyes babanë në mbrëmje!

— E pse ta pyesësh?.. A e di sa e lehtë është!..

— dhe shitësi i vogël e harroi mallin e vet.

Atëhere djali me pallto ngjyrë qielli e kapi për dore dhe i foli me gëzim:

—A e di ç'bëjmë?.. Unë po i them mësuesit të na ulë të dyve në një bankë. Dhe kështu të mësojmë bashkë.

— Po... po ai që rri me mua në një bankë, nuk ngrihet nga vendi. Pastaj edhe nuk dua. Ne banojmë bashkë në një lagje me të, pastaj ai është i varfër, kështu si unë...

«Do të mendojë se unë e përzura dhe se në vend të tij ula një të pasur», — deshi të thotë shitësi i vogël, po u pendua.

Në atë minutë, nga magazina doli ajo gruaja e ve-shur bukur dhe hodhi shikimin përreth. Duart i kishte të mbushura me pako. Shoferi vrapoi te ajo, ja mori dhe i futi në veturë.

Gruaja shikoi përsëri andej e këndeje. Po, kur pa se i biri po qëndronte afër shitësit të vogël, fytyra ju nxi dhe u drejtua me hapa të shpejta drejt tyre. Kur vuri re të jëmën, pasaniku i vogël u shtang.

Edhe nëna e shitësit të vogël ngriti kryet. Kur shikoi atë grua me peliçe dhe me këpuçë të bukura se si po ecte u tmerrua. Zonja ju afrua të birit dhe e kapi për dore.

— Ç'është kjo? — uluriu ajo. — Me cilin flet? — Dhe menjëherë i ra me çadër mu në sup shitësit të vogël... — Brekëgrisor! Pse, shok me birin tim je ti, mor këmbë-zbathur?!

Sytë e shitësit të vogël filluan të rrjedhin lot nga dhembja. Nëna e tij u shtang pranë murit.

— Nënë! Unë e kam shok shkollë! — ndërhyri i biri... — po e ëma, e nxirë në fytyrë, e tërhoqi duke e mbajtur për dore.

— Mos ki merak, se ja tregoj unë qejfin!.. Nesër do të telefonoj në shkollë! T'ua mbledh mirë atyre që pranojnë të këtyllë brekëgrisor për të mësuar!

Dhe, duke tërhequr të birin për dore, ajo u fut në veturë.

Kurse shitësi i vogël vazhdoi përsëri të thërresë me zë të hollë dhe me lot të hidhur në sy:

—... Nga pesë solda! Karroca të miral!..

NUK HARROJMË

Lu, i biri i Lu Bensonit, hyri në oborrin e fermës duke fërshëlyyer dhe duke kënduar: «Penë e libra lam-tumirë, se tani unë jam i lirë. Jam i lirë, jam i lirë!» Shkonte duke hapur këmbët, sikur pantollonat t'i rrinin ngushtë. Iva vinte pas tij, duke zvarrisur në pluhur çantën e saj të zbrazët.

— Po, i lirë! — tha Lu Bensoni, që ndreqte plugun e vjetër. — Je i lirë të punosh, mor bir. Je i lirë t'i përvishesh punës që në moshë të njomë; shpejt ke për të parë se ke lindur nën zgjedhë. — I ra plugut me forcë me çelsin e dadove.

Iva u ul mbi bar e zemëruar si një kllaçkë.

Bensoni e vështroi. Me gishtin e madh ngriti mjekrën e vajzës. Sytë e saj ishin gjithë lot, buzët i dridheshin.

— Tani, baba, s'do të kem më asnjë libër!

— Libër, libër! — tha Lu. — Gjithë udhës ka qarë për këto përralla. Shkolla u mbyll, kështuqë ajo s'ka ç'të këndojë tani! Unë i them: e ç'na duhen neve bujqve gjithë këto libra? Neve na duhet vetëm katalogu Sirz-Robek. Kurse Iva...

— Mirë, mbylle gojën, — tha Bensoni dhe, duke u kthyer nga Iva, i tha me përkëdheli: — Libra të gjej unë, moj zonjushe, aq libra, sa të mos dish se cilin të këndosh më parë.

Iva shtrëngoi fort qafën e tij të trashë dhe të dërsirë dhe shkoi shpejt në dhomën ku ishte vendosur tani

zyra e Bashkimit të bujqve. Ajo e fshehu çantën e shkollës në sirtarin që ishte çaktuar për të në tryezën e shkrimit, dhe u ul në karrige; duke qëndruar atje, ajo shpeshherë lozte me veten e saj: i mblidhte flokët nga pas topuz, vinte në hundë karficën e kokës në vend të syzave dhe bënte sikur ishte mësuese. Tani ajo do të kishte libra për gjithë verën. Dhe në vjeshtë mësuesja do të thoshte në shkollë, përpara gjithë klasës: «Të lumtë, moj Iva Benson, sa mirë që paske mësuar të lexosh!»

Kur u mbyll shkolla, Lu mori përsipër gjithë punët e fermës, kurse babai u muar me punën organizative të Bashkimit të fermerëve. Bensoni kalonte gjithë ditën me fermerët dhe natën, me t'u kthyer në shtëpi, shkruante një kohë të gjatë në maqinë, pastaj shtrihej për të bërë një sy gjumë në shtratin që ishte brenda në zyrë, pastaj dilte prapë nga shtëpia me të kënduar këndeizat.

Iva priste më kot librat që do t'i sillte i ati. Ajo ju ankua s'ëmës. Tereza i tha:

— Ka një javë që as unë s'kam folur siç duhet me babanë.

Lu erdhi nga ara në shtëpi, se e kishte marrë etja dhe i tha së motrës:

— Megjithëse babanë e kanë nxjerrë nga burgu prapëseprapë ai nuk është i lirë. Nuk e kupton këtë gjë? Ai është rekrutues kryesor i punëtorëve në Bashkimin e fermerëve dhe s'ka nge të të gjejë libra ty!

Iva shkoi në zyrë dhe u mendua. Si t'ja bënte? Sigurisht, nuk duhej ta mërziste babanë. Edhe kësaj radhe Lu kishte të drejtë. Duhej gjetur punë, tjetër s'kishe ç'të bëje. Ajo duhej të punonte dhe të fitonte jo vetëm për të blerë libra dhjetë sencash me figura ngjyra — ngjyra, të cilat shiteshin në qytet, po edhe për të blerë fustan, çorape dhe këpucë. Meqenëse shkollën e mbyllnin shpejt në verë, që fëmijët të punonin, edhe ajo do të gjente një punë.

Po ku? Fabrikat që ishin në xhade, nuk pranonin njeri. Për këtë gjë flisnin nëpër mbledhjet vajzat e

rritura të fermerëve. Të pajtohej te ndonjë familje për t'u kujdesur për foshnjën? Asnjë nga gratë e fermerëve nuk ishin në gjendje të paguante për këtë gjë, qoftë edhe pesë senca në ditë. Përveç misis Perit, të gjithë ishin shumë të varfër.

Misis Peri, e veja e një gjykatësi, kishte një pronë, pranë së cilës kalonte gjithmonë Iva, kur e dërgonin të hidhte letrën në kutinë e postës. Një gardh me dërrasa e rrethonte tokën e misis Perit dhe shtëpinë me shtylla, që dukej midis pemëve. Sipër trinės ishte varur një copë dërrasë, ku ishin shkruar këto fjalë: «Ndalohej hyrja pas orës pesë». Një qen i madh, me një qafore bronxi, me bishtin që i rrinte përpjetë si shkop, ruante pronën gjithë ditën e ditës.

Rrugës, duke shkuar për në kutinë e postës, Iva ndalej përpara trinės. Grilat e dritave ishin mbyllur. Misis Peri nuk ishte kthyer ende nga jugu. Dy ose tri herë në ditë Iva shkonte për në kutinë e postës për të parë në ishte kthyer misis Peri, kohën tjetër rrinte e ruante në xhade se mos vinte automobili luksoz i së vesë. Dhe ja, një ditë ajo pa se grilat e dritareve ishin hapur dhe vetë misis Peri, me një kovë të vogël të shndritshme në dorë, mblidhte në lëndinën përpara shtëpisë lule radhiqe.

Iva hapi trinën e gardhit dhe shkoi drejt zonjës së shtëpisë.

— Doni të pajtohem te ju për të këputur lule? Unë di të punoj shpejt, misis Peri. — Ajo u përkul, këputi me shkathtësi një lule radhiqe dhe e hodhi në kovën e vogël.

Misis Peri, një grua e gjatë dhe e thatë, me një hundë si të skifterit, e vështroi si me inat:

— E kujt je ti, moj vajzë?

Iva u habit dhe tha:

— E babait. Babanë ma thonë Benson. Atë e njohin të gjithë.

— Hëm! — ja bëri misis Peri.

Erdhi qeni, skërmiti dhëmbët dhe turfulloi me zemërim.

— S'jam përtace, — tha Iva. — Di të punoj mirë.

— Të shohim. — Misis Peri shtrëngoi buzët e saj të holla. — Më duhen pesë kova lule radhiqe. Në do të punosh, do të paguaj gjysmë dollar për pesë kova.

Iva shkoi shpejt matanë gardhit, i mori letrat dhe atëherë ju kujtua se nuk e kishte falënderuar misis Perin.

U kthye prapë me të shpejtë, po misis Peri kishte shkuar. Vetëm qeni ishte pranë pemës. Iva u përkul duke përshëndetur shtëpinë me kolona dhe shkoi rrugës me kaq shpejtësi, sa që i buçisnin veshët.

Përpara shtëpisë së tyre kishin qëndruar disa maqina: në zyrë fermerët kishin mbledhje. Atje ishin Tereza dhe Lu: Bensoni i thërriste tani shpeshherë në mbledhje, kështuqë familja të mos mbetej pas nga ai në këto çështje.

Me t'u larguar fermerët, Iva u vërsul me një frymë për të dhënë lajmin.

Terezës ju prenë duart.

— S'e di, po ajo Peri është një grua shumë e keqe. Unë s'dua të ngatërrohem me të edhe sikur me flori të ma shtrojë.

— Lere mos e nga se ç'është! — u hodh e tha Lu. — Çarli Maks punonte te ajo dhe një ditë harroi t'i jep-te ujë viçit. Atëhere ajo e urdhëroi kuzhinierin që të mos i jepte bukë. E pajtoi, e mundi sa deshi, pastaj i dha drunë. Kjo pasanike të vjedh dhe morrat e pantallonave, po të mos e kesh mëndjen te puna.

— Lui, — bërtiti Tereza, — ç'janë këto që thua?

Po Bensoni u shkul gazit dhe s'e mbante dot të qeshurit. Fytyra i qe skuqur, barku i tundej. Kur qeshte, qeshte me gjithë zemër.

— Sigurisht, s'duhet të flasësh në këtë mënyrë faqe sat motre. Bensoni shikoi fytyrën e zemëruar të së shoqes — Pse je tronditur? — pyeti ai ngadalë.

Iva e vështroi t'anë plot shpresë. Pastaj tha me një ton të vendosur:

— Baba, ti je shumë i zënë me fermerët, kurse unë... — i lidhi duart sikur të lutej, — kurse unë s'jam më e vogël, ka ardhur koha të mendoj për të fituar bukën e gojës.

I ati rrudhi ballin.

— Po, ndofta ka ardhur koha.

E tërhoqi vajzën pranë dhe filloi t'i tregojë se si kishte hyrë në punë për herë të parë; një pasanik i fshatit e kishte vënë të hidhte plehun në arë. Në mbrëmje, pronari i kishte dhënë pesëdhjetë senca. Ai s'i kishte marrë dhe i kishte thënë në sy pronarit se kishte punuar gjithë ditën e ditës si argat dhe duhej t'i paguante sa u paguante atyre, domethënë një dollar; ai kishte punuar sa punonte një burrë, prandaj duhej t'i paguante sa u paguante edhe burrave. Pronari ishte koprac i madh, po edhe shumë i matur, s'donte shamatë. Deshi s'deshi i dha një dollar... Po, kur e muarën vesh këtë gjë fëmijët e tjerë që punonin në fermë, edhe ata ngritën zërin dhe kërkuan shtesën. Pronari u detyrua t'ua shtonte edhe atyre mëditjen.

— Unë atëhere isha siç është tani Lu: isha gati të zihesha me të gjithë. Një herë më dhanë atë që kërkova, po pastaj një dru pas koke. Hapi sytë mirë. Mundohu të fitosh më shumë se yt atë. — U ngrit dhe shkoi bashkë me Lunë në arë për t'i treguar se ç'duhej të bënte javën tjetër, kurse Tereza filloi të rregullonte ndëresat e burrit dhe ilaçin e stomakut, sepse natën Bensoni do të shkonte në një fshat të largët për të futur fermerë të tjerë në Bashkim.

Iva u muar vesh me vëllezërit e saj besnikë që ata të ruanin lopët në vend të saj kohën që ajo do të mblidhte lule radhiqe.

Për këtë gjë do t'u jepte pesë senca. Binjakët muarën nga një shkop dhe shkuan shpejt në livadh dhe i vunë përpara lopët duke bërtitur. Iva, që ishte e tronditur, fshihi duart dhe u nis për herë të parë në jetë për të fituar mëditjen e saj.

Zezakja, kuzhinierja e misis Perit, i dha vajzës së

vogël kovën dhe Iva shkoi tërë gaz në fushë. Shumë lule kishte në fushë atë ditë: vjollca, lulëshqera po lule radhiqet atë ditë ishin fshirë nga faqja e dheut. Iva kapërcente gardhet, kërkonte në pyll dhe gjatë rrugës; kovën e kishte pranë. Ajo shkoi pothuajse gjer në qytet, gjer atje ku kalonte vija e trenit, pastaj u kthye prapë në shtëpi ndaj të ngrysur, duke shkuar përmes pyllit që ishte plot me huta dhe lakuriqë.

Tereza e pyeti në ishte shumë e rëndë kjo punë për të, se ja, ishte lodhur aq shumë, sa i qe prerë edhe uria. Po Iva u mbështet në tryezë dhe tha:

— Nënë, kjo është puna ime e parë dhe unë s'heq dorë nga ajo. As babai nuk ka hequr dorë. Kam dhënë fjalën. — Vështroi nga ana e binjakëve, pastaj mbështeti kokën në duart që i dridheshin nga të lodhurit.

Për të mbledhur pesë kova radhiqe u end një javë të tërë fushave dhe korieve. Fustani i vajzës qe grisur te telat me gjëmba, duart i qenë fryrë dhe i qenë bërë mavi. Ishte e lodhur dhe e rraskapitur, po dhe krenare kur solli kovën e fundit në shtëpinë e misis Perit dhe i ra kaq fort derës sa kuzhinierja e gruas së ve brofi në këmbë sikur kishte rënë në zjarr. Zonja s'ishte në shtëpi, kishte dalë të shetiste me kalë: po të donte, vajza mund të vinte të dielën

Të dielën në mëngjez, Iva u kreh mirë e mirë, i lau këmbët dhe mbathi këpucët. Duke mbajtur shaminë në dorë, shkante me kudjes xhadesë dhe, sa herë që kalonte ndonjë maqinë largohej që të mos bëhej me pluhur.

Në lëndinën që ishte përpara shtëpisë së misis Perit, kishte shumë miq; ca rrinin në kolltukë kashte dhe ca të tjerë loznin krocket. Iva bëri sikur hodhi letrën në kutinë e postës. Pastaj, me zemrën që i rrihte fort në kraharor, hapi trinën e gardhit dhe hyri brenda, duke kaluar pranë njerëzve që loznin krocket.

Ajo u përkul me njerëzi përpara misis Perit dhe tha duke pëshpëritur:

— Paguamëni, ju lutem!

Misis Peri nuk u duk aspak e kënaqur nga këto

fjalë. I ktheu kurrizin, futi dorën në çantën e vogël të mëndafshtë dhe lëshoi të hollat në dorën e Ivës.

Zonjat, mikeshat e misis Perit, shikuan Ivën dhe ja krisën gazit. Vajza e vogël i shtrëngoi paratë në grushtin e saj dhe s'pa nga iku. Vëllai i saj, Lu, ngiste parmendën në arë. Iva nuk qëndroi, po tundi grushtin sikur t'i binte ziles. Vajti duke gulçuar në shtëpi, u fut në kuzhinë dhe përplasi monedhën në tryezë.

Terezës i ngriu nënqeshja në buzë:

— S'të paska dhënë gjysmë dollar, po njëzet e pesë senca.

Iva rrahu qerpikët e syve, se ju duk sikur ju zu fryma.

— Kaq më dha, nënë. Kaq më dha, pa më thënë asnjë fjalë.

Tereza shtrëngoi dhëmbët. E vështroi të bijën, pastaj monedhën, pastaj fëmijët e vegjël; mori një copë bukë dhe filloi ta përtypë; po atë çast e pështyu dhe e hodhi në oborr nga dera e hapur, pastaj e mori Ivën nga dora dhe shkoi bashkë me të rrugës.

Shtëpia e misis Perit dukej e shkretë. Tereza e përplasi me forcë derën e gardhit. Doli kuzhinierja zezake dhe i tundi dorën, duke i dhënë të kuptojë se misis Peri bënte gjumin e vapës.

Tereza tha me ashpërsi:

— Kam një fjalë për t'i thënë!

Pritën një copë herë të madhe. Brenda në shtëpinë e freskët këndonte një kanarinë. Terezës zunë t'i kullonin djersë nga balli: I ra ziles:

Dera u hap dhe në krye të shkallëve doli misis Peri me një dolloma të gjatë prej mëndafshi.

Iva shkoi drejt saj dhe i lëshoi në dorë monedhën që i kishte dhënë.

— S'më keni dhënë gjysmë dollar, misis Peri.

Misis Peri buzëqeshi lehtë.

— E di. Po ti, moj vajzë, nuk punove më shumë, që të fitoje më shumë. Ti i mbushe kovat përgjysmë.

Iva mbeti gojëhapur nga habia.

— Kjo është gënjeshtër e ndyrë, — tha me zemërim Tereza. — I pashë që i kishte mbushur plot kovat.

Iva mbuloi supet dhe u gëlltit, se ju duk sikur i kishte ngecur një lëmsh në grykë.

— I mbusha plot, misis Peri.

— S'jam e detyruar t'u bëj të mira të tjerëve. — Misis Peri u ngërfos si langoi kur i del përpara gjahu. — Ti i këput lule radhiqet bashkë me kërcejtë. Një kovë e tillë s'vlen asnjë senc.

Tereza hapi duart e saj tërë kallo.

— Edhe pesëdhjetë senca është lirë! S'ju mjafton që i ripni të mëdhenjtë? S'ngopeni? — bërtiti ajo.

Misis Perit ju hapën vrimat e hundëve.

— Pse s'bëni një demonstratë? Mblidhuni një turmë fermerësh të ndyrë dhe dilni e bëni demonstratë!

Tereza u zbeh në fytyrë.

— Bushtër! Bushtër e fëlliqur dhe e mallkuar! — tha ajo.

Misis Peri ja hodhi monedhën njëzetepesësenca dhe u largua duke mbajtur kokën lart. Kuzhinierja doli bashkë me qenin dhe qëndroi te dera.

Iva deshi ta merrte monedhën, po Tereza e zuri për krahu, i shtrëngoi fort gishtrinjtë dhe e tërhoqi nga trina e gardhit. Ajo shkante përmes lëndinës me çape kaq të mëdha, sa i dukej sikur do t'i grisej fundi. Iva ktheu kokën dhe vështroi: qeni u vërsul pas tyre. Vajza e vogël deshi s'deshi vrapoi që të arrinte t'ëmën.

Vetëm kur ju afruan shtëpisë, Tereza lëshoi dorën e vajzës. Hyri brenda dhe, dyllë e verdhë siç ishte, u lëshua në karrige pa pikë fuqie.

Erdhën binjakët dhe kërkuan të hollat që u kishte premtuar.

Iva u largua shpejt nga ata dhe shkoi në plevicë. Ra përmbys mbi barin e ngrohtë të vitit të kaluar; zemra i rrihte me fuqi. Ndënji shtrirë një kohë të gjatë. Më në fund lotët i filluan t'i teren. Nga plasa e plevicës pa t'ëmën që merrej me punë në kuzhinë, që lau

enët, e pastaj shkoi të milte lopën. I vëllai Lu solli kalin nga fusha dhe pyeti me zë të lartë.

— Si u bë ajo puna me kopracen?

Ai ju afrua s'ëmës, po Tereza e shtyu dhe u ul në fron me grushte të shtrënguara mbi gjunjë.

Lu u kthye te binjakët dhe tundi kokën me fytyrë të ngrysur, duke i dëgjuar që murmurisnin dhe i tregonin me gisht plevicën. Pastaj Lu vuri gojën në mes të pëllëmbëve dhe bërtiti.

— Ivë, Ivë!

Ajo u fut edhe më thellë në bar. Lu u drejtua për në shtallë për t'ja rregulluar shtratin kalit që të flinte, pastaj, duke përpjekur këpucët me zemërim, hyri në shtëpi.

Pas një copë here u bë natë. Nëna doli në oborr dhe, duke u kthyer nga plevica, thirri Ivën me zë të ulët. Vajza doli dhe zbriti poshtë; fustani që vishte të dielave, ishte plot me fije bari, shamia e hundëve ishte bërë qull nga lotët dhe i qe grisur. Po Tereza nuk i foli, i dha të hajë dhe i tha pa e vështruar:

— Dyshekun ta kam shtruar.

Binjakët ishin shtrirë dhe flinin në krevat duke marrë frymë me zhurmë, sikur i frynin çorbës së përvëluar. Edhe Lu ishte shtrirë; ishte aq i dobët, sa të dukej sikur nën jorgan ishte një shkop; fytyra e tij ishte pothuajse e zezë. Iva shkoi në këndin e saj pranë dritares dhe u mblodh kruspull në dyshek.

Kishte kohë që ishte errur e ishte bërë natë kur fenerët e një automobili ndritën plevicën dhe e bënë ditë oborrit. Maqina u ndal dhe, atë çast, motori u fik. Nga automobili zbriti Bensoni dhe përqafoi të shoqen që kishte dalë në oborr për ta pritur. Ata hynë në shtëpi dhe zunë t'u ngjiteshin shkallëve.

— Jo, ajo po fle.

Iva kishte dalë në korridor, po, me të dëgjuar këto fjalë të nënës u praps dhe u shtrëngua pas murit.

Babai dhe nëna shkuan në dhomën e gjumit. Dera u mbyll. Nëna tha:

— Lu, Lu, si është e mundur që të mos i lënë rehat as fëmijët tanë?!

Këpucët e Bensonit krisën në dysHEME si dy të shtëna.

— Ti je grua, po për gjënë më të vogël dëshpërohe si një fëmijë. Mos kështu!

Ivës ju duk sikur s'do të merrte dot frymë. Ajo dëgjoi se si e mori me të mirë nënën i ati, duke i thënë që të mos mërzhitej. Ajo qau se këtu bënte shumë ftohtë dhe ajo ishte vetëm. Dikush e zuri për supi dhe e largoi nga koridori. I vëllai Lu ju afrua shumë dhe i tha:

— Përgjon?

Iva u shkëput nga duart e tij.

Ajo zbriti nga shkallët duke u penguar, kaloi me të shpejtë përmes oborrit dhe zuri të vrapojë në rrugë. Huti bërtiste si një qengj që ka humbur udhën. Xixëllonjat kërcenin dhe të dukej sikur një njeri me shkrepse endej nëpër errësirë. Iva hapi ngadalë derën e gardhit dhe, duke ecur në majë të gishtrinjve, ju afrua tinës shtëpisë së madhe. U ul në gjunj dhe zuri të kërkojë me dorë nëpër bar.

Që prapa reve dolj hëna. Ajo vështroi vajzën përmes degëve të panjave të larta. Papritmas në shtëpinë e madhe u dëgjua zhurmë, qeni zuri të lehte dhe të kruante derën me këmbë.

Iva brofi në këmbë dhe iku me vrap. Këmbët i kishte të lagëta, të gërvishtura. Asaj i dukej sikur hëna i kishte pajisur me sy të gjitha sendet dhe sikur ato e shikonin me vëmendje. Pati shumë frikë dhe u sul fluturimthi në shtëpinë e saj. Në zyrë kishte dritë. I vëllai Lu ishte ulur te praku i derës, këmbë mbi këmbë dhe përtypte duhan.

E kapi Ivën përkrahu dhe e uli në karrige.

— Ku ishte? — pyeti ashpër.

Ajo e shtyu.

— Mos pandeh se do ta lë misis Perin të ma hedhë në këtë mënyrë? — tha ajo duke qarë me dënësë. — Babai më tha... edhe unë kam detyrimet e mia... — me të thënë këto fjalë, mbuloi fytyrën me duar.

Lu tha me zemërim:

— Mos bërtit, folë shtruar.

Iva pushoi së qari dhe tregoi se ç'i kishte ngjarë.

Lu u përkul nga ajo dhe pëshpëriti:

— Në vend që të kesh turp, duhet të gëzohesh.

Iva e vështrroi të vëllanë me sy të përlotur.

— Të them se duhet të gëzohesh. Ti ma kalove edhe mua. — I ra tryezës me gishtrinj. — Tani edhe ti ke hyrë në ushtri, në ushtrinë ku ka hyrë babai, nëna dhe të gjithë ata që punojnë për të tjerët dhe të cilët i vjedhin. Tani edhe ti je në këtë ushtri.

— Po, po, —tha Iva duke qarë me ngashërim.

Lu mori me kujdes nga tryeza një libër të kuq dhe të vogël. Në kapakun e tij ishin shkruar këto fjalë «Armiqtë e klasës».

Iva vështrroi dhe s'kuptoi asgjë. Ajo e dinte se i vëllai ishte shumë i prapë dhe kishte shumë armiq në klasë. Ai kthehej shumë herë nga shkolla me fytyrë vula-vula, dhe i ati i fliste për këtë gjë, po Lu shkante e zihej përsëri me armiqtë që kishte në shkollë.

Në faqen e parë të librit të kuq ishte shkruar me gërma shtypi: «Të poshtrit», dhe në një vend tjetër, në mes të faqes, «Të poshtrat». Lu i lexonte të motrës listën e gjatë të armiqtë të klasës. Këtu ishin matrapazët e qumshtit, sherifët që kishin shtypur grevën e fermerëve, gjykatësit që kishin burgosur babanë, bankieri që ja kishte marrë tokën fqinjit, doktori që s'kishte pranuar të vinte të shihte nënën, sepse kjo ishte e shoqja e Bensonit.

— Kështu pra, — tha Lu, — filloi me misis Perin.

Iva më në fund kuptoi. Bërtiti lehtë dhe e rroku të vëllanë në qafë; atij i vinte era kalë dhe duhan, si babait; dhe menjëherë e ndjeu veten shumë të lehtësuar.

Lu shtyu të motrën, pastaj u ul ndanë karriges dhe e përqafoi si pa dashje.

Duke buzëqeshur me ata sy gjithë lot, në librin e vogël dhe të kuq, në librin që se harrojmë, Iva shkroi: «Misis Peri për pesë kova».

KLIME E RE

Dipoja e vogël i zgjati pjatën Ishar Kaurit.

— Gjyshe, — tha ajo me gjallëri, — sot na kanë shirë grurin. Mamaja ka gatuar karan¹⁾ për këtë festë dhe ja ku solla një copë edhe për ty.

Ishar Kauri hoqi kapakun gjithë lyrë dhe një dridhmë i përshkoi kurrizin. Të tjerët e kishin shirë grurin, kurse ajo nuk kishte se ç'të shinte. Një vit më parë, në dhjetor, policia kishte arrestuar djalin e saj të vetëm, Seva Sing. S'kishte se kush të kujdesej për mbjelljet, kështuqë ato u prishën dhe tani ara e tyre dergjej e palëruar dhe braktisur. Me zemër të lënduar e mbylli prapë kapakun.

— Shpjere atje te vatra dhe jepja tezes, — tha ajo me zë të qetë.

E reja e Ishar Kaurit rrinte pranë vatrës së shuar. Duke i zgjatur pjatën, Dipoja vuri re se sytë e teto Bantës ndrinin, ashtu siç i ndrinin sytë nënës kur i frynte zjarrit. Banta e mori si me gjysmë zëmre karan dhe e vuri në kusi. Po, kur e ktheu pjatën, papritur e papandehur pa se kishte përpara Dipon e vogël. Ajo fërgëlloi e tëra dhe u mbush me gjallëri kur i pa ato duar që zgjateshin nga ajo si filiza të njomë. E vuri mënjanë si me ngurrim pjatën e zbrazët. Pastaj me një lëvizje të vrullshme e përqafoi Dipon dhe e shtrëngoi. Të dukej

1) Karan — një lloj ëmbëlsire.

sikur mundohej të mbytte hidhërimin e përvëluar të netve vetmitare të dhjetorit, netët e para të martesës së saj.

Ajo e puthi dhe e puthi prapë Dipon, duke e shtrënguar te gjiri i saj, që s'kishte ushqyer kurrë fëmijë. Sa mirë që i vinte kur i çikte dhe i përkëdhelte ato leshra ngjyrë gështenjë dhe si mëndafsh! Po befash, sipër këtyre leshrave ngjyrë gështenjë, dhe si mëndafshi, ju duk sikur pa sarëkët e kuq të policëve, të cilët ja kishin marrë burrin dhe ja kishin çuar në burgun e largët. Nuk i shtrëngoi më duart. Nuk e ndjente më veten të qetë kur e prekte vajzën, sikur diçka e diqte nga brenda. Dipoja e vogël, e cila u turbullua nga ky ndryshim i befashëm, e la pjatën dhe iku.

Ishar Kauri po rrinte më këmbë te praku dhe vështronte larg; dukej e pikëlluar. Përpara syve të saj shtriheshin arat. Pas një jave, kaçubet e piperit do të mbuloheshin me lule të bardha dhe gjithë ajri do të kundërmonte nga ajo era e fortë. Ata që kishin pak tokë, e kishin korrur grurin dhe po e shinin. Tani arat i bënëin gati për të mbjellë oriz.

Në fshat, të gjithë po merreshin me punë: gratë meremetonin enët prej argjili, i fshinin e i pastronin hambarët dhe në farkat zjarri digjej gjithë natën e natës: atje i mprehnin drapëret dhe korrëset. Edhe fshe-saxhinjtë e rrugëve, që s'kanë asnjë pëllëmbë tokë, këpucarët dhe endësit u bënë kositës, kurse pleqtë dhe fëmijët rrinin në hijen e bananeve dhe thurmin litarë nga bisqet e orizit. Kurse Ishar Kauri, tani që gjithë fshati shkante e vinte si suvajka e vegjës, ajo me të re-në rinin duarlidhur, ngaqë s'kishin qoftë edhe dy fije kashtë për t'i thurur.

Ishar Kauri nuk shqetësohej vetëm nga shkaku i arës së shkretë; ajo shqetësohej dhe për Bantën. Gruaja e re, pothuajse gjithmonë hiqej mënjane nga moshataret e saj dhe s'u qasej fëmijëve të vegjël. Të nesërmen e martesës, Seva Sing u nda nga e shoqja që të mernte pjesë në luftën që kishte plasur në mes të pronarit të madh të tokave, Sardarit, dhe bujqve që ja punonin tokat.

Ata kishin shekuj që punonin këto toka dhe tani donin që t'i kishin të tyret.

Seva Sing mezi pati kohë të dëgjonte tringëllimin e bylyzykëve të kuq të martesës në duart e së shoqes. Po shtinin kundër bujqve dhe policia e mori. Atë çast, Ishar Kaurit ju duk sikur diçka u thye në veten e saj; Banta i shihte të gjitha përmes duvakut të kuq. Të shoqin e muarën dhe e shpunë përmes arës ku kishin filluar të gjelbëronin filizat e parë.

Më parë Ishar Kauri i thoshte shpesh të birit:

— More bir, kur do të më marrësh ndonjëherë që të shetis me autobus, se s'kam hipur kurrë në atë maqinë djalli!

Po djali ishte shumë i zënë me punë. Kur ja kujtoi ajo këtë shetitje, ai e përqafoi dhe plot përkëdheli, si një fëmijë, i tha:

— Moj nënë, veç sa të fitojë lirinë vendi ynë, pa të shetis jo me autobus, po me aeroplan.— Dhe sytë e Seva Singut shkëlqenin.

Erdhi dita e pavarësisë dhe bashkë me të edhe shetitjet me autobus. Ishar Kauri me të renë shkuan në qytet, ku ishte në burgun e madh Seva Singu. Ato rrinin në rrugë, te portat e mëdha me hekura, dhe prinin. Gjithë ditën e ditës ato dëgjonin vringëllimin e zinxhirëve dhe gjëmimin e aeroplanëve, që ngriheshin nga aerodromi që ishte aty pranë. Siç duket, ja për këta aeroplanë fliste Seva Singu.

Ato pritën gjersa përëndoi dielli dhe atëhere roja e burgut tha:

— S'mund të takoheni me të. Është i poshtër. Ka shpallur grevën e urisë, ai bashkë me shokët.

Dhe s'muarën vesh më tepër. U kthyen prapë në fshat duke sjellë bohçen me sheqer e gjalpë, që i kishin bërë vetë.

Dikush trokiti te dera. Banta e hapi dhe u tremb kur pa një burrë të huaj. Po Ishar Kauri e njohu Kekun.

— Tungjatjeta, moj nënë, — i tha miku.

Ishar Kauri u turbullua. Nga kishte ardhur? Pastaj e vështroi Bantën dhe pati frikë për rininë e saj. Ato

ishin vetëm dhe s'kishte njeri që t'i mbronte. Duke bërë sikur donte t'i thoshte diçka fqinjës së saj, ajo u nxitua të nxirrte të renë jashtë nga shtëpia.

— Dëgjo, moj nënë, — tha si duke ngurruar Keku, — kam ardhur të të them se djalin e ke shëndoshë e mirë. Të dërgon të fala ty dhe nuses.

Ishar Kaurit i erdhi zemra në vend dhe psherëtiu.

— Ku e takove? — pyti ajo.

— Në burgun e madh, në qytetin e madh. Unë u lirova. Më mbajtën brenda shumë kohë, po pastaj më falën.

— Të falën? Po si kështu?

— Thonë se kanë arrestuar shumë nga shokët e Seva Singut dhe disa nga ne, gjynahqarët e vjetër, i falën që t'u bënin vend atyre. Se sa të vërteta janë këto fjalë, s'e di.

Ishar Kauri u mundua të mos tronditej.

— S'm'i ka ndodhur gjë djalit? — pyeti ajo.

Keku sikur deshi të thoshte diçka, po e mbajti veten. Më në fund tha me një zë shumë të butë.

— Jo, moj nënë, tani është mirë.

— Ç'kërkon të thuash me këto fjalë? Djali im... Ç'i ka ngjarë?

— Në burg u plagosën... me plumba. Po tani është në spital dhe s'ka gjë, — me të thënë këto fjalë, Keku i uli sytë.

— I qëlluan në burg? — pyei ajo si pa u zënë besë fjalëve të tij.

— Po, për t'u çuditur, — tha Keku, pa ngritur kokën. — As ne s'do të kishim besuar, po të mos kishim parë me këta sy. Kam qëndruar kaq vjet në burg, po s'kisha dëgjuar kurrë të shtinin. Seva Singu dhe shokët e tij kundërshtuan... — s'tha dot ç'kishte për të thënë dhe u mundua t'i mbante lotët.

Ishar Kauri qante në heshtje. Buzët s'i dridheshin po zemra i ishte bërë copë e çikë... Shumë vjet më parë, atëhere kur Seva Singu ishte fare i vogël, mënt e shtypi

demi i tërbuar. Një hidhërim i tillë ja kishte shpuar zemrën edhe atëhere.

Papritur e pakujtuar dëgjoi një zhurmë. Nga ana lindore e fshatit po vinin duke i rënë trumbetës. Keku vështroi në rrugë. Ai pa atje larg nja tridhjetë fshatarë dhe trumbetierin... Pas tyre, mes resë së pluhurit, vinin tre pendë qe.

Banta erdhi me të shpejtë. Ishar Kauri vështroi me vërejtje dhe pa se grumbulli i njerëzve qëndori ndanë arës. Trumbeta dëgjohej dhe më tepër dhe dikush doli nga grumbulli dhe u drejtua për në shtëpinë e Ishar Kaurit.

— S'kuptoj se pse janë mbledhur këta njerëz, — tha Keku i shqetësuar; ai kishte frikë se mos kishin ardhur për të marrë plaçkën e Seva Singut.

Ishar Kuari e përqafoi Bantën pothuajse padashur.
— Kërkojnë të na marrin tokën! — klithi ajo me një zë të çjerrë. — Kanë ardhur nga ana e Sandarit. Ata na sjellin urinë dhe vdekjen! Kjo është toka ime dhe unë jam vetëm fillthi, s'kam njeri që të më mbrojë.

Keku deshi ta qetësojë, po s'dinte se ç'të thoshte. Ngaqë kishte kaluar shumë vjet në burg, ishte çmësuar të fliste me gratë.

— Mbahu, moj nënë, — tha ai me të butë. — Sa të jem unë këtu, asnjë nga larot e Sardarit s'guxon të të fyejë.

Ishar Kauri ishte bërë si e çmendur. Ajo e la Bantën që dridhej, dhe, si e rrëmbyer nga një fuqi e madhe, shkoi vrap në arë. Ajo jo sikur shkonte, po sikur fluturonte si tufan drejt arës, të cilën e punonte dikur i shoqi, ku ai hante në drekë një grusht oriz dhe kulaç; drejt asaj arë të cilën e punoi pastaj i biri, dhe ku e shoqja s'pati rast t'i çonte qoftë edhe një herë drekën.

— Xhelatë! — u thirri ajo që nga larg.

Edhe Keku u drodh nga kjo klithmë.

Trumbeta ra dhe më fort dhe grumbulli i njerëzve u shtua dhe më shumë. Ishar Kauri e njohu atë që i kishte dalë përpara; ishte Lal Singu. Ial Singu! Si ishte e mundur që të pleksej me këta horra? I biri e

kishte shok, ata bashkë shkonin në mbledhje dhe bashkë ktheheshin. Ai kishte ngrënë shumë herë bukë në shtëpinë e saj, kur vinte me të birin.

— Lal Sing! Edhe ti qenke këtu?

Lal Singut i qeshte fytyra nga gëzimi. Ai u vërsul dhe, pa pritur që kjo të thoshte ndonjë fjalë, i tha me përkëdheli:

— Nënë...

Oshëtima e madhe e trumbetës buçiti në zemrën e saj. Ajo i shikonte me zemërim të madh ata që ishin mbledhur atje. Po, sa më shumë afrohej, aq më shumë njerëz të njohur shihte në atë grumbull. Ja Hazari, ja Çani, që kishte luftuar me egërsi në kohën e kryengritjes së bujqve vitin e kaluar; ja Premi, që këndon gjithnjë ca këngë të mallëngjyera, kur fshatarët mblidhen mbrëmënet për t'u çlodhur në sheshin e fshatit. Trumbeta pushoi edhe pastaj foli Dalipi, Dalipi për të cilin thoshnin se në zërin e tij fshihej një magji. Ishar Kaurit ju duk sikur po i binte të fikët dhe e shtrëngoi fort dorën e Lal Singut.

Dalipi tha:

— Shikojeni arën. Ajo është e shkretë dhe e braktisur. Kjo arë është e shokut tonë. Ai luftoi për ne dhe ata erdhën të armatosur dhe e muarën. Po askush s'ka fuqi ta ndalojë lëvizjen e jetës. Tani punët kanë ndryshuar në vendin tonë. Ne do të ndërtojmë jetën e re. Do ta punojmë së bashku këtë tokë. Çdo brazdë e kësaj are do të jetë një thirrje për në bejleg, që do t'u bëjmë qeveritarëve të sotëm. Ne do t'u tregojmë se timonin e kohës sot e kemi ne në dorë. Seva Sing, ajo drita e kohës së re që ka shkrepur në zemrën tënde, s'është e mundur të shuhet me plumba! Kjo arë është jotja, është jona dhe, sado që të na qëllojnë me plumba, s'e lëmë pa e punuar. Përpara, shokë!..

Qetë u futën dy nga dy në arën e Seva Singut.

Ishar Kauri e puthi fort Lal Singun. Dipoja erdhi me të shpejtë dhe u shtrëngua pas Bantës dhe, kur e shikoi të renë, Ishar Kauri pa se asaj i qeshte fytyra nga gëzimi, tamam sikur të ishte martuar dje.

ANDRESHKOJA

— Do arrijmë shpejt, zotni, pa u errur. Ja fshati, ja, atje pas pyllit. Kur ta lemë prapa atë kodrën, zëre se kemi arritur.

Dhe karrocieri i ri, pasi e fishkulloi kamxhikun, u thirri kuajve me zë të lartë, që t'i nxiste.

— Ya... Ya zotërinj!..

Të katër rrotat e karrocës stërkalnin më fort baltën e holluar të rrugës së fshatit. Skeleti i saj i hollë trokiste me zë të mbytur në mes të fushës së vetmuar, të trishtuar, të shkretë e të njomur nga shirat. Fshatari thirri edhe një herë, zuri vend mirë në arkën ku ishte ulur, hoqi nga koka kapuçin e lagur të gunës së trashë dhe zuri të këndonte me hundë i shkujdesur.

— Si e ke emrin? — pyeti nga thellësia e qyrkut të madh prej lëkure ujku, ku ishte zhytur, zotnia i trashë që rrinte në karrocë.

Djaloshi nuk pushonte së kënduari me hundë.

— Na, more, more djalë! — thirri udhëtari me zë të lartë e të ngjirur.

— Ë? — u kthye djaloshi.

— Emrin, emrin! Si e ke emrin?

— Andreshko.

— Ehe! Andreshko... finok je ti!.. Kështu jini bërë të gjithë. Jini bërë dinakë ju fshatarët... Dini vetëm të gënjeni e të dredhoni. Dhe sa mirë dini të hiqeni sikur s'merrni vesh gjë. I shoh në gjyq... Duken shqerra, kurse janë ujq! Lozin me gjykatësit.

— Jemi popull i thjeshtë, zotni, vetëm nami na

ka dalë i keq. Juve ashtu u duket, po nuk është ashtu. Ngaqë nuk dinë, dredhojnë fshatarët. Nga padituria dhe varfëria...

— O-o-o, nga varfëria, nga varfëria. Të shkretat koka të pagdhendura! Qahen nga varfëria, kurse pinë si kafshët.

— Se mos pinë nga qejfi? Jo, s'është nga qejfi... Që pinë, të gjithë pinë. Për të mirë... po jo nga e mira... Një gjë të tillë një njeri si ju mund edhe ta shkruajë në letër.

— Aha, më duket se edhe ti ke pirë, more mik... Kurse je i ri, s'të kanë dalë ende mustaqet... Ta shkruash në ballë këtë që po të them, se ata fshatarët tuaj s'janë veçse njerëz të humbur, ja, kështu!

— Shkruaje ti, zotni, se ne nuk dimë të shkruajmë.
— Dhe, duke ju kthyer kuajve kockë e lëkurë, u thirri:

— Ya, ya, zotërinj! — dhe ra në mendime.

Edhe kuajt ranë në mendime. Zotnia ngriti jakën e madhe të gëzofit prej lëkure ujku, u zhyt në të dhe ra edhe ai në mendime. Në një dru të vetmuar anës rrugës qëndroi një sorrë me pendë të ngritura përpjetë, u lëkund në degën e thatë, klithi si me të qarë dhe ra edhe ajo në mendime. Edhe moti i trishtuar i dimrit kishte rënë në mendime. Njëpër qiell, rëndë edhe ngadalë, zvarriseshin dhe copëtoheshin re të trasha, të reckosura e plot lagështi dimërore, mbi të cilat dukeshin pjesë nga qielli i kaltër, gjithashtu si të menduar dhe të ftohët.

Toka zhytej në baltë e lagështi. Të vdekura dhe pa shpresë nxinin peizazhet e shpërndara të fshatrave, të përrenjve, të pyjeve të largëta dhe të maleve. Njëpër fushë shkëlqenin pellgje të mëdha uji, të errët të ftohët dhe të çakëritura si sy të vdekurish.

Karroca e vogël lëkundej ngadalë, njëpër baltën e thellë e të hollë zhytej, dilte, vente anash. Një dërrasë e karrocës, e shqitur mënjanë, përplasej vazhdimisht njësoj dhe, duke ja goditur papushim nervat zotnisë së trashë në gëzofin prej lëkure ujku, ja theu durimin. Ai hapi jakën, nxori fytyrën e trashë dhe thirri:

— Ç'është kjo kllapashkë e tmerrshme, e marrtë djalli e marrtë! Nuk po më lë të qetë.

— Është një dërrasë që po përplasen pas karrocës, zotni. Dërdëllet si njeri me shkollë: as vetë nuk kupton se ç'është, as të tjerët nuk e kuptojnë.

— Dreqi vetë je ti, Andreshko, dreqi vetë!

Zotnia uli jakën e gëzofit.

— Ti çfarë je, zotni, për ç'punë vjen këtej nga fshati ynë?

— Jam gjykatës, i përmbarrimit.

Andreshkoja u kthye dhe e vështroi me vëmendje qiraxhiun e vet.

— Edhe ke ardhur për përmbarrim, ë?

— Për përmbarrim, kuptohet. Po më tall një fshatar i juaj, po kësaj radhe do t'ja tregoj qejfin. Ka kohë që e ndjek, dhe gjithnjë më rrëshqet nga duart... E mora vesh që më bën dredhira, pra do ta kap sonte dhe do të më mbajë mend... grurin do t'ja sekuestroj! Edhe atij do t'i jap një mësim, edhe për ju do të jetë një shembull, që mos bëni më marifete të tilla. Gënjeni tregëtarët, gënjeni qytetarët e u shisni vezë të prishura dhe vaj të hidhur. Pa prit, moj bushtër fshatare, — pushteti nuk gënjehet lehtë! Të kap — bukur të kap! Për ju duhet kamzhik, kamzhik rus — ashtu do të ndreqeni... Jini bërë pijanecë, kini rënë poshtë, jini prishur. Do të bëheni të paaftë për të paguar taksat dhe do ta shkatërroni shtetin. Ah, kur s'kam më shumë fuqi në dorë! Ëngjëj do t'ju bëja.

Gjykatës përmbarruesi shkopsiti gëzofin dhe trupi i tij lëvizti në të si ndonjë zog pule kur del nga veza.

— Ah, zoti gjykatës. Perëndia bëri botën dhe e pa me vend që grave nuk u duhet mjekra dhe nuk u dha... E pa me vend që gomari duhet të ketë veshë të gjata dhe ia dha, — u përgjegj Andreshkoja gjoja me naivitet.

— Ti, ama, mos llap, po jepi karrocës, se u err... Më more shumë, djalë! Aq shumë para për njëzet kilometra! Dini të na ripni ju... Jepi, pra, jepi, se i zuri gjumi të zgjebosurit.

— Ya, ya-a, zotërinj! — thirri Andreshkoja edhe vërtiti kamzhikun.

— Zotërinj u thua, ë? Më mirë quaji vëllezër, — vërejtë me inat gjykatësi.

— Do zemërohen, zoti gjykatës! Do t'i prek në nder, po mos u thërras zotërinj! Kanë detyrë prej nëpunësi — me orar. Me orar ngrihen, me orar bien; me orar u japim të pinë, me orar u japim të hanë. Pastaj u vëmë yzengjitë, domethënë hyjnë në zyrë, dhe aq. Kurse në stallë lexojnë menjëherë gazetën.

— Paske pirë, or mik, por mos llap shumë, jepi, se u vonuam. M'i ke sytë si të djallit.

— S'ka ujë, zoti gjykatës, mos kini frikë, — tha karroceri me një ton të tillë, sa që nëpunësi i nderuar vështroi majtas e djathtas me ndrojtje.

— Nga ujqit s'kam frikë, or mik, po u freskua. S'kam nge të ftohem.

— Mëbështilluni me thes. Kuajt e mi kurrë nuk qahen se ftohen.

«Ama llafazan, ë?» — mendoi gjykatësi dhe ju kthye me rreptësi:

— Jepi, jepi, hajvan!

Dhe, si u shfry i zemëruar, u zhyt në gëzof e heshti.

«Ëhë, më re në dorë, mik,» — mendoi me vete Andreshkoja. Dhe, duke u kthyer, pyeti me ton serioz:

— Domethënë për sekuestrim, ë? Kujt do t'ja përcëlloni lekurën?

Gjykatësi heshti një kohë të gjatë, pastaj u përgjegj me zemërim:

— Është një... Stanoiç e quajnë, — i shkurtër... me qafë të trashë...

— E njoh. Atij do t'ja sekuestroni grurin, ë? Ai është i varfër, zoti gjykatës, mos e ngisni.

— I varfëri është djalli vetë.

Gjykatësi heshti prapë. Tani po errej. Kuajt mezi zvarriseshin mbi një kodër, prapa se cilës gjendej fshati. Andreshkoja as u thërriste më, as e fërshëllente kamzhikun mbi ta. Pushoi së foluri e së kënduari dhe ra në mendime.

Kur e kaluan kodrën dhe zbritën në fushën matanë, ishte bërë fare natë, kurse fshati nuk dukej më. Një erë e hollë dhe e ftohtë fryu mbi tokën e zhytur në errësi. Retë e coptuara po tërhiqeshin në male. Kupa e kaltër e qiellit të ftohtë dhe të ngrirë po kthjellohej, po zgjerohej dhe po lartësohej. Shpejt aty filluan të dridhen yje, yje të ndritshme, si akull. Ajri u ftoh shumë, ndërsa kuajt ecnin ngadalë. Gjykatësi vazhdimisht nxehej.

— Jepi, ore, malok, do ngrijmë!

Andreshkoja u thirri kuajve pa dëshirë dhe e vërtiti kamzhikun me përtim mbi kokat e tyre. Ata e tërhiqnin karrocën zvarrë dhe kokulur, thuase nuk dëgjonin. Andreshkoja mendonte për të shkretin Stanoiç, që gjykatësi do t'i sekuestronte të nesërmen grurin, gjykatësi që po e çonte ai.

«Ti ma prure atë bela, Andreshko», — do t'i thotë Stanoiçi, kur ta marrë vesh, dhe do ta shajë. Pastaj do të trishtohet, do ta qerasë, do të dehet dhe do të qajë.

«Duhet ndihmuar, duhet ndihmuar... — mendon Andreshkoja. — I duhet thënë ta fshehë grurin natën dhe ta fshijë hambarin, përndryshe gjithë vitin do t'i këndojnë zorrët... Duhet ndihmuar, s'ka si bëhet ndryshe».

Ishte errësi dhe në tokë nuk dallohej asgjë tjetër, veçse baltë, baltë e thellë dhe e trashë. Rruga humbiste në atë baltë dhe nuk të shpinte asgjëkundi tjetër, veçse prapë në atë baltë.

Në një vend Andreshkoja tërhoqi frenat dhe i ndali kuajt.

— Dale, se sikur kam ngatërruar rrugën!

Dhe djaloshi zuri të vështronte me vëmendje në errësi. Gjykatësi shihte fytyrën e tij të egër, ku nuk kishte mbetur asnjë gjurmë nga shakatë e para, dhe i thoshte:

— Çun, mblidh mendjen, se nuk përgjigjem... Do hash dru!

Andreshkoja tërhoqi frenat, vërtiti kamzhikun dhe thirri:

— Mbaju fort, zoti gjykatës!

Përpara, larg, në errësirë, ndriçonte fshati. Nga të lehurat e qenit, që vinin andej, dukej se ishte pranë. Disa hapa më të djathtë shkëlqente me një ndriçim prej margaritari një sipërfaqe uji të palëvizur.

— Ç'eshtë kjo? — pyeti gjykatësi.

— Kënetë, zoti gjykatës... Rruga shkon nëpër të. Eshtë e cekët, mos kini hiç frikë. Vetëm aty këtu ka vrima. Sa herë e kam kaluar edhe me karrocë edhe më këmbë, edhe... Yaa, yaa, zotërinj! Mbahuni mirë, zoti gjykatës!

Kuajt hynë në ujët e ftohtë, ku shihej qielli, dhe me kujdes bënë përpara, duke u zhytur gjithnjë më thellë e më thellë. Ujët e vdekur dhe të ndritshëm në ngjyrë të gjelbër margaritari lëvizin dhe u gjallërua.

— Ndal, hajvan! — thirri pas pak gjykatësi dhe u zgjat i trembur nga gëzofi. — Do më mbytësh, or malok! Nuk e sheh se karroca u mbush me ujë? Ndal! Ndal!

Gjykatësi u nxeh e filloi të shajë.

Andreshkoja i ndali kuajt. Karroca, e zhytur gjer te fundi, qëndroi në mes të kënetës, anët e së cilës humbisnin në errësirën e dendur.

— Yaa... Përpara! — u thirri Andreshkoja kuajve. Zëri i tij i fuqishëm e i shëndoshë jehoi fort në errësirën e natës dhe u mbyt në shkretëtirën e padukshme. Aty pranë fluturuan rosa të egra dhe u zhdukën me zhurmë.

— Duhet të bëhemi edhe ne rosa, pa të dalim, — tha i menduar Andreshkoja, — përndryshe...

— Ah, hajvan! Sa të dalim një herë, pa do të të zhdëp në dru! Do mbytemi, ore!.. Viç!

— Jo, jo, zoti gjykatës, mos ki frikë... Në këtë errësirë kushdo gabon, rri i qetë, — foli Andreshkoja edhe zuri të punonte me kaishat. Lidhi, zgjidhi, shau, mallkoi dhe më në fund u ul prap në sëndyq, vërtiti kamzhikun dhe thirri:

— Yaa!.. Përpara!

Kuajt bënë një përpyekje dhe u nisën. Njëri u shkëput nga karroca dhe zuri të ecte lirisht nëpër kënetë. Tjetri mbeti vetëm në karrocë.

— Mo-o-re! Ç'u bë kështu, — bërtiti gjykatësi.

— Ndal! Dorço... Dorço... — bërtiti Andreshkoja pas kalit dhe zuri ta ndillte. Po ai, duke pasur frikë nga uji, u kthye mbrapsh dhe shpejt e shpejt humbi në errësirë drejt bregut, pa dëgjuar thirrjen e të zotit.

Gjykatësi rrinte në karrocë duke u dredhur nga frika.

Në këtë kohë Andreshkoja ju hodh shpejt përsipër kalit tjetër dhe shkoi pas Dorços, duke thirrur vazhdimisht fort edhe qartë:

— Dorço, Dorço, Dorço!

— Ku po shkon, ore... ej! Ç'bën ashtu, hajvan? Budalla! Ah, katundar morracak... Do të ta rregulloj unë qejfin ty.

Nga errësira ju përgjegj një qeshje sarkastike.

— Ej, hajvan, po më lë këtu!.. Të vdes! Të më shqyejnë egërsirat! Djalo, mos bëj kështu, të lutem! — foli gjykatësi me një zë vajtues.

— Mos ki frikë, zoti gjykatës, — ja ktheu zëri i Andreshkos. — Egërsirat nuk do hyjnë në kënetë. Mbështilluni me thes, se mos ftoheni... Unë do të vij nesër në mëngjez heret... Në karrocë ka bar, shtroje!.. Nuk do të të marr qera!

— Çun, mos u tall, more! — u lut gjykatësi. — Mos më lër!.. Eja! Nxirrme që këtej!

— Është errët, zoti gjykatës, është errët, asgjë nuk duket!.. Pa edhe kali iku. Si të të ndihmoj? S'mundem.

Gjykatësi e dëgjonte atë zë sarkastik që vinte nga errësira, dhe tmerrohej. Si? Të mbetesh aty? Në mes të kënetës! Në mes të atij uji të ftohtë, të gjelbër, moçalor, që nuk i dukej ana!

— Eja, ore Andreshko! Do të të jap para sa të duash!.. Çilimi, a s'ke zemër? — bërtiti nga dëshpërimi; mirëpo askush nuk u përgjegj më.

Atëhere gjykatësi, i dëshpëruar dhe pa mend në kokë, ulëriti nga ana e fshatit:

— Ej, çilimi!.. Haivan... kanibal... budalla... kërcu... katundar, malok! Ah-ah!.. Ndihmë, ndihmë!

Dhe, si u ul në karrocë, u zhyt në gëzof dhe qau si fëmijë.

Po errësira nuk ju përgjegj.

NE SHTEPINE TONE ISHIN KRYENGRITESIT

— Mos u bëni merak, shpejt do të kthehet, — na siguronte nëna, sa herë e pyesnim për babanë.

Ai pat ikur një javë më parë, duke marrë edhe kalin tonë qimekuq. Para se të ndahej, i qe lutur nënës:

«Kujdesu për fëmijët, Amina».

Ai iku, po ne e prisnim çdo mbrëmje. Na bëhej sikur ja, nga çasti në çast, dera do të hapej dhe zëri i tij i dashur do të mbushte dhomën. Ne do t'i dilnim të gjithë përpara, do t'i hidheshim në qafë dhe do ta përqaфонim fort. Po babai nuk po dukej dhe ne i kalonim ditët në pritje, të shqetësuar shpesh pyetnin njëri tjetrin: «Pse iku babai pikërisht tani, në kohën e frutave, iku dhe mori me vete kalin tonë qimekuq?» Sidomos na bëri shumë përshtypje që iku natën.

Ne jetonim në luginën Al-Huti. Këtu kopshtet ishin plot pemë, degët sa s'thyheshin nga frutat e arrira. Fare afër rridhte lumi Tora. Oh, sa qejf kishim të loznim në brigjet e tij, të hijeshuar me plepa të gjatë e të bukur! Po ja që një ditë prej ditësh babai na ndaloi të shkonim në lumë:

— Disa ditë, fëmijë të dashur, s'do të shkoni të lozni në brigjet e Torës. Ka raste që ata e kalojnë lumin me not. Rrezikoni kokën.

Kur ne u bëmë kureshtarë dhe ngulëm këmbë të dinim kush qenë «ata», babai vuri buzën në gaz me hidhërim dhe tha:

— Ushtarët francezë! Ata të poshtër, që kanë shkelur vatrën tonë!

Si fëmijë që ishim, aty për aty nuk u dhamë rëndësi fjalëve të babait. Më vonë, i kuptuam fort mirë...

...Kaluan disa ditë. Nga ana e lumit u dëgjuan të shtëna pushkësh. Pas disa çastesh pamë njerëzit që po mbanin në tezgë një të vranë. Ishte bashkëfshatari ynë i vogël, moshatari dhe shoku ynë, Hamidi. Atë e vranë ushtarët francezë, kur ishte duke lozur në breg të lumit. Ata e qëlluan dhe trupi i Hamidit ra në ujë. Trupi i Hamidit të vogël, bërë copë-copë nga plumbat e ushtarëve francezë, doli në sipërfaqe të ujit dhe e nxuarën. Vrasja e Hamidit të gjithëve na hidhëroi pa masë dhe ne e qamë për një kohë të gjatë. Megjithatë, ne s'mund ta imagjinonim jetën tonë pa Torën, pa brigjet e saj dhe shpesh pyesim babanë:

— A është e mundur, baba, që Torën tonë, të na e marrin përgjithmonë?

Në vend të përgjigjes, atij i shpëtonte një pshe-rëtimë e thellë. Ai na donte shumë. E cili është ai baba që s'do fëmijët e tij? Na dukej se, sa më shumë plakej, aq më i dashur, aq më i afërt bëhej me ne. Na mblidhte të gjithëve dhe me net të tëra na tregonte mbi jetën dhe mbi punën e tij. Ne e dëgjonim babanë tonë, si të thash, pa marrë frymë, duke i thithur çdo fjalë.

Rrjedhën e jetës sonë e prishën ushtarët francezë, me luftën e tyre kundër atdheut tonë. Babai ndryshoi krejt. Mbrëmjeve rrinte i zymtë, me asnjeri nuk fliste. Thellë në shpirt, të gjithë s'e ndjenim veten mirë të gjithëve na mundonte një brengë. Ushtarët francezë na kishin rënë në qafë, po na vrisnin në shtëpinë tonë.

Po shpejt filloi lufta, babai iku dhe ne mbetëm vetëm.

... Një natë dëgjuan një hingëllimë kali. U gëzuam sa s'thuhet, se menduam që mund të ishte babai. Nëna që po thurte një triko për mua, e hodhi atë dhe, nga gëzimi, doli me vrap jashtë si e çmendur.

— Po kthehet babai! — thirrëm ne të ngazëllyer.

Shtëpisë sonë po i afroreshin tre kalorës të armatosur. Dëgjuam zërin e nënës, që i ftoi në shtëpi. Ajo

gjithmonë shkonte me shpresë se mos ata ishin shokë të babait. Po mysafirët ishin njerëz të panjohur dhe shpresa e saj dhe jona u fik.

Të panjohurit hynë në dhomë, hodhën sytë rreth e rrotull me kujdes dhe njëri prej tyre pyeti:

— E kujt është kjo shtëpi?

— E Abu Mustafa Hamarinës, — u përgjegj me zë të ulët nëna.

Mysafirët ishin me mjekra të gjata. Kushedi sa kohë faqet e tyre s'kishin parë brisk. Me një shpejtësi të çuditshme ata i gëlltitën të gjitha gjellët, që u vuri nëna përpara. Ndoshta ishin të uritur, ndoshta nxitohe-shin, se ruheshin nga diçka, s'di çfarë të them. Po puna është se zhurma më e vogël, që vinte nga jashtë, i shqetësonte, dhe ata, si shkëmbenin shikimet një copë herë, vazhdonin të hanin.

Njëri prej tyre, duke ngrënë, tha:

— Sa gjellë e mirë dhe e shijshme, apo jo Abu Hamid?

Abu Hamidi tundi kokën në shenjë miratimi. Ai ishte njeri me tipare burrërore, me ca sy të zinj, që nuk i qeshnin kurrë. Në fytyrë kishte një shenjë plage, tamam si ajo e babait. Sa herë e pyesnim babanë, na thoshte se është gjurmë lufte. Na lindi një dëshirë e zjarrtë të pyesnim Abu Hamidin për atë shenjën e plagës në fytyrën e tij, po s'guxonim, sepse Abu Hamidi na dukej i jashtëzakonshëm. Ai na kujtonte ata heronjtë e përrallave, për të cilët na kishte folur kaq herë gjyshja. Atëhere çfarë s'thoshin për kryengritësit. Gjithmonë kishim ëndërruar të shikonim të paktën edhe një kryengritës, të preknim dorën e tij të fuqishme, të shihnim fytyrën e tij të përzhitur në zjarrin e betejave. Dhe ja, më në fund, për çudinë tonë të madhe, dëshira jonë u realizua: tre kryengritës në shtëpinë tonë, ata po hanë dhe bisedojnë bashkë me ne.

Vëllaj më përshpëriti në vesh:

— Këta janë kryengritës... Çudi, ata qenkan njerëz, si ne të gjithë.

Para kësaj kishim dëgjuar shumë për kryengritësit.

Thoshin se, në brigjet e Torës, ata çfaqen dhe zhduken në mënyrë të papritur. Djemtë e rrugës sonë thoshin se ata janë diva, që dalin drejt e nga toka. Oficerët francezë, në fillim qeshnin me këto përralla, po më vonë u detyruan të besojnë. Një herë francezët po mundoheshin të kalonin Torën, kur para tyre, si fantazma, pa e kuptuar se si dhe nga, dolën kalorësit e fuqishëm, të armatosur deri në dhëmbë. Francezët u sprapsën. Asnjë pyetje nuk u bëme mysafirëve, po shikimet tona plot kureshtje s'mund t'i shkëpusnim prej tyre. Nëna s'donte t'i shqetësonte dhe qëndronte pak larg. Vetëm herë pas here i afrohej tryezës dhe binte për të ngrënë. Fytyra e saj, e ndriçuar nga drita e dobët e llambës me vajguri, shprehte hidhërimin e thellë. Në sytë e saj ne lexonim po atë pyetje, që na mundonte të gjithëve: a do ta kenë takuar babanë tonë mysafirët?

Befas nga ana e lumit, u dëgjuan të shtëna pushkësh. Ne shikonim të friksuar nga njerëzit e armatosur, që po hanin. Sa dëshirë kishim të preknim armët e tyre, të ngrihnim çarkun, ose të paktën t'i mbanim në dorë. Po s'guxonim as t'u luteshim për këtë mysafirëve.

Edhe babai kishte një pushkë. Të njëjta dëshira na ngjallte edhe ajo pushka e babait. Sa herë i ishim lutur të loznim me të, po ai as që na i varte fare. Pushka gjithmonë qëndronte varur në mur, sipër saj lexohej mbishkrimi: «Atdheu është i madh me madhësitinë e tij». Nëna na thoshte se pushka qëndronte e varur në mur qysh në kohërat më të vjetra; qysh atëhere, kur ne ende s'kishim parë dritën e djellit me sy. Ajo u zhduk bashkë me babanë atë mbrëmje të paharruar, kur ai iku dhe na la. Babai asnjëherë nuk e hiqte pushkën nga muri, ne bile mendonim se ai do ta kishte harruar fare përdorimin e saj. Po atë natë të paharruar, ai e hoqi nga muri dhe, kur ne pyetëm nënën, ajo na tha: «Babai ka ndërmend ta shesë pushkën». Ç'është e vërteta, që kur na kishin sulmuar francezët, pushkët vlerësoheshin me flori. Ne dëgjua rastësisht nënën një ditë kur i tha fqinjës se të gjitha armët i kanë rrëmbyer burrat që kanë dalë në mal.

... Njëri nga mysafirët e panjohur, pa hequr gjerdanin, u ul drejt e në rrogoz. Dy të tjerët hapën një arkë të vogël, që kishin prurë me vete, dhe filluan të mbushnin gjerdanët. Abu Hamidi u hodh e tha:

— Sikur ta ndiznim një herë, si thua Abu Muhamed?

Abu Muhamedi nënqeshi:

— Koka jote është vlerësuar shumë shtrenjtë nga oficerët francezë, ndërsa dëshira jote është shumë e vogël... Ti s'duhet të pish duhan, se të nget kolla.

— A e vlen barra qeranë të shqetësohesh për këtë, Abu Muhamed? Qysh se na kanë detyruar të rrokim armët, s'mendojmë më për veten tonë.

Motra ime e vogël, Amina, ju afua Abu Muhamedit dhe filloi t'i trazojë mjekrën e tij të gjatë. Kur ishte në shtëpi babai, asaj gjithmonë i pëlqente t'i fuste dorën në mjekrën e tij pyll të dendur. Kryengritësi e përqafoi me dhembshuri, e puthi dhe tha:

— Ti, moj vogëlushe bukuroshe, po më kujton bijën time.

— Sa fëmijë keni? — e pyeti nëna kryengritësin.

— Pesë... Si pëllumba i kam. Kur isha në shtëpi, më uleshin në gjunjë, mbi kurriz. Mallkuar qofshin armiqtë tanë! Të mos kishin qenë ata, do të jetonim pranë grave dhe fëmijëve tanë.

Nënës, si duket, ju kujtua babai, se u prek shumë dhe filloi të qajë. Edhe sytë e mi u mbushën me lot.

Kryengritësit nuk ishin njerëz të jashtëzakonshëm, diva, siç thuhej në legjendat e thurura. Ata ishin njerëz të zakonshëm, si babai. Duke i parë në shtëpinë tonë, unë zemërohesha me shokët e mi që më kishin krijuar një përfytyrim të gabuar rreth kryengritësve. Ata i përshkruanin kryengritësit si njerëz me trupa shumë të lartë, gjer në qiell, me shpatulla aq të gjera, sa mund të kthenin rrjedhën e një lumi të tërë, thoshin se mbanin në dorë thika të gjata shumë të mprehta, me të cilat u prisnin kokat armiqve nga larg.

Amina, tregoi me gisht gjerdanin e Abu Muhamedit. Duke belbëzuar nga emocioni, ajo pyeti:

— Përse ju duhen këto?

Kryengritësi i përkëdheli me dashuri kokën dhe ju përgjegj:

— Me këto mbrojmë lirinë tënde, bija ime.

Përsëri u dëgjuan të shtëna pushkësh. Abu Hamidi vrapoi në dritare, përgjoi një copë herë dhe ju drejtua Abu Muhamedit:

— Si duket, së shpejti na pret zjarri i betejës. Nisemi.

Nëna e zuri prej dore:

— Ne ç'të bëjmë, të ikim nga shtëpia?

— Jo, ju qëndroni, s'keni pse të ikni.

— Kemi dëgjuar sikur kryengritësit u mundën!?

— Përkohësisht. Po së shpejti armiqtë do t'i shporrim një herë e përgjithmonë.

Një shpërthim shurdhues u dëgjua aty afër. Ne u ngjitëm pas fustanit të nënës, sikur aty do të mbroheshim nga rreziku.

Kryengritësit ikën.

— Diell e paçi ngado që të shkoni, — pëshpëriti nëna, kur ata u larguan.

Pas kësaj ra heshtja. Dëgjohej vetëm trokëllima e patkonjve të kuajve, që sa vinte e largohej. Ne u trembëm dhe më shumë. Amina filloi të qajë. Nëna e qetësonte.

— Mos ki frikë, shpirti i nënës! Kryengritësit na mbrojnë të gjithëve.

Përsëri u dëgjuan gjëmime të fuqishme. Tani të gjithë s'mund t'i përmbanim lotët, përfytyronim kryengritësin, të madh sa një mal, me kokën deri në qiell dhe me thikën e gjatë në dorë, duke mbrojtur shtëpinë tonë.

Na zuri gjumi vetëm kur rrezet e para të mëngjezit ndriçuan dhomën tonë.

* * *

Na zgjoi një zhurmë. U hodhëm në dritare dhe s'mund t'u besonim syve: babai, i lodhur, tërë pluhur, i armatosur me pushkën e tij, i gëzuar, përqafonte nënën

dhe qeshte i lumtur. Pranë tij hingëllinte kali ynë i kuq. Menjëherë fluturuam në oborr.

— Domethënë edhe babai ynë paska luftuar, — tha vëllai.

S'arrita t'i përgjigjem, se babai më mori dhe më shtrëngoi fort në gji.

— Tani, Mustafa, mund të shkoni përsëri të lozni në lumë. Brigjet e tij janë qëruar nga armiqtë.

FEMIJËT E PARMES

Në Gjenovë, në sheshin e vogël përpara stacionit të hekurudhës, është mbledhur një turmë e madhe populli, sidomos punëtorë, po ka edhe shumë njerëz të veshur mirë, të bëshëm, shenjë që tregon se kanë e pinë mirë. Në krye të turmës gjenden anëtarët e këshillit bashkiak; mbi kokat e tyre valavitet flamuri i mëndafshhtë dhe i rëndë i qytetit, i qendisur shumë bukur, dhe përkrah tij valaviten flamurët me ngjyra të ndryshme të organizatave punëtoare. Shndrijnë xhufkat e arta, thekët dhe shiritët; ndrisin shtizat e flamurëve, shushurin mëndafshi; turma e njerëzve me pamje solemne gumëzhin si një kor që këndon me gjysmë zëri.

Mbi turmën, i vendosur në një pedestal të lartë, ngrihet monamenti i Kolombit, i atij ëndërrimtari që vuajti shumë për atë që besonte dhe doli fitues pikërisht sepse besonte. Tani ai vështron nga lart njerëzit, sikur u thotë me gjuhën e tij të mermertë:

«Fitojnë vetëm ata që besojnë».

Në këmbët e tij, rreth pedestalit, muzikantët kanë mbështetur trompetat e remta, që shkëlqejnë si ar në rrezet e diellit.

Ndërtesa e rëndë prej mermeri e stacionit, e përkulur si një gjysmë rrethi, ka hapur krahët sikur kërkon të përqafojë njerëzit. Nga skela dëgjohen frymëmarrjet e rënda të vaporëve, zhuzhërime e mbytur e elikave që çajnë ujin, vringëllima zinxhirësh, fërshëllima dhe të thirrura; në shesh zotëron qetësia, dielli djeg e përvëlon.

Në ballkonet dhe në dritaret e shtëpive duken gra me lule në duar, fëmijë të veshur si për ditë feste, si trumba lulesh.

Stacionit po i afrohet me fërshëllima një lokomotivë; turma u drodh, mbi kokat fluturuan si ca zogj disa kapele të zhubrosura, muzikantët muarën trompëtat; disa njerëz hijerëndë, të shkuar nga mosha, bënë një çap përpara, duke nxjerrë gjoksin dhe i folën turmës duke tundur duart djathtas dhe majtas.

Turma u tërhoq rëndë-rëndë, pa u ngutur, e hapi një shteg të gjerë në rrugë.

— Cilin prisni?

— Fëmijët e Parmës!

Në Parmë ka plasur greva... Padronët ngulin këmbë, punëtorët gjenden ngushtë. Dhe ja tani, ata mblodhën fëmijët e tyre që nisën të vuanjë nga uria dhe ua dërguan shokëve të tyre në Gjenovë.

Që përtej shtyllave të stacionit dalin në rreshta fëmijë të vegjël, gjysëm të zhveshur; duken si të kërleshtë me ato zhelet e tyre, po të kërleshtë, sikur janë bisha të vogla, të çuditshme. Ecin dorë për dorë, nga pesë në një rresht: janë shumë të vegjël, të pluhurosur, të kapitur, fytyrat e tyre janë serioze, po sytë u shkëlqejnë me gjallëri. Janë të kthjellët dhe, kur muzika i pret me hymnin e Garibaldit, në këto fytyra të dobëta, të holla dhe të uritura shihet një buzëqeshje e gëzuar.

Turma i përshëndet njerëzit e së ardhmes me një thirrje shurdhuese, para tyre përkulen flamurët, buçasin trompetat e remta, duke i shurdhuar dhe verbuar fëmijët. Duken pak si të hutuar nga kjo pritje; për një çast prapsen dhe përnjëherësh drejtojnë trupin, sikur rriten, bashkohen dhe shndërrohen në një trup me qindra zërash, thërresin me tingullin e një kraharori të vetëm:

— Viva Italia!¹⁾

— Rroftë Parma e re! — bubullon turma dhe u vërsulet mysafirëve.

1) Rroftë Italia!

— Eviva Garibaldi!) — thërrasin fëmijët: ata luten si një pykë ngjyrë hiri në mes të turmës dhe zhduken në këtë turmë.

Entuziazëm i madh, gjallëri e madhe; mermeri i përhimtë duket më i ndritur.

Valëviten flamurë, ngrihen në erë kapele dhe lule, mbi kryet e njerëzve ngrihen kokat e vogla të fëmijëve, duken duar të vogla, që kapin lulet dhe përshëndesin. Dhe në ajër bubullon papushuar një thirrje e pareshtur dhe e fortë.

— Viva il socialismo!2)

— Eviva Italia!3)

Pothuaj të gjithë fëmijët i kanë ngritur në krahë; tani qëndrojnë në supet e njerëzve të rritur ose të mbështetur në gjokset e gjera të disa njerëzve të rreptë dhe mustaqemëdhenj; muzika mezi dëgjohet në mes të zhurmës, të të qeshurave dhe të thirrjeve.

Gratë ngashërehen, duke marrë fëmijët që kanë mbetur, dhe i thërrasin njëra tjetrës:

— Anita, ti do të marrësh dy?

— Po. Edhe ti?

— Do të marr dhe një për atë Margeritën pa këmbë...

Kudo entuziazëm, fytyra të gëzuara si në ditë feste, sy mirëdashës, të njomur nga lotët. Aty këtu sheh se fëmijët e grevistëve po mbllaçitin ndonjë krodhë bukë.

— Në kohën tonë s'kishte gjëra të tilla! — thotë një plak me një hundë shpendi dhe me një puro të zeze në gojë.

— Punë e thjeshtë...

— Po! E thjeshtë dhe me mend.

Plaku nxori puron nga goja, vështroi majën e saj, psherëtiu dhe shkundi hirin. Pastaj, duke parë pranë tij dy fëmijë të ardhur nga Parma, me sa duket vëllezër, u vrënjt, u zgërdhesh — në këtë mes fëmijët e vështronin

1) Rroftë Garibaldi!

2) Rroftë socializmi!

3) Rroftë Italia!

me seriozitetin më të madh — ngjeshi kapelen në kokë, hapi krahët: fëmijët u ngjeshën njëri pranë tjetrit, u bënë të zymtë dhe u tërhoqën një çap, po plaku u ul përnjëherësh në gjunjë dhe këndoi si gjel. Fëmijët qeshën, duke kërcyer nëpër gurët me ato këmbët e tyre të zbathura. Pastaj plaku u ngrit, ndreqi kapelen dhe, duke thënë me vete se kishte bërë atë që duhej të bënte, shkoi më tutje, duke shkelur me këmbët e tij të dobëta.

Një grua e kërrusur, me një fytyrë me ca flokë të thinjura, të ashpra, në mjekrën tërë kocka, qëndron më këmbë pranë statujës së Kolombit dhe qan duke fshirë sytë e skuqur me cepat e një shalli që i ka dalë boja. E vrenjtur dhe e shëmtuar, kjo grua duket çuditërisht e vetmuar midis turmës të entuziazmuar të njerëzve.

Kalon me çap të lehtë, sikur hedh valle, një gjenoveze flokëzezë, duke mbajtur për dore një goxha djalë shtatë vjeç, me nallane dhe me një kapele ngjyrë hiri, që i zbret gjer te supet. Ky tund kokën për të larguar kapelen, po kapelja i bie orë e çast mbi ballë; grua ja merr kapelen nga koka, e ngre lart, e tund dhe qesh e këndon, vogëlushi e vështron duke ngritur kokën i gëzuar, kërcen disa herë duke u munduar të kapë kapelen, dhe pastaj, të dy, grua ja dhe vogëlushi, zhduken në mes të turmës.

Një burrë i gjatë, me një përparëse prej lëkure, me ca duar të mëdha, mban në sup një vajzë nja gjashtë vjeç, të hirtë, si një kocomi, dhe i thotë një gruaje që ecën përkrah tij, duke mbajtur përdore një vogëlush flokëkuq si flaka e zjarrit.

— Më kupton? Në qoftëse do të vazhdojmë kështu... vështirë do ta kenë të na mposhtin... Ë?

Dhe qesh me zë të trashë, të fortë, të gëzuar, e lëkund vajzën që ka në sup, e hedh në erë dhe thërrret:

— Evviva Parma-a!1)

1) Rroftë Parma!

Njerëzit shkojnë duke patur me vete fëmijë, në sheshin përpara stacionit kanë mbetur lule të shkelura, copa letre bombonësh, një trumbë e gëzuar hamësh dhe mbi ta qëndron fytyra fisnike e njeriut që zbuloi Botën e Re.

Dhe nëpër rrugët, si nga disa trompeta shumë të mëdha, derdhen thirrjet e gëzuara të njerëzve që shkojnë përpara, drejt jetës së re.

NË DITËT E PARA TË TETORIT

Ishin ditët e para të Revolucionit të Tetorit. Në Petrograd gjendja ishte e nderë. Të gjithë prisnin diçka. Smolni gumëzhinte nga populli.

Në Smolni u vendos shtabi kryesor i bolshevikëve: Komiteti ushtarak — revolucionar. Këtu ndodhej edhe Lenini. Ai përshëndeste më buzë në gaz të gjithë njerëzit që hynin dhe dilnin. I pyeste për të gjitha ngjarjet e ditës, po më tepër pyeste se ç'bëhej në Pallatin e Dimrit dhe në hyrjet e tij.

Lajmi se Lenini ishte në Smolni, u përhap midis bolshevikëve si rrufe. Shumë njerëz që kishin dëshirë të shikonin Leninin, erdhën këtu. Në dhomë filluan të hidhnin sytë edhe të huajtë. Këtu përpiqeshin të hynin sidomos korespondentët e gazetave të ndryshme, duke mos përjashtuar edhe ata të gazetave të huaja. Ata, siç duket, e vunë re se në këtë dhomë hyjnë shumë njerëz e se këtu vepron qendra udhëheqëse e kryengritjes.

Ishte e domosdoshme të vendosej një mbrojtje e sigurtë. Në njërën nga sallat e Smolnit zunë vend më tepër se pesëqind punëtorë të armatosur. Këta ishin ushtarët e Rojes së Kuqe.

Nga këta u vendos të zgjidheshin vetëm shtatëdhjetë e pesë njerëz, që do të ishin për mbrojtjen e Smolnit.

Një punëtor tridhjetëvjeçar, një bukurosh i ri me flokë të dredhur, që i dilnin nga shapka, me qetësinë më të madhe dha urdhërin:

— Radhitu!

Në çast të gjithë zunë vendet e tyre. Pastaj ra një heshtje e tillë, sa nuk ndihej as miza. Nëpër dyert, rojet qëndronin si të ngrirë. Komandanti njoftoi se duhe-shin shtatëdhjetë e pesë veta që të ishin gati për çdo gjë, bile edhe për vdekje.

Të pesëqind punëtorët e armatosur bënë një hap përpara dhe ngrinë në vend. Komandanti zgjodhi njerë-zit, emëroi përgjegjës in dhe dy zëvendësit.

— Për çdo rast... — tha ai i vrëjtur dhe heshti. Menjëherë përgatitën lejet e kalimit. Lejen Nr.1 ja dhanë Leninit.

— Ç'është kjo? Leje? Pse? — pyeti Lenini.

— Duhet për çdo të papritur... Mbrojtja e Smol-nit u krijua. Ju lutemi vështrojeni...

Lenini zgjati kokën në derë dhe pa njerëzit që qëndronin në rresht.

— Ju lumtë! Ta ka ënda t'i shohësh! — tha Leni-ni me admirim.

Rojet qëndruan në derën e hyrjes, brenda dhe jashtë dhomës. Përgjegjësi, pa humbur kohë, vendosi lidhjen me repartin qëndror.

Njerëzit venin e vinin papushim.

* * *

Lenini ishte shumë i shqetësuar që rrethimi i Pa-llatit të Dimrit, ku shumë forca kundërrevolucionare ruanin Qeverinë e Përkohshme, po zgjatej.

Rojet e kuqe, marinarët dhe ushtarët revolucionarë, pa humbur kohë, duke vrapuar pa u ndalur, zunë shtigjet që të shpinin në Pallatin e Dimrit. Filloi sul-mi, i cili vazhdoi disa orë.

Kryqëzori «Aurora» u afrua dhe u ndal në lumin Neva. Ai kishte urdhër t'i kthente topat kundër Palla-tit të Dimrit. Krismat e topavet të «Aurorës» lajmë-ruan fillimin e sulmit. Rojet e kuqe, marinarët dhe

ushtarët revolucionarë, me një goditje të fuqishme, hapën dyert e mëdha të Pallatit, hynë brenda me forcë dhe zunë të gjitha hyrjet e daljet. Natën e 25 Tetorit, duke gdhirë 26 (sipas kalendarit të ri është nata e 6 Nëntorit duke gdhirë 7), Pallati i Dimrit u muar nga trupat bolshevike të revolucionit. Qeveria e Përkohshme u arrestua dhe u burgos. Kryetari i qeverisë, Kerenski, i veshur si grua, u largua nga pallati nga një dalje e fshehtë dhe iku me automobilin e ambasadës amerikane

* * *

Me hap të shpejtë ushtarak nxitonte nëpër koridor një ushtar i armëve të motorizuara, i veshur me xhakëtë dhe pantallona prej lëkure. Ai kishte hedhur në sup çantën e udhës dhe e mbante me dorën e majtë.

— Këtu është shtabi i Komitetit ushtarak - revolucionar? — pyeti ai dy gardistë të kuq, që bënë roje në derë.

— Cilin kërkon?

— Leninin! Kam për t'i dorëzuar diçka.

Roja u kthye dhe i tha shokut:

— Duhet thirrur oficeri i rojes. Ka ardhur një korier. Pa leje... për në shtab. Kërkon Leninin...

Doli oficeri i rojes. Pyeti korierin nga vjen e kush e ka dërguar.

— Nga Pallati i Dimrit... Nga komandanti Podvojski.

— Shkojmë...

— Kam për të dorëzuar diçka, — tha korieri duke hyrë në derën e dhomës fqinjë. — Më duhet Lenini. Lenini ju afrua.

— Ç'kishit për të më dorëzuar, shok?

— Ju qenkeni Lenini!

Ushtari e pa me habi Leninin dhe sytë e tij

shndritën me gëzim. Hapi çantën me të shpejtë, gjeti fletën e letrës dhe ja dorëzoi me kujdes Leninit, e nderoi si ushtarët dhe tha shkurt:

— Raport!

— Ju faleminderit, shok, — ju përgjegj Lenini dhe zgjati dorën.

Ai, i hutuar, ja shtrëngoi dorën Leninit me të dy duart. Qeshte. Përsëri e nderoi si ushtarët, bëri gjysmë rrotullimin dhe me një hap të gjallë u largua.

— «Pallati i Dimrit u muar. Qeveria e Përkohshme u arrestua. Kerenski iku!» — Vladimir Iliçi lexoi shpejt me zë raportin.

Sapo mbaroi së lexuari letrën, buçiti një «urra», që pastaj u përhap nga rojet e kuqe në dhomën fqinjë.

— Urra! — u dëgjua në të katër anët.

* * *

Në orën katër të natës, të kapitur, po të emocionuar, u larguam nga Smolni. Unë i thashë Leninit të shkonim për të fjetur në shtëpinë time. Telefonova me kohë në repartin ushtarak dhe i ngarkova që të kontrollonin rrugët.

Ne dualëm nga Smolni. Qyteti ishte pa dritë. Hipëm në automobil dhe shkuam në shtëpinë time.

Lenini, siç duket, ishte shumë i lodhur, se po dremiste në automobil. Darkën e hëngrëm dosido. U përpoqa dhe bëra gjithçka që Lenini të pushonte. Mezi ja mbusha mendjen që të zinte krevatin tim në një dhomë jo shumë të madhe, po të veçantë, ku kishte tryezë shkrimi, letër, bojë dhe bibliotekën, gjëra që atij mund t'i duheshin. Lenini më në fund pranoi dhe ne u ndamë.

Unë rashë në divan në dhomën fqinjë dhe vendosa të fle vetëm atëhere kur të bindesha se Leninin e kishte zënë gjumi.

Pak më vonë, Lenini e fiku dritën në dhomën e vet. Mbajta vesh: «E zuri gjumi vallë?». Nuk ndihej

asgjë. Fillova të dremisja. Po ja, sapo më zinte gjumi, papritur në dhomën e Leninit u ndez drita.

Hapa sytë. Dëgjova se Lenini, pa bërë zhurmë fare, u ngrit nga krevati mengadalë, hapi pak derën time dhe, kur u bind se unë «flija», shkoi në tryezën e shkrimit me hapa të lehtë, në majat e gishtave, që të mos zgjonte njeri. U ul, hapi shishen e bojës dhe u thellua në punë. Të gjitha këto unë i shihja nga dera gjysmë e hapur.

Lenini shkruante, disa herë u hiqte vizë atyre që kishte shkruar më sipër, lexonte, kopjonte diçka nga ndonjë libër, përsëri shkruante dhe më në fund hidhte në të pastër punën e bërë.

Filloi të agojë mëngjezi i vonë i vjeshtës së Petrogradit. Në këtë kohë Lenini fiku dritën, u shtri në shtrat dhe e zuri gjumi. Humba dhe unë.

Në mëngjez ju luta të gjithëve të shtëpisë që të mbanin qetësi, sepse Lenini kishte punuar gjithë natën dhe padyshim ishte mjaft i raskapitur.

Po ja, u hap dera dhe ai doli nga dhoma i veshur, energjik, i gjallë dhe i qeshur.

— Gëzuar ditën e parë të Revolucionit Socialist!
— na uroi të gjithëve.

Në fytyrën e tij nuk shihej asnjë gjurmë lodhjeje, sikur të kishte fjetur shumë mirë, kurse në të vërtetë kishte fjetur e shumta dy - tri orë pas njëzet e katër orë pune të lodhshme.

Erdhën shokët. Kur u mblodhëm për të pirë çaj, Lenini nxori nga xhepi fletët e shkruara në të pastër. Ai na lexoi «Dekretin e tokës», atë dekret të famshëm, që e kishte shkruar në këto ditë vendimtare.

Për Smolni u nisëm në këmbë, pastaj hipëm në tramvaj. Leninit i shkëlqente fytyra nga gëzimi, kur shikonte në rrugë atë rregull shembullor.

Në mbrëmje, në Kongresin e dytë të Sovjetëve të të gjithë Ruisë, si u pranua dekreti për paqën, Lenini, me një rrjedhshmëri të veçantë, lexoi me zë dekretin për tokën, i cili u prit me entuziazëm dhe njëzëri nga gjithë Kongresi.

SHETITJA

Në kohën që Lenini ishte sëmurë, vinin shumë letra dhe delegacione punëtorësh. Të gjithë shqetësoheshin, pyesnin për shëndetin e tij. Kur u përmirësua dhe filloi të ngrihej, bile të dalë edhe shetitje, ne ju përgjigjeshim se Lenini po shërohet. Ky ishte një lajm shumë gazmor, po punëtorët përsëri nuk ishin të qetë: shumë mirë që po shërohet, po kur vallë do ta shohim?

Pyetëm mjekët se kur mund të flasë Lenini në ndonjë miting. Ata na thanë jo para tre muajve. Prandaj ne menduam që Leninin ta merrnim në film dhe këtë punë ja besuam Bolltjanskit. E porositëm që të vepronte në mënyrë të atillë, që Lenini mos të merrte vesh gjë, ndryshe nuk do të pranonte. Ne u muarëm vesh me Bolltjanskin që ndonjë ditë të mirë me diell të vinte në Kremlin bashkë me operatorët e tij dhe ti shpërndante nëpër qoshet e rrugicës së asfaltuar, e cila kalonte anash ndërtesës së arsenalit dhe vazhdon-te deri te «Topi - mbret». Këtu shetiste zakonisht Lenini.

U muarëm vesh ta kryejmë sa më shpejt këtë punë kaq të rëndësishme, pastaj ta prodhohim filmin në shumë kopje dhe t'u tregonim kështu punëtorëve dhe gjithë popullit Leninin duke shetituar në Kremlin.

Ishte një ditë e bukur vjeshte e vitit 1918. Bolltjanskin e lajmëruam me telefon që të përgatitej, nga ana tjetër Leninit i thamë që rreth orës një të mesditës

duhej të dilte patjetër të shetiste, sepse këtë e këshillonin mjekët me këmbëngulje.

Lenini pranoi.

Në orën e caktuar Leninit ja kujtuan përsëri se duhet të shkojë të shetisë. Ai u ngrit shpejt, mori kasketën dhe tha:

— Po dal pa pallto, sot dita qenka shumë e bukur.

Bolltjanski ishte paralajmëruar nga shokët tanë se Lenini do të dilte. Duke biseduar për punën e përditshme, ne dualëm nga banesa dhe u drejtuam për në rrugicën e asfaltuar.

Në film janë marrë të gjitha, duke filluar nga casti i daljes së Leninit e deri kur u kthye në shtëpi.

Ne ecnim duke biseduar si zakonisht. Në këtë kohë operatorët, nga të gjitha drejtimet, merrnin në film çdo hap, çdo lëvizje të Leninit. Ata kishin frikë se mos ai i shihte dhe atëhere filmi do të ndërpritej, se Lenini mund të mos shetiste më. Prandaj përpiqeshin të mos diktoheshin

Unë, pak nga pak, fillova të largohesha nga Lenini me qëllim që atë ta merrnin vetëm në film. Po kjo nuk shpëtoi nga vështrimi i tij. Ai tha:

— Pse largoheni?... Nëqoftëse do të shetisim, atëhere shetisim së bashku!

Unë menjëherë ju afrova dhe vazhduam bisedën. Kështu shkuam deri te «Topi - mbret». Ju luta të vazhdonim më tutje, po Lenini tha:

— Me gjithë qejf, po nuk mundem. Deri në orën katër më duhet të shkruaj diçka dhe të pres dy shokë që do të vijnë.

U kthyem. Si bëmë disa hapa, Lenini tha papritur:

— Shikoni, atje se kush vrapon dhe mban diçka në shpinë... Po ai qenka operator filmi...

— Po, po, vërtet, — ju përgjegja unë. — Ai është operator dhe si ai këtu ka shumë. Ju muarën në film, shoku Lenin.

— Po kush ju lejoi? — pyeti ai. — Dhe pse nuk më paralajmëruat?

— Sepse ju nuk do të pranoni t'ju merrnin në film, kurse kjo është e domosdoshme.

— Kështu, domethënë ma hodhët... Si u bë kjo kështu? — më pyeti si me qërtim.

— Hera e parë dhe e fundit në jetë, shoku Lenin! Po ja që duhet patjetër t'ju shohin punëtorët. Të gjithë janë të gëzuar që po shëroheni, dëshirojnë t'ju shohin, fundja edhe në kinema. Pa kaluar tre muaj ju nuk mund të flisni para popullit.

— Mirë, e zëmë se është kështu, — kundërshtoi Lenini.

— Kështu thonë mjekët, kurse punëtorët janë të shqetësuar. Prandaj vendosëm t'ju marrim në film në shetitje dhe filmin ta çfaqim në fillim në të gjitha klubet e punëtorëve. Kjo është shumë e nevojshme për klasën punëtore.

— Nëqoftëse duhet, atëhere tjetër punë, mëkatin e latë...

Qeshëm, biseduam se si e kishim rregulluar gjithë këtë punë dhe shkuam më tutje të gëzuar dhe duke folur me gjallëri.

— Këtu ju paskeni një mori të tërë operatorësh!... Më gënjyet me dhëlpëri, — tha Lenini me dashamirësi.

Operatorët e filmit, kur panë se «komploti» u zbulua, dolën nga strehët e tyre dhe muarën në film të gjitha skenat e këtij bisedimi.

Më kujtohet se këto skena ishin veçanërisht të goditura mirë, sepse Lenini kishte dalë i qeshur dhe i gëzuar.

Edhe çastet e tjera ishin të gjalla dhe tërheqëse.

Kur Bolltjanski i tregoi Leninit në sallë të gjithë filmin, atij më tepër i pëlqyen pamjet te «Topi-mbret».

Pas disa kohësh, dokumentari, i titulluar «Lenini duke shetitur në Kremlin», u çfaq në fillim në kinematë e lagjeve të punëtorëve në Moskë, pastaj kudo. Gëzimi i spektatorëve ishte i papërshkruar. Kur në ekran dukej Lenini, të gjithë ngriheshin në këmbë, duartrokisnin për një kohë të gjatë dhe brohorisnin:

— Rroftë Lenini!

NENË E BIJË

E gjetën në rrugë. Në fillim menduan se vajza ishte e vdekur dhe Grisha ktheu timonin që të mos shtypte këmbët e saj të zbathura. Ajo ngriti pak kokën, era ja mori flokët si bar i thatë. Grisha e ndali maqinën. Juri, që ishte ulur me të, kërceu nga kabina e u përkul mbi vajzën.

— Hip në kamion.

Ajo lëvizi, u përpoq të ngrihej me këmbë e me duar, po ra përsëri në ije, në baltën e rrugës. Fytyra e saj e dobët, me qepalla gjysmë të mbyllura, ishte e sëmurë dhe e uritur. Juri hodhi sytë rreth e përçark; në stepë, nën retë e lagura pranverore, nuk dukej gjëkund asnjë banesë.

— Kështu! E qartë! — tha me inat Juri, megjithëse asgjë të qartë nuk kishte dhe e ngriti vajzën.

Ajo vari kokën në supin e tij, po pastaj menjëherë e mblodhi në mes të supeve si e trembur. Edhe kokat dukej sikur i kishte bosh, aq e hollë dhe e lehtë ishte. Juri e uli në kamion, mbi një mushama të hapur në mes të arkave me municion, kërceu në kabinë, përplasi derën me xham të ndotur e të shpuar nga plumbat.

— Jepi më shpejt. Po vonohemi.

Grisha, duke rrotulluar timonin, tha:

— Kjo do ta ketë shtëpinë diku afër, kurse ne, drejt e di ku e shpiem.

Si kaluan nja pesë kilometra, Juri u përgjegj me

zë të çjerrë, si me përtaci, ashtu si ishte mësuar të fliste gjatë kohës së luftës:

— Më çudit aparati yt mendor.

Nga rruga kthyen në një arë pa fund: rrotat zhyteshin në baltën e zezë, motori që nxehur shumë, po më në fund arritën gjer te shtylla në rrëpirë; kaluan tatëpjetën e madhe dhe ndaluan afër baterisë së mbuluar përsipër me rrjeta.

— Vështirë të ketë mbetur gjallë, — tha Grisha duke fshirë me mëngë djersën e ballit.

Po vajza ishte gjallë. U futën në kabinë dhe Grisha i tha rreptë:

— Shiko, mos i nga veglat, rri urtë.

Porosia ishte e kotë; asaj i kishte mbetur vetëm një shkëndijë jete nën atë fustan të hollë basmaje. Juri vështroi gjatë me sy të ftohtë atë fytyrë të hequr, me dy rrudha pleqërie, me qoshet e gojës gjysmë të hapura. Kur artilierët mbaruan shkarkimin, ai shkoi në strehim.

Te hyrja e blindazhit, në një arkë municioni, ishte ulur kapiteni, komandanti i baterisë, me fytyrë të rruar, të kuqe, tamam si të përcëlluar; ai thëthinte tymin me kënaqësi nga një çibuk i shkurtër.

— Sa qetësi është te ne! — i tha Juri. — Dëgjohen laureshat. Në mëngjez na erdhën, të mallkuarit.

— Si shkoni? — pyeti Juri.

— Ja, natën i gostitëm gjermanët me prushe të përvëlura. Dëshironi të hidhni një sy: pesë tanke dhe dy sulme psikologjike. Nga kodra duken rezultatet e pasura...

Si dëgjoi me respekt kapitenin, që s'e kishte marrë veten ende nga puna e natës, Juri pyeti:

— A keni në bateri bombone trofe ose çokollata?

— Çokollata? — u çudit kapiteni dhe hoqi çibukun nga goja. — Për herë të parë po dëgjoj që një togeri në stepën e zhveshur t'i duhen çokollata.

— Kam një vajzë të vogël në maqinë.

— Po kështu thuaj, de. Duhet pyetur zbuluesit, ata sjellin shpesh çokollata.

Ata shkuan te kamioni. Kur pa atë fëmijë të munduar, kapiteni rrudhi me keqardhje fytyrën e kuqërremtë.

— Si të quajnë? Ë? Nga je? E kujt je? — pyeti ai me zë të trashë, të ngjirur.

Vajza nuk përgjigjej, po fuste kokën në mes të supeve.

— E kanë rrahur, — tha kapiteni. — E qartë... Ah, të poshtrit!... — Dhe psherëtiu ngadalë, se ju kujtua familja e tij, e shtypur dhe e dërmuar nga gjermanët. — Do të jetë nga fshati Vladimirsk, nga ajo anë... Ç'mendoni të bëni me të? (Juri mblodhi supet). Këtu në bateri ka shumë zhurmë për të... Ejani të kërkojmë çokollata.

— Mos, mos, — pëshpëriti vajza me një zë që mezi dëgjohej, po kapiteni, Juri dhe Grisha, përpiqeshin t'i fusnin në gojë një copë çokollatë.

Që të tre i kishin gishtrinjtë të trashë, të ashpër, kurse vajza e kishte gojën të vogël, kishe frikë t'ja zije me dorë. Ata përpiqeshin, mundoheshin t'i mbushnin mendjen. Më në fund ajo ndjeu ëmbëlsirë në buzët e përlyera me çokollatë dhe hapi pak dhëmbët. Kapiteni, i gëzuar, i futi gjysmën e çokollatës.

Vajzën e vunë me Grishën në kabinë. Juri ndenji prapa në kamion, për të vështruar qiellin. Kamioni u nis për rrugë, duke u hedhur nga një anë në tjetrën dhe duke nxjerrë tym të zi. Grisha, më në fund, vuri re se vajza po e vështronte; domethënë çokollata e bëri punën e saj. Ajo u çel pak. Si i dha edhe gjysmën tjetër të çokollatës, Grisha i tha:

— Do flasësh ti, apo si e ke punën? S'je e vogël.

— Nuk do të flas, — u përgjegj ajo ngadalë.

— Po pse kështu? Ne jemi tanët. Thuamë emrin. Domethënë ti na qenke pa familje... Ku i ke nënën, babanë?

Vajza i ktheu shpinën dhe nuk e vështronte më, as çokollatën nuk e hëngri. Atë e rregulluan në strehim, në rrëpirën e pyllëzuar, ku, jo larg stacionit, ishte depoja me municion. Atje jetonin Juri, Grisha dhe

pesë ushtarë. Vajzës i sajuan një shtrat prej bari të mbuluar me kapotë. I lanë kokën te burimi dhe, si u lërguan që mos i vinte turp (vajza ishte nja dhjetë vjeç), i thanë të lante trupin me sapun. Juri i lau fustanin dhe ja arnoi. Ditët e para e ushqenin me kujdes, nga pak e shpesh, po meqenëse e ushqenin shtatë burra bashkë, kur i fushnin ndonjë send në gojë, ajo përsëriste! «Mos, mos...» Me ditë të tëra rrinte shtrirë në strehim, me fytyrë nga muri; si duket dremiste. Kur bënin shaka me të, ajo kthente krahët. Një mbrëmje, Jurit i ra ndërmend t'i thoshte një vjershë për fëmijë. Vajza e shikoi kaq rëndë e me qërtim, sa ai u dëshpërua e doli nga strehimi që të pinte një cigare.

— Ajo është e çmendur, — i tha Grisha, — s'është në rregull. Çoje në qytet, shtroje në ndonjë spital.

Këshilla ishte me vend. Po meqenëse e tha Grisha dhe jo ai vetë, Juri shfryu:

— Nuk është as e sëmurë, as e çmendur... Ta shkar-kosh veten nga një barrë, është puna më e thjeshtë... Në spital! Të nuhasë jodoform! Brenga e saj është e rëndë për shpatullat e një fëmije... Ja ç'ka ajo...

Në mbrëmje dhe në agim, në mes të yjeve, gumë-zhinin aeroplanët gjermanë. Nga stacioni dëgjoheshin gjënimet e kundërajrorëve dhe shpërthime të forta. Njerëzit flinin si zogjtë, me sy gjysmë të mbyllur. Një herë Juri dhe Grisha u kthyen në mëngjez, mezi hoqën çizmet dhe ranë pa ngrënë. Te krevati i Jurit u ul Vanja, mitralieri; ky rronte në rrëpirë si në shtëpi pushimi, sepse gjermanët nuk vinin asnjëherë atje.

— Dëgjon, ajo gjithë natën ka qarë si e madhe, — tha Vanja, — s'na la të flinin fare.

Juri vështroi si nëpër mjegull fytyrën e tij të mbushur dhe mendoi: «Sa lehtë të prishet gjumi ty!»... Ja ç'kishte ndodhur. Ditën e kaluar, vajza s'i qe ndarë një minutë Vanjës; ku vinte ai, atje shkonte dhe ajo, ai shkoi te mitralozi dhe ajo pas tij, u fsheh në mes të kaçubeve, gjersa Vanja e kërcënoi: «Maskohu, se

mos dukesh». Ajo u zvarris, u ul pranë tij (ai kishte zbërthyer karikatorin e mitralozit) dhe e thirri me ngadalë: «Vanja... «Ç'ke? Do të hash» Ajo përsëriti «Vanja» me një zë që mitralierit i shkuan mornica në trup.

Si dëgjoi këto në krevatin e tij, Grisha tha nëpër gjumë:

— Në rregull. Ju zbut zemra. Po si e quajnë, nuk e tha?

— Asgjë nuk tha tjetër, vetëm Vanja, më mërzi-ti gjithë ditën. Ndërsa gjithë natën s'pushoi së qari.

Të gjithëve, bile edhe Jurit, ju duk e natyrshme që zemra e vajzës të zbutet. Vanja ishte i thjeshtë, i ngadalshëm e zemërmirë, dhe me fjalët e sjelljet e tij i bindte të gjithë se gjithçka shkon mirë e do të rregullohet, prandaj edhe vajza u lidh me të, e ndiqte pas dhe deshi t'i qante hallin.

Po atë natë Juri u zgjua, ndezi elektrikun e dorës dhe pa vajzën që flinte me gjunjë të mbledhura; ajo kishte përqafuar jastëkun e mbushur me bar, qante në gjumë e thërriste me zë të mbytur: «Nënë, nënë, ku je?» Juri nuk e zgjoi, të paktën le ta gjente në gjumë nënën e saj... «Pse fshihesh, nënë?» Papritur vajza pushoi, mori frymë dhe briti me zë të mbytur e të gëzuar... Si duket e gjeti...

Vanja mitralieri mori gavetën dhe, duke kaluar nëpër mes kaçubeve, zbriti gjer në fund të rrëpirës, ku rridhte një përrua dhe ku në një vend formohej një vorbull. Kur kishte ndonjë minutë të lirë, atje mbliidhte gaforre.

Vanja hoqi gjimnastiorkën dhe këmishën, u shtri barkas ndanë përroit dhe filloi të kërktojë me duar në lym, nganjëherë kaq thellë, sa zhytte edhe kokën në ujë. Kur i zinte dora gaforre, Vanja murmuriste: «Më re në dorë Hans - Shpans sydali... S'të pëlqen?... Hajde, hajde në gavetë». Një herë hyri në ujin e ftohtë dhe, kur u ngrit, kishte në dorë një gaforre të madhe jeshile, që tundte bishtin. Pas kurrizit të Vanjës, një

zë i hollë e delikat qeshi me gëzim. Duke hequr me pëllëmbë ujin nga flokët e nga fytyra, ai ktheu kokën: po qeshte vajza... — Ç'bën ashtu? Si tallesh me një ushtar?

Vajza hapi sytë e kaltër, ngriti vetullat, i mblo-dhi sikur do të qante...

— Bëj shaka, Mashka, mos qaj.

— Unë nuk jam Masha, jam Vala, — u përgjegj vajza.

— Hë, hë, ja ku e the si të quajnë, — kështu, de.

— Vanjës i kërcisnin dhëmbët; veshi këmishën dhe gjimnastiorkën, u ul afër Valës, i pushtoi supet dhe e tërhoqi nga vetja. — Do hamë gaforre?

— Do hamë, — u përgjegj ajo.

— Më parë të ndezim një cigare. Mirë?

— Mirë...

Vanja grisi një copë gazetë, hodhi duhan nga një kuti teneqeje, e drodhi, e lagu me pështymë:

— Mos u zemëro me mua, Vala. Toger Juri më ka dhënë urdhër të mësoj gjithë të fshehtat e tua. Ai vërtet është i rreptë, po i drejtë; po të mos e zbatoj urdhërin, doemos do më bërtasë...

Vanja nxori nga xhepi «katjushën», e rregulloi, qëlloi tri herë gurin me një copë hekur dhe ndezi cigarën. U përhap era e këndshme e eshkës.

— Hajde, hajde, rrëfe...

Nga tregimet e shkëputura të Valës (atë ditë dhe ditët e tjera), ata mësuën: Vala jetonte me t'ëmën, Matrjona Hrabrovën, në fshatin Vladimirska. Vëllai i madh i Valës, Andrei, ishte në Ushtrinë e Kuqe, i vogli, Misha, vitin e kaluar, kur e pushtuan fshatin gjermanët, kishte humbur pa lënë gjurmë.

Matrjona Hrabrova kishte shumë frikë nga një njeri dhe, kur e shihte atë nga dritarja, thoshte me zemërim: «Përsëri po shkon nëpër shtëpitë, i paudhi, s'e ha mortja...» Kur Vala pyeste: «Nënë, pse e quan Mihej Ivaniçin të paudhë?» nëna përgjigjej: «Kur të rritesh, do ta marrësh vesh... Ti, Valka, më mirë mbylle

gojën... Ç'thotë nëna në shtëpi, mos i nxirr jashtë... Ki mendjen...»

Ato rronin shumë keq. Kishin tri pula, dy të bardha, një të verdhë dhe një këndezi të mirë, që u jepte pulave gjithçka gjente. Matrjona i fshihte në vende të ndryshme nga gjermanët. Ajo thoshte:

— Në pranverë, kur të ngrohet koha, pulat tona do të bëjnë tri vezë në ditë, atëhere, bijë, do çelsh...

Një herë në agim, tri javë të shkuara, Matrjona e zgjoi vajzën.

— Bijë, — i tha ajo, — vish çizmet e mia, hidh shallin, ecë e shiko, pse është zemëruar këndezi, mos ka hyrë dhelpira në kotec?..

Vala veshi çizmet e nënës, hodhi shallin, doli në oborr dhe pa: dera e ahurit dhe dericka e kopshtit ishin të hapura, pulat s'ishin aty, vetëm gjeli vente e vinte me zemërim nëpër oborr.

Vala ofshani dhe hodhi sytë nga gardhi... Nga oborri po dilte një ushtar gjerman, që mbante pulat për këmbësh; atyre u vareshin krahët... Vala bërtiti, nxitoi pas ushtarit. Ai bashkë me pulat hipi në një kamion të mbuluar, që andej dëgjuan disa zëra të gëzuar dhe maqina u nis. Vala thirri: «Hej, hej, ato janë pulat tona...»

Në anën tjetër të rrugës, kërthazi izbës së Matrjonës, ishte shkolla e re prej qerpiçi. Pak kohë më parë kishte ardhur një maqinë me njerëz të veshur me kapota e kapele të zeza; bankat dhe librat i kishin hedhur në oborr, dritaret i kishin lyer me ngjyrë të bardhë, kopshtin e kishin rrethuar me tela me gjemba; kështu, shkolla qe bërë Gestapo. Banorët e Vladimirskut nuk kalonin kurrë afër atij vendi dhe Matrjona, kur donte të dilte nga oborri, kapërcente gardhin nga ana e rrugicës.

Vala, që kishte qëndruar në rrugë, pa Mihej Ivanoviçin kur doli nga Gestapoja; ai zbriti nga shkallët, kaloi pranë rojes dhe, si i pirë, u largua duke u tundur. Fytyrën e kishte mavi, kështu ju duk Valës, gjithë rrudha, sikur t'ja vriste drita sytë, kur ju afrua Valës, u ndal dhe i nguli sytë e tij të paturpshëm.

— Ti ç'bën këtu? Më gjurmon mua? Ah, qelbë-sirë! — E qëlloi Valën në kokë dhe përpiquej ta godiste me çizme, po nuk e zinte.

Ndërkohë Matrjona kishte dalë, po bërtiste me zë të ashpër dhe i nguli thonjtë në fytyrën e rrumbullaktë të Mihejit: «Përse e qëllove vajzën time? I paudhë, i mallkuar».

Këtë Mihej nuk ja fali nënës së Valës. Natën, në izbën e tyre hynë dy ushtarë të zinj me elektrik dore dhe qëndruan te dera. Erdhi një oficer me qafë të gjatë, me fytyrë të vogël pa mjekër dhe pas tij Mihej Ivanoviçi.

Matrjona u drodh, u mbështet te soba dhe pëshpëriti: «Më erdhi fundi, bijë...» Mihej shkëputi dorën e Valës nga dora e nënës, e shtyu Valën në të ndarën tjetër, ku ishte krevati.

— Urdhëroni të bëjmë kontroll, zoti toger?

Oficeri u ul në tryezë dhe u përgjegj ngadalë rusisht:

— Bën punën tënde.

Nga e çara e derës Vala pa se Mihej hipi në minder dhe diçka po kërkonte.

— Ashtu është, zoti toger, këtu ka një letër nga i biri, Mishka...

Vala dëgjoi si u përgjegj nëna ngadalë e qartë:

— Letra është vënë me qëllim... Më besoni mua, zotni... Biri im, Mihaili, ka humbur që vitin e kaluar, këtë e di gjithë fshati... S'mund të ketë letër nga ai...

Oficeri nxori kutinë e bardhë të cigareve, e hapi, që andej doli menjëherë një cigare dhe një flakë e vogël. Mihej tha:

— Hi-hi, dhelpër, s'ke ç'thua...

Oficeri nderoi cigaren, buzën e sipërme e kishte më të gjatë se të poshtmen, mbështeti brrylet në tryezë dhe filloi të lexonte letrën. Mihej u shtrëmbërua i tëri dhe i përshpëriti:

— Letra është e atij, e Mishkës, ai është zbulues në një repart dhe ka lidhje me nënën... Ndërsa djali tjetër,

Andrei, kapërcen frontin me aeroplan dhe vete te partizanët...

— Më besoni, zotni, ai nuk mund të më shkruajë mua, unë jam analfabete.

— Tani do ta marrim vesh, e mësuar je apo analfabete... — Oficerit papritur i kërcyen damarët në qafën e gjatë. — Nuk do të humbas kohë me ty. Të këshilloj të thuash të vërtetën menjëherë, përndryshe dhembja do të jetë e tmerrshme. Ai ktheu kokën nga ushtarët e zinj. — Bëni gati litarin, karrigen, mangallin. — Dhe menjëherë ua nguli sytë, që ja mbulonte hija e strehës së kapelës së madhe të rrasur në kokë, duarve të mavijosura të Matrjonës, të kryqëzuara në bark...

Pastaj filloi ajo që Vala nuk mund t'ja rrëfente as Vanja mitralierit: asaj i kërcisnin dhëmbët, i zihej gryka dhe nuk nxirte dot fjalë, po vetëm piskatte si mi.. E megjithatë, ata kuptuan se Vala atëhere kishte dëgjuar për disa orë rresht, pas derës prej dërrase, torturat që i bënin nënës, rënkime, psherëtime, klithma dhembjeje, mërmëritje, që nuk ngjanin me zërin e nënës...

Të nesërmen, fqinja hyri fshehurazi në izbën e Matrjonës. Në dysheme pa gjurma gjaku. Valën e gjeti në dhomën tjetër mbi një dyshek, në mes të jastëkëve që i kishte kafshuar me dhëmbë. Vajza s'ishte në vete. Fqinja e mori në shtëpinë e saj. I vuri hurin derës së izbës së Matrjonës dhe i mbylli kanatet e dritareve.

Ditët ishin me zagushi, të lodhshme, pa erë. Rrugët ishin të mbuluara me pluhur nga varganet e panumërta të maqinave. Dielli përvëlonte nëpërmjet reve të pluhurit. Juri dukej rrallë në strehim; ai ishte dobësuar, nxirë, fliste nëpër dhëmbë me një zë të ngjirur, sa të mërziste. Të gjithë e kuptonin se stuhia e luftës po afrohej, gjer-manët diku po përgatitnin një sulm dhe se ai do të ishte i pamëshirshëm...

Erdhi kapiteni, komandanti i baterisë, fytyra i qe zgjeruar edhe më tepër, nga koka në këmbë kishte marrë ngjyrën e hirit të pluhurit. U ul në stol, te tryeza një-këmbëshe nën dushkun e vogël, hoqi kapelën me kënaqësi dhe kërkoi ujë burimi.

— Nga stacioni erdha te ty, — i tha Juri, — i keni gaforret shumë të mira, më jep pesëdhjetë copë. — Thirrri Valën dhe i përkëdheli faqet e rrumbullakosura. — Është çelur. Të kujtohet? As çokollatë nuk donte të hante. — Ai qeshi aq fort, sa Vala u praps pak. — Tani ha çdo gjë? Shumë mirë... Pa shko e na mblidh ca gaforre të mëdha...

— Për gjermanët ç'dëgjohet? — pyeti Juri. — Do zgjasë shumë kjo punë?

— Për pesë ditë presim... Gjermanët duken të shqetësuar. Në sektorin tim kanë përqëndruar një regjiment artilerie, e kanë dislokuar... Tani në vijën e parë kanë prurë reparte të zgjedhura; pothuaj të gjithë i kanë gjokset plot me urdhëra e medalje. Të zësh ndonjë «gjuhë»¹⁾ është shumë vështirë. Tanke, aeroplanë, sa të duash... Presim, presim... Mirë thua, u mërzitëm...

Duke nxjerrë hundën e gjatë përpara, Juri tha:

— Do t'i bëjmë të kërcejnë.

— Tamam, nuk është viti dyzet e një... S'do të shohin nga të venë...

Kapiteni e ndërroi fjalën me kënaqësi, kur Vala solli në shportë gaforret jeshile, që lëviznin me zemërim. Vuri kapelen, u ngrit, u drejtua:

— Mysafirë në bateri nuk mund t'ju ftoj... Dreqi e di, mund të fillojnë dhe sonte natën... Zbuluesit e rinj zunë urdhërin e tyre: u jepet tri ditë për rrethimin e Ushtrisë së Kuqe dhe katër ditë për asgjësimin e saj... Ne qeshëm... Epo, mbeçi me shëndet... Ndoshta nuk shihemi shpejt...

Tani pluhuri nuk ngrihej vetëm nga rrotat, gjithë horizonti në perëndim po mbulohej me tym të zi e gjëmonte.

Zhurma e aeroplanave të panumërt në qiell të shurdhonte veshët. Dhe kështu kalonin ditët, netët dhe javët.

Ato ditë e harruan fare Valën. Një herë erdhi Juri për cigare, faqet e rëna ja kishte mbuluar mjekra, sytë e thelluar sikur i qenë zbardhur. Ai vuri re se strehimi, ku

1) Ushtar armik për t'i marrë informata.

prej një jave nuk banonte asnjëri, ishte i fshirë, krevatet ishin të rregulluara, në sobën e ndryshkur ishte një tufë e vogël me lule të verdha. Vala qe ulur e po qepte ngadalë një këmishë kukullash; aty ishte shtrirë dhe kukulla e mbështjellur me leckë nga të maqinave, fytyrën e kishte prej letre, sytë të vizatuar.

— Tungjatjeta, Vala! Si ja çon, nuk ke frikë vetëm?

— Jo, nuk kam frikë, xhaxhi Juri.

— Po si bën pa një çikë gjë të ngrohtë?

— Shkrepset m'u mbaruan, më lini ca fije, xhaxhi Juri... Unë edhe kam gatuar...

— Mirë... Mbaju, Valka... Punët nuk shkojnë keq... Lamtumirë...

Fshati Vladimirska u zu aq papritur, sa që andej nuk iku dot asnjë gjerman. Nuk iku dot as Gestapoja: kamioni i madh me ushtarët e zinj e komandantin e tyre u kap në rrugën e paasfaltuar e u dogj me ç'kishte brenda. Fronti po shkonte drejt perëndimit. Juri, me gjithë plaçkat, erdhi e u vendos në korian afër fshatit Vladimirska.

Grisha shoferi, duke folur pasdarke për të rejat e luftës, të cilat shoferët sepse i mësojnë më parë se të tjerët, u tha ndër të tjera:

— Valka jonë është vajzë shumë energjike; pak më parë vajti në fshat dhe pyeti për atë Mihej Ivanoviçin, mbiemrin e ka të çudiçëm — Nepej. U kthye e ngrysur. Nepej është zhdukur pa lënë gjurmë. Banorët thonë për të: «Më keq se kolera ishte; ne do ta kishim futur në dhe të gjallë, ai e dinte këtë, prandaj dhe iku...»

Sapo kujtoi Grisha Mihejin, erdhi Vala. Fytyrën e kishte të vrenjtur si ndonjë e madhe, buzët i kishte të shtrënguara. U ul te ana e trungut, pranë Jurit. Si folën për të gjitha, Vanja mitralieri nxori një muzikë goje gjermane dhe filloi t'i binte; Vala uli kokën e i tha:

— Xhaxhi Juri, gjejeni atë njerinë që mundoi nënën time.

Atëhere të gjithë kthyen kokën dhe vështruan vajzën. Jurit ju drodhën flegrat e hundës, ai u përgjegj:

— Do përpiqemi... Shokë, duhet të mbledhim njoftime për të.

Këtë e mori përsipër Grisha. Pas disa ditësh, po në atë orë, ai mundi të thoshte diçka.

Mihej Ivanoviçi kishte ardhur në fshat nga një vend tjetër, tetë vjet më parë, qe martuar me një kolkoziane të ve dhe shpejt e kishte përcjellur në varr. Për veten e tij ai thoshte se rridhte nga një familje minatorësh, po, siç duket, i ati dhe ai vetë para revolucionit do të kishin qenë sipërmarrës në miniera; ishte i keq dhe dredharak. Në izbën e tij mund të gjeje gjithmonë vodka të bërë vetë. Ca kohë vinte te ai për të pirë veterineri dhe bashkë me të ja se ç'kishin bërë. (Kjo u muar vesh më vonë, në kohën e gjermanëve, kur e tregonte vetë Mihej me mburrje). Në vigjiljen e festës së Pokrovit, në mëngjez herë, mjelësja vajti në stallën e lopëve dhe pa se lopa e racës simental, «presidentja», krenaria e kolkozit, qe shtrirë e ngordhur në bar me buzë të përveshura, me dhëmbët e çkërmitur. Filloi një rrëmujë. Veterineri që kishte fjetur te Mihej, erdhi bashkë me kolkozianët, e kontrollloi «presidenten», «Largohuni, shokë, — tha ai rëndë-rëndë, — më duket se kjo është sibirka»¹). Lopën e zvarrisën me kujdes jashtë fshatit, e mbuluan në gropë pa e rjepur, stallën e dizinfektuan. Lopë të tjera nuk ngordhën. Ndërsa Mihej me veterinerin gjithë dimrit hëngrën pastërma. Ç'kishte bërë ai, që mburrej pastaj? Kishte marrë një patate të madhe, kishte hapur natën derën e stallës dhe me shkathtësi ja kishte futur në fyt pataten «presidenten». Natën tjetër, bashkë me veterinerin e kishin nxjerrë lopën nga gropa dhe e kishin ajrosur. Kur filloi lufta me gjermanët, Mihej mori guxim e nuk mundi ta fshihte dot gëzimin e egër, gjithë ato ditë i shkëlqenin sytë, takonte njerëzit e u thoshte: «Oh, do të derdhet gjak... Oh, gjak që do të derdhet...» Kur tanët, duke u tërhequr, kaluan në fshat dhe ushtarët e kuq trokisnin te Mihej për të kërkuar qumësht, ai ngrinte xhamin e dritares e u përgjigjej: «S'kam, s'kam, të dashur, pushteti sovjetik na i pastroi të gjitha...» Kur hynë gjermanët, menjëherë pas tankeve, Mihej, i krehur, me këmishë të re e xhakëtë të mirë, qënd-

1) Sëmundje që ju bie lopëve.

droi te porta me një peshqir të qendisur në dorë, ku kishte vënë një çyrek dhe kriporen e argjentë. Ai u përkulej gjermanëve, gjersa njëri nga oficerët, duke kaluar, i mori çyrekun, ja dha një ushtari e tha: «Shumë mirë, më pëlqen...»

Mihej filloi të vente nëpër shtëpitë dhe të hapte bise-dime; ulej te praku i derës, përplaste shkopin në shesh dhe vështronte me shumë kuptime të zotit e të zonjën e shtëpisë, që rrinin të vrënjtur e të hutuar.

— Nuk e di, të them të vërtetën, nuk e di, si do rroj më tani në pushtetin e ri, o kolkozianë? Pa e peshuar mirë, unë ju nxora atyre bukë e kripë... Po tani, që thua ti, fillova të pendohem... Sidoqoftë, pushteti sovjetik na dha diçka... Sigurisht, gjermanët vunë rregull, lejuan tregëtinë private e shumë të tjera, po qeverisin me rreptësi... Herë mendoj kështu, herë ashtu... Prandaj shkoj te njëri e te tjetri. — Dhe rrudhte fytyrën e kruhej me shkop pas veshit. — U mësuam me shoqëri, me kolektivitet... Pa shiko, shumë venë partizanë, domethënë diçka ka këtu... A do rrinë shumë gjermanët këtu? Edhe kjo s'dihet... Ti si mendon Stepan Petroviç?...

Ushtarët e garnizonit gjerman në fillim — një javë, dy — sikur nuk ja vinin veshin popullsisë. Rronin si në shtëpi pushimi, bënë ushtrime, loznin futboll, u binin borive, shetisnin nëpër rrugë vetëm në brekë, pa turp. Po, kur erdhën të zinjte dhe varën në një fije kompensatoje shpalljen, ku thuhej se për çdo shkelje të rregullit njerëzit i kërcënonte dënimi me vdekje, atëhere gjermanët i treguan dhëmbët prej ujku. E grabitën fshatin në mënyrë të organizuar dhe ato që nuk i hoqën dot me kamiona, i pastruan ushtarët e garnizonit.

Gestapoja filloi të interesohej për çdo familje. Aty e kuptuan fshatarët përse vente Mihej shtëpi më shtëpi e hapte biseda me dy kuptime. Me dinakëri, i poshtri, pa u kuptuar, nxirrte nga kuvendimet se kush e kishte djalin ose dhëndërin në Ushtrinë e Kuqe, kush ishte lidhur me komunistët, kush ishte mik me mësuesin Virjovkin. Mësuesi, bashkë me disa djem të rinj, ishte zhdukur nga fshati në vigjiljen e ardhjes së gjermanëve dhe thoshin

se hidhte në erë urat e depot, kishte shkatërruar një tren që kishte brenda batalionin pancir të SS-ve, e kishte djegur shumë kamiona nëpër rrugë.

Pas fundit të tmerrshëm të këtij treni, të zinj të filluan të merrnin njerëzit, pleq e të mitur, e t'i mbyllnin në shkollë. Më tepër merrnin nga ato shtëpi ku kishte qenë Mihej.

Për Mihejin thoshin që merrte pjesë në tortura, prandaj munda të sigurojë dy lopë dhe një dem. Ai vishte xhakëtë të gjelbër, kishte rruar mjekrën e flokët, dhe një herë e panë të pinte puro. Njerëzit, kur e shikonin që kthente nga izba e tyre, fshihnin ushqimet e veshmbathjen që u kishin mbetur, i dërgonin fëmijët sa më larg. Ata nuk donin ta fusin brenda Mihejin. Tani ai vinte nëpër shtëpitë me qëllim, nxirrte nga xhepi shishen e shnapsit dhe fillonte.

— Nuk më duan bashkëatdhetarët, — thoshte duke u ulur në tryezë, — i shikoj, të gjitha i shikoj... Nuk më besojnë... Shpifin për mua, shpifin... (Nga xhepi tjetër nxirrte sallon e e priste në copa të vogla katrore). Pse, s'jam njeri unë? Egërsirë jam, apo djall? E, të dashurit e mi, më është mërzhitur jeta... Kaq më janë mërzhitur gjermanët!.. Ata më besojnë. Dhe po të besoi gjermani, s'e tund as topi... Kjo është teknikë, organizim... Ai s'ka kohë të mendojë, mendon pak... — Mihej mbushte gotën, ja afronte të zotit të shtëpisë të uritur bashkë me një copë sallo. — Ata përhapin lloj-lloj gjepurash të ndyra për mua, sikur unë punoj në Gestapo... Kështu duan të më lidhin që, unë, Mihej, po të kthehet pushteti sovjetik, mos kem ku të futem... Hajde, kumbarë, e pimë nga një... Nëqoftëse nga dobësia bëra ndonjë gjë që s'duhej, ose thashë ndonjë fjalë të pamatur, të më falni, për hir të zotit... Ja, këtë shishe ua kërkova, ma dhanë, po si? «Na!» Ma hodhën në surrat, si qenit... Ja edhe lopët e mia... Ato para i kisha ruajtur qëkuri për lopët. Më pëlqen qumështi, po më shumë më pëlqen pastërmaja. — Ai mbyllte synë me dinakëri, qeshte dhe mbushte gotat përsëri. — Djalli i marrtë edhe lopët, gjersa m'u hap një nam i tillë!... Do braktis gjithçka, do iki që këtej... Do kaloj frontin, bëni

ç'të doni me mua... Edhe te Verjovkini mund të vete, do t'i bie ndër këmbë e do t'i them që dua t'i laj me gjak të gjitha mëkatet...

Kush ishte i zgjuar, heshte, pa e shikuar në sy, kush ishte më i thjeshtë, i besonte dhe e miratonte. Pas disa ditësh te ky vinin të zinjte.

Juri vajti bashkë me Valën në Degën e shtatë, te majori, dhe i tregoi për Mihejin. Vala hidhte sytë me shqetësim nga Juri te majori dhe dëgjonte kaç e përqëndruar, sa dukej sikur gjithë jeta e saj e vogël mbahej ndezur vetëm nga një shpresë: ta gjejnë atë njeri, se, po s'e gjetën, edhe kjo shkëndijë e fundit jete do të shuhet. Majori mbajti shënim të dhënat «Do ta kërkojmë të poshtrin...» Vala buzëqeshi, ja mbërtheu sytë atij dhe përsëri tundi kokën, e shqetësuar.

Gjatë rrugës për në koriye, në kampin e tij, Juri ecte shpejt, Vala e ndiqte duke u hedhur...

— Xhaxhi Juri, a do ta gjejë ai?

— Ku ta di unë, Vala?.. Gjersa tha do ta kërkojë...

— Xhaxhi Juri, do vete dhe vetë ta kërkoj.

— Ku do vesh ti? Marrëzira... Do shkelësh ndonjë minë ose do të të shtypë ndonjë kamion...

— Nuk bën?

— Nuk bën, mos më mërzit dhe pusho...

Disa ditë Vala ndenji e mërzitur, përgjigjej vetëm «po», «jo», ulej në një qoshe e mblidhte vetullat e shkurtëra e të ngritura përpjetë. Një mëngjez ajo u zhduk nga strehimi. Kishte ikur... Filluan të diskutojnë: «E qartë, shkoi të kërkojë Mihejin.» Të gjithëve u erdhi keq. «Dre-qi! Do humbasë vajza» Grisha shkoi në fshat për të pyetur; disa e kishin parë afër izbës së mbërthyer të Matrjonës, ajo kishte pyetur disa për Mihejin, po se ku kishte vajtur pastaj asnjeri nuk e dinte.

Pas tri ditësh, Vala u kthye në kamp si ndonjë kone që ka bërë faj, e pakrehur, e gërvishtur, e palarë. Atë nuk e qërtuan, nuk e pyetën, vetëm i ndenjën pak ftohtë. Vala fjeti pothuaj njëzet e katër orë, hëngri, po në mëngjez përsëri u zhduk.

Një grua, e shoqja e një komunisti, që u kthye me

dy fëmijët në shtëpinë e shkatërruar, u tha fqinjëve (pas një ore dy çunat vrapuan në korie dhe ja treguan këtë Grishës) se pesëmbëdhjetë kilometra nga fshati kishte takuar në rrugë vajzën e Matrjonës, e cila i kishte hapur të fshehtë e zemrës... Dhe sa vajzë e pjekur! E kishte kuptuar që Mihej fshihej, duke punuar diku për ushtrinë. «Teto Stjepanida, do vete kudo që rregullojnë rrugë, ku hapen hendeqe kundër tankeve, do t'i vështroj të gjithë në sy...» Kishte qarë bashkë me të, i kishte dhënë një peksimadhe dhe ajo kishte shkuar.

— Xhaxhi Juri, o xhaxhi Juri, ngrehuni, shpejt, shkojmë...

Juri gërhiu thellë dhe u zgjua. Mëngjezi kishte lëshuar pak dritë në dritaren e vogël të strëhimit. Vala kishte qëndruar afër krevatit; i prekte fytyrën...

— Na erdhe... Tungjatjeta... Je një djall edhe ti... ç'më tund kështu?

— Shkojmë te ai xhaxhi, ku vajtëm një herë bashkë... xhaxhi Juri, unë e gjeta atë... — zëri i saj tingëllonte në mënyrë të çuditshme. Juri, duke marrë frymë rëndë, mbathi çizmet, vuri rripin, lëmoi balluket...

— A thua ta kesh gjetur?

— Ëhë... Atje t'i them të gjitha, vetëm më shpejt!

Shkuan në Degën e shtatë, te majori, që flinte në dy banka të bashkuara, i mbështjellë me kapotë e me kokën mbështetur në çantë. Vala, pa pritur të zgjohet mirë ai e të ulej në tryezë, filloi të tregojë me të shpejtë si e kishte gjetur dhe si e kishte njohur Mihejin.

— Dyqind kilometra brodha po më në fund e gjeta... Xhaxhi, ai ka rruar mustaqet dhe mjekrën, vetëm unë mund ta njoh...

Pas pak, majori me Valën shkuan te vendi ku meremetohej xhadeja e prishur nga gjermanët. Vala qëndronte në maqinën e hapur dhe vështronte përpara e përqëndruar. Ngriti dorën, u kthye dhe i pëshpëriti majorit:

— Këtu...

Një njeri i kërrusur, i bardhë nga pluhuri i gëlqeres, me kokën lidhur me shami dhe këmbët mbështjellë me

lecka po çante gurë. Kur u ndal maqina, ai ngriti kokën, zgurdulloi sytë dhe rrudhi fytyrën e rruar e me hundë të shkurtër, sikur ta kishte vrrarë një dritë e fortë...

— Ai! — thirri Vala, duke e treguar me gisht.

— Si është puna? — pyeti me zë të ngjirur ky njeri majorin që po i afrohej. — Dokumentin tim? Urdhëroni... Gjithçka në rregull... — Dhe, si i hodhi një sy depërtues vajzës, që rrinte pranë majorit, u përkul dhe zuri të çante përsëri gurë.

Majori e pyeti duke shfletuar pasaportën.

— Emri juaj, Aleksej Demjanoviç Pavllov, i datë-lindjes trembëdhjetë? (Dora e ftohtë e Valës kapi dorën e tij dhe e shtrëngoi).

— Po, Aleksej Demjanoviç Pavllov, — u përgjegj ai pa ngritur kokën. — Po si është puna?

— Puna është se pasaporta jote është lëshuar nga komandatura gjermane... — Ai tundi kokën ngadalë, qe-shi nën hundë:

— Mos më bini më qafë, shokë, pasaportën time e ka lëshuar milicia e Smolenskut, unë jam i ikur nga Smolensku, invalid i luftës civile. — Papritur, ai rrudhi hundën. — Jetë qeni po bëjmë... Çajmë gurë me barkun bosh. Kam derdhur gjak për pushtetin sovjetik dhe tani ja se ç'na kurdisin: pasaporta nga komandatura.

Gjer atëhere majori s'kishte folur, po, kur ai bëri sikur çante, nxori revolen:

— Ngrehu! — Njeriu u ngrit si me zor dhe flaku çekiçin me inat. — Duart lart! (Majori i kontrolloi xhepat). Shko përpara meje në maqinë!..

Mihej nuk mohoi dot gjatë, e njohën menjëherë dëshmitarët. Dhe atëhere filloi të tregojë:

— Në kohën e gjermanëve isha vazhdimisht i dehur: pija nga gëzimi. Nuk e fsheh, gjermanët i prita me bukë e kripë, më qe mërzhitur pushteti sovjetik, kujtova se nën gjermanët do bëja jetë, kuptoni, do bëja jetë! Po ata më gënjen.

Disa net me radhë ai foli për mundimet e njerëzve rusë, për torturat dhe ekzekutimet në Gestapo. Tregoi gropën ku qenë mbuluar kufomat e të munduarve, tregoi

veglat e torturave që gjermanët i kishin fshehur dhe mbuluar në bodrumin e shkollës: mangallin, çengelat e hekurta, me të cilët i varnin njerëzit për brinjësh, kamxhi-kët prej kauçuku, kunjat e drunjtat që u futnin në thonj...

Rrëfente për torturat me zë të qetë, hollësisht, sikur të fliste për ndonjë punishte ku vrisnin bagëtinë dhe bënin sallam...

— Kam marrë pjesë në shumë tortura, — mëmëriste ai me sytë mbyllur. Një herë, papritur ra në dysheme, filloi të gërvishtë tokën me thonj. «Ja ai, gjaku, ja ai, gjaku!» thoshte dhe puthte dheun...

— Mjaft më, jeni shumë i ndyrë, — i tha oficeri që e merrte në pyetje. Më vonë në qeli e pyeti: — A nuk ju ka shkuar ndonjëherë nëpër mend juve, Mihej Nepej, se duke punuar për gjermanët, shisni popullin rus, shisni atdheun?

— Më ka shkuar, më ka shkuar... Po vetëm me atdheun nuk ngopet njeriu, më afër dera se qilari.

Me një fjalë, për gjyqin çdo gjë ishte e qartë. Në prani të banorëve të fshatit Vladimirska, që ishin grumbulluar afër shkollës, në shkollë e nëpër dritaret e saj, gjyqi e dënoi Mihej Ivanoviç Nepejn me varje. Kur e shqiptoi gjykatësi këtë fjalë, Mihej, që kishte qëndruar drejt, gati-tu, nuk luajti asnjë qepallë, fytyra e tij e rruar, me faqet e fryra e ballin e ulët nuk ndryshoi fare. Në sallë njerëzit psherëtinë të lehtësuar dhe menjëherë qindra duar u përplasën; një grua bërtiti me inat:

— Pak e ka, i poshtri... Pak e ka këtë dënim... Atij t'i rjepësh lëkurën...

Në mëngjez, afër trekëmbëshit, u mblodh përsëri gjithë fshati. Mihejin e prunë katër ushtarë të kuq. Ai ecte si i dehur, me kokë ulur. Gjykatësi lexoi përsëri vendimin. Mihejin e çuan te froni. Ai u praps. E kapën, e vunë mbi të. Atëhere ai vuri vetë me kujdes thilenë në grykë. Të gjithë panë sytë e tij të urryer, të bardhë, buzëqeshjen e tij përçmuese, që i shtrembëroi gojën me dhëmbë të vegjël...

Vala, që kishte qëndruar fare afër tij, shtrëngoi grushtet e bërtiti:

— Mos qesh... Po ulëri.

GURI I NXEHTË

I

Jetonte në botë një plak i vetëm. Ai ishte plak i dobët nga shëndeti, bënte kanistra, qepte çizme, ruante kopshtin e kolkozit dhe kështu nxirrte bukën e vet.

Ai kishte adhur në fshat para shumë kohësh nga një vend i largët. Kolkozianët menjëherë e kuptuan se ky plak kishte vuajtur shumë.

Ishte i çalë dhe i thinjur, po jo nga vitet. Nga faqja e tij, nëpërmjet buzëve, shtrihej shenja e pashlyeshme e një plage të vjetër. Dhe prandaj, kur buzëqeshte, fytyra i merrte një pamje melankolike dhe të ashpër.

II

Një herë, një fëmijë me emrin Ivashka Kudrajshkin hyri në kopshtin e kolkozit që të mblidhte mollë dhe të ngopej me to, sa të mos mund të lëvizte. Po, në gardhin e kopshtit i ngecën pantallonat në gozhdë, u rrëzua mbi një ferrë me gjemba, u gërvisht, thirri nga dhembja dhe aty për aty u kap nga rojtari.

Sigurisht që plaku mund ta ngopte Ivashkën me thupër dhe ajo që ishte më e keqe, ta çonte në shkollë dhe t'u tregonte të gjithëve se ç'kishte ndodhur.

Po plakat i erdhi keq për Ivashkën, sepse duart e tij ishin mbushur me të gërvishtura, dhe nga prapa, si ndonjë bisht qengji, i zvarritej pantalloni i grisur, kurse nëpër faqet e kuqe i rridhnin lot.

Plaku, pa bërë zë, e nxori Ivashkën e frikësuar nga dericka e kopshtit dhe e lëshoi pa e ngarë as me gisht dhe pa i thënë asnjë gjysmë fjale.

III

Nga turpi dhe dëshpërimi, Ivashka u fut në pyll, humbi rrugën dhe u gjend para një kënete. Ishte lodhur shumë. Prandaj deshi të ulej mbi një gur të kaltër, të mbuluar me myshk, po menjëherë u hodh përpjetë duke britur, pasi ju duk sikur u ul mbi ndonjë bletë pylli, e cila e kafshoi fort nëpërmjet vrimës së pantallonave.

Mirëpo në gur Ivashka nuk pa asnjë bletë; guri ishte si qymyri i nxehtë, ndërsa në sipërfaqen e tij të sheshtë mezi dukeshin disa germa të mbuluara me baltë.

— Ky gur, siç duket, qenka magjik! — këtë Ivashka e kuptoi menjëherë. Ai hoqi këpucën dhe me takën e saj filloi t'i heqë shpejt baltën mbishkrimit, që të merrte vesh sa më parë se ç'dobi mund të kishte për vete nga ky gur.

Dhe ja, ai lexoi këtë mbishkrim:

«Kush e shpie këtë gur në kodër dhe e thyen atje copa-copa, ai do t'i kthejë vetes rininë dhe do të nisë jetën nga fillimi».

Dhe poshtë ndodhej vula, po jo vulë e thjeshtë dhe e rrumbullaktë, si ajo në sovjetin e fshatit, ose trikëndëshe, si ajo e shkresave të kooperativës, po më e çuditshme: me dy kryqe, tre bishta, një rreth me shkop dhe 4 presje.

Ivashka Kudrajshkin u dëshpërua. Ai ishte tetë vjeç. Dhe të niste prapë jetën nga fillimi, domethënë pas një viti ta bënte prapë klasën e parë; këtë nuk ja donte qejfi fare.

Po! Sikur me ndihmën e këtij guri, pa mësuar mësimet e shkollës, të kaloja nga klasa e parë, menjëherë në të tretën, do të ishte mrekulli.

Duke kaluar pranë kopshtit i dëshpëruar, Ivashka e pa përsëri plakun. Ai ecte duke u kollitur dhe herë-herë qëndronte për të pushuar; në dorë mbante një kovë me

gëlqere të shuar dhe në sup një shkop të gjatë me një furçë të lidhur në majë.

Ivashka, i cili prej natyre ishte djalë zemërmirë, u mendua: «Ja, ky njeri, po të donte mund të më ngopte me shufra. Po atij i erdhi keq për mua. Hajde një herë t'i bëj edhe unë një të mirë, t'i kthej rininë, që të mos kollitet, të mos çalojë e të mos marrë frymë kaq me zor».

Ja se me ç'mendimë të mira ju afrua plakut Ivashka zemërbardhë dhe i shpjegoi shkurt se ku qëndronte çështja. Plaku e falenderoi Ivashkën. Po të shkojë në kënetë dhe të lërë rojen nuk e pranoi, sepse kishte ende në botë njerëz të atillë që brenda kësaj kohe mund të shplanin fare kopshtin e kolkozit.

Plaku urdhëroi Ivashkën që ta çonte vetë gurin nga kënetë në kodër. Ai do të vinte pastaj atje për pak kohë dhe shpejt e shpejt me ndonjë send do t'i bjerë gurit.

Ivashkën e dëshpëroi shumë një zgjidhje e këtillë.

Po plakun s'donte ta zemërojë. Të nesërmen në mëngjes, pasi mori një thes të mirë dhe një palë dorëza të trasha, për të mos djetur duart te guri, Ivashka u nis drejt kënetës së pyllit.

IV

Kur e solli gurin nga kënetë në rrëzë të kodrës, Ivashka e ndjeu veten të lodhur, ishte bërë dhe me baltë prandaj u ul të pushojë mbi barin e thatë.

«Oh! Sa mrekulli! — mendoj me vete. — Tani, edhe pak, gurin e ngjis në kodër, pastaj do të vijë plakui i çalë, do ta thyej, do të bëhet i ri dhe do të fillojë jetën nga e para. Të gjithë thonë se ai i shkreti ka vuajtur shumë. Pastaj është dhe plak, i vetëm, i përvuajtur, i plagosur dhe sigurisht jetë të lumtur nuk ka parë ndonjëherë. Kurse njerëzit e tjerë kanë parë». Sa i vogël ishte Ivashka dhe tri herë e kishte parë jetën e lumtur. Një herë kur u vonua në mësim dhe një shofer i panjohur e çoi me veturë të mrekullueshme prej stallës të kolkozit deri në shkollë. Pastaj një herë në pranverë, kur kapi me duar një peshk

të madh në kënetë. Dhe në fund, kur xha Mitrofoni e mori me vete në qytet, në festën e bukur të 1 Majit.

«Le të shohë dhe plaku i mjerë jetë të lumtur», — tha me vete Ivashka zemërbardhë.

Ai u ngrit dhe me durim e çoi gurin në majë të kodrës.

V

Kur po perëndonte dielli, erdhi dhe plaku. Ivashka, i rraskapitur, ishte kërrusur pranë gurit të nxehtë, duke u dridhur dhe duke tharë rrobat e lagura me baltë.

— Pse s'prure me vete, mor gjysh, ndonjë çekiç, sëpatë, ose ndonjë copë hekur? — pyeti me çudi Ivashka. — A po mos ke shpresë ta thyesh gurin me dorë?

— Jo, mor Ivashka, — u përgjegj plaku, — unë nuk shpresoj ta thyej me dorë. Unë s'dua ta thyej gurin fare, sepse nuk kam dëshirë ta nis jetën nga fillimi.

Këtë ças, plaku ju afrua Ivashkës së çuditur dhe i fërkoj kokën. Dhe Ivashka ndjeu se si dora e rëndë e plakut dridhej.

— Ti sigurisht ke menduar se unë jam plak, i çalë, dhe i shëmtuar, — i tha plaku Ivashkës. — Po në të vërtetë unë jam njeriu më i lumtur në botë.

— Mua këmba më është thyer nga një tra, atëhere, kur ne rrëzonim mure dhe ndërtonim barikada, duke bërë kryengritje kundër Carit, të cilin ti e ke parë vetëm nëpër fotografi.

— Mua më kanë thyer këmbën, po kjo ndodhi atëhere, kur ne na kishin burgosur dhe këndonim me sa fuqi që kishim këngë revolucionare.

— Mua në luftë më plagosën fytyrën me shpatë, po kjo ndodhi atëhere, kur regjimentet e para popullore po vritnin dhe po shkatërronin ushtrinë e madhe armike.

— I shtrirë në bar të thatë, në një barakë të ftohtë, unë kam vuajtur i sëmurë nga tifua. Lajmi se vendi ynë është rrethuar dhe se forcat armike po na mundin, që për mua atëhere si lajm i vdekjes.

Po një ditë, kur u ngrita me rrezet e para të diellit që ndriçonte, mora vesh se armiku prapë që shpartalluar dhe se përsëri po sulmonim.

Atëhere, të gëzuar pa masë, nga krevati në krevat, ne i zgjatnim njëri tjetrit duart tona të dobësuarra dhe ëndërronim si me frikë që dikur, të paktën edhe pas vdekjes sonë, vendi ynë të bëhet i tillë, siç është sot, i fuqishëm. Mos vallë kjo nuk është lumturi, mor Ivanushka? Ç'më duhet prapë rinia, kur e kam kaluar vërtet me vështirësi, po me luftë dhe me nder!

Këtu plaku heshti, nxori llullën dhe ndezi një duhan.

— Mirë, mor gjysh! — tha mengadalë Ivashka. — Po, meqë qenka kështu, pse u mundova kot që ta sjell këtë gur në kodër, kur mund të rrinte fare mirë në kënetën e vet?

— S'ka gjë, le të rrijë këtu në fushë të mejdanit, — tha plaku, — dhe ti do të shohësh, Ivashka, se ç'do të ndodhë me të.

VII

Që nga ajo ditë kaluan shumë vjet, po guri ashtu mbeti, i pathyer, në atë kodër.

Afër tij kaluan shumë njerëz. Ata i afroheshin, e shikonin, mendoheshin, tundnin kokën dhe i largoheshin menjëherë.

Shkova edhe unë një herë në atë kodër. Nuk e di sepse, po ndëgjegjen nuk e kisha të qetë, nuk isha në qejf. «Po sikur, — menova me vete, — t'i bie një herë këtij guri dhe të filloj jetën nga fillimi?»

Po pastaj qëndrova pak dhe u pendova.

«E ç'do të thonë kur të më shohin të tre fqinjët e mi? Ja, po vjen një budalla i ri! Nuk diti të kalojë një jetë ashtu si i ka hije njeriut dhe s'e njohu lumturinë, prandaj paska vendosur të fillojë nga fillimi.»

Atëhere drodha një cigare dhe e ndeza te guri i nxehtë për të mos harxhuar shkrepshen. Dhe u nisa rru-gës sime.

FUSHATA E SHAMISË SË KUQE

Plaku Eduard Baier ka një buzëqeshje të ëmbël, tërheqëse dhe ca sy miopë, të cilët e shikojnë botën nëpërmjet syzave me rrathë të artë. Ai jeton sipas mënyrës së vjetër. Ecën ngadalë: s'ka përse të ngutet. Në kokë mban një kasketë, të cilën prej 30 vjetësh e fshin çdo mëngjes me kujdes të madh me një furçë të vjetër. Ai kishte patur edhe pension dhe, kur e merrte atë, ushqehet me qumësht, duke ngjyer bukën në të. Çdo ditë pasdreke, Baieri rrinte në kopshtin e qytetit, ndërsa në mbrëmje, në hanin «Joakimi i zi».

Në han bëhej fjalë për kohërat e lashta; nga fundi i muajit, atëhere kur pakësohej edhe numri i gotave me birrë, këto diskutime paksoheshin në mënyrë të dukshme. Të them të drejtën, pensionistët, aty nga fundi i muajit, shpeshherë pinin më shumë ujë mineral, se sa birrë, gjë që i bënte të plogët dhe të mërziur. Pra, Eduard Baieri në fund të muajit vuante nga uria, bile edhe më tepër se sa nga etja. Megjithatë, ai jetonte në mënyrë të përkorët dhe nuk kërkonte kushte të veçanta jetese.

Kështu kaloi jeta e Eduard Baierit këta tridhjetë vjetët e fundit dhe dukesh se kështu do të vazhdonte të jetonte deri në fund të jetës së tij. Plaku Baier nuk ishte pensionist i zakonshëm i shtetit. Po kjo aspak nuk e humbte të drejtën e pensionit, as edhe meritat e tij para atdheut. Ai kishte punuar dhe kishte vuajtur për atdheun aq, sa as një pension nuk do të ishte i mjaftë për të shpërblyer meritat e tij.

Ja meritat e tij:

1) Pesë brinjë të thyera, të thërmuara nga çizmet e komandantit të gestapos në burgun e Moabit në Berlin, në të të cilin qe burgosur, në vitin 1933, Baieri «i kuq», që punonte në organizatën e Partisë Komuniste të Vëdingut¹⁾. Ky burg ekziston edhe tani matanë vijës së kufirit, ku shkruhet: «Ju hyni në sektorin amerikan».

2) Po atë vit, më 1933, Baierin e dërguan në kampin e Bukenvaldit dhe për dymbëdhjetë vjet mbajti një xhakëtë lara-lara, të mbërthyer, dhe pantallona të një të burgosuri të kampit.

Që në atë kohë ju shkaktua një kollë e thatë e tmerrshme dhe, kur kollitesh, shamia që fshinte buzët, mbushesh me gjak. Ai ecte ngadalë dhe ndalonte çdo minutë. Ballin ja mbulonte gjithmonë një djersë e hollë, ndërsa faqet merrnin një ngjyrë të kuqe.. Këmbët i ngulta në tokë më me kujdes, se sa një akrobat mbi trapezë, po jo me shumë siguri.

Të gjitha këto ju a themi, së pari, që t'ju përshkruajmë plakun Baier, dhe së dyti, që t'ju tregojmë se Eduard Baieri e merrte pensionin në përputhje me ligjin mbi shpërblimin e dëmeve, që kishin bërë nazistët, ligj që ishte shpallur në vitin 1945.

Po, sa për pensionin, ai merrte një pension shumë të vogël, që i mjaftonte sa për simite me qumësht dhe ngandonjëherë për birrë vetëm në gjysmën e parë të muajit, ndërsa, në gjysmën e dytë të muajit, për pensionistët fillonin ditët e agjërimit.

Mund të pyesnit: ç'i duhej birra dhe gjëra të tjera të këtij lloji. Po ne e duam Eduard Baierin, këtë luftëtar të vjetër me ide komuniste, dhe nuk i pranojmë këto fjalë. Le të pijë sa t'i dojë qejfi, kur birra i pëlqen. Në qoftëse do, le të qerasë miqtë e tij të vjetër — zdruckthëtarin pa punë Knopfa dhe rojen e natës Volffe. Plaku ynë nuk është ndonjë koprac, ai ka një natyrë bujare, nuk mund të durojë urinë dhe etjen e tjetrit, kjo për të është më e rëndë se sa kur vuan vetë nga uria.

1) Veding — është një nga lagjet punëtore në sektorin perëndimor të Berlinit.

Po me atë pension as mund të jetoje, as mund të vdisje!

Pensionin e sillte çdo herë në datën një të muajit, në orën dymbëdhjetë, postieri Greif. Plaku Baier përgatitej që më parë për të marrë pensionin. Në mëngjes heret të datës një, pasi rruhej me kujdes, ulej në një kolltuk për të pritur postierin. Sa fillonte të bjerë zilja, Eduard Baieri ngrihej ngadalë nga kolltuku i tij i vjetër dhe me hapa të vogla i afrohej derës. Ecte ngadalë, ngadalë, në mënyrë që ta zgjatte çastin e madh të marrjes së pensionit.

Postieri ishte një njeri që i nderonte të tjerët, po i pëlqente të fliste shumë, prandaj procedurën e dorëzimit të pensionit e zgjatte tepër. Plaku Baier gjithmonë harronte t'ja kthente lapsin, me të cilin nënshkruante. Postieri me qëllim kthehej përsëri dhe, pasi merrte frymë me zor, e pyeste:

— A e kam lënë te ju lapsin, herr Baier?

— Ndoshta, — i përgjigjej Baieri dhe fillonte të kërkonte me nxitim nëpër xhepat lapsin e humbur.

Pastaj lapsi gjendej dhe postieri, pasi merrte frymë me lehtësi, ulej të pushonte. Fillonin bisedimet. Për politikë rrallë dhe pak flisnin. Postieri, si një nëpunës i shtetit, kishte frikë të bisedonte me Baierin për politikë, që të mos humbte nëpunësinë. Ruajna zot sikur Baieri të thoshte diçka komuniste dhe këtë ta mësonin superiorët e tij, ata do ta regjistronin Greifin në listat e elementëve të dyshimtë. Dhe ai, si një diplomat, shqiptonte, për shembull, këtë frazë:

— Burgerët morën sot letër nga ishulli Borneo. Ç'thoni ju për këtë?

Baieri mendonte për diçka tjetër. Ai e kapte Greifin nga pulla e sipërme, ja përdridhte atë dhe me zemërim thërriste:

— Socialdemokratët... O pjellë e ferrit! Gjermania fatkeqe! Sot hipën Noske, nesër Shumaheri... Ju, herr Greif, duhet të mendoni për këto çështje... Ju jeni një burrë me të kaluar luftarake...

Po postieri i përgjigjej:

— A e dini, herr Baier, sot me radio lajmëronin se koha do të jetë me re dhe me shi...

Për këtë flet, po për diçka tjetër mendon postieri Greif.

Ai është nëpunës shteti, duhet të ketë kujdes, përndryshe i japin duart!

Pastaj ata ndaheshin. Postieri me hapa të rënda zbriste shkallët, ndërsa Eduard Baieri, duke njomur gish-tat me gojë numëronte markat shumëngjyrëshe të perëndimit, që shtypeshin në SHBA. Po, sado që t'i numërosh të hollat, mbeten po ato, nuk bëhen më shumë. Të nesërmen, pas marrjes së pensionit, Eduard Baieri blinte një litër qumësht dhe katër simite. Ai qeraste me birrë në mbërmje zdrukhtarin Knopfa dhe rojtarin e natës Volke, dhe këndonin këngë, ndër të tjera edhe këngën «Ne, roja e re»...

Po një herë...

Ditën e parë të gushtit të vitit 1951, pikërisht në mes të ditës, erdhi në derë të apartamentit të Baierit postieri Greif. Ai qëndroi përpara derës së hyrjes dhe vuri dorën mbi sustën e ziles, po nuk i ra. Greifi nxori nga çanta një letër me zarf të blertë, e futi menjëherë përsëri në çantë dhe ju afrua kutisë së postës të apartamentit fqinjë.

Plaku Baier ishte ulur në kolltukun e tij, i rruar me kujdes, me pantallona të hekuosura të mirë dhe me këpucë që shkëlqenin nga pastërtia. Ai kishte shumë uri.

Më në fund ra zilja, po këtë herë tingulli i saj ishte i zbetë dhe i mbytur. Pensionisti Eduard Baier u ngrit nga kolltuku dhe ju afrua derës pothuajse me vrap.

— Mirëdita, herr Baier, — i foli postieri Greif, — si jeni me shëndet?

— Jo keq, si të thuash, mbahemi, po me zor, — ju përgjegj herr Baieri.

Atij i shkante lëng për goje kur kujtonte lugën.

Baieri e ftoi Greifin në dhomë.

— Radioja njoftonte se po afrohet një valë ajri e ftohtë nga oceani Atlantik, — pëshpëriti me dëshpërim postieri dhe Baieri e kuptoi: diçka do të kishte ngjarë!

— Ç'ju ka ndodhur? — e pyeti i shqetësuar dhe e shikoi drejt në sy postierin.

Greifi nuk e duroi dot atë vështrim. Pa bërë as një fjalë nxori letrën me zarf të blertë dhe ja dha Baierit. Letra shkruante:

«I nderuar zotni, qeveria ka vendosur shpërndarjen e bashkimit të viktimave të nazizmit dhe, pasi i duhen të holla për nevoja të tjera, nevoja më të rëndësishme, u pezulloi pensionin anëtarëve të këtij Bashkimi.

Qeverisë i vjen kaq thellësisht që në të ardhmen nuk do të mundet më t'ju paguajë pensionin.

Me shumë respekt» (firma është e palexueshme).

Po, herr Baier, shpenzimet e shtetit janë shumë të mëdha, duhet bërë ekonomi, duhet, zoti Baier, të shtohen rrogat e gjeneralëve të rinj të ushtrisë së re gjermane, duhet të ulen taksat e shampanjës. Duhet t'i japim hua Alfred Krupit nga paratë e shtetit. Ai ka një patentë të re të mrekullueshme për armët me qitje të largët! Mos u dëshpëroni, herr Baier, ne duhet të kursejmë. Ne po shtojmë racionin e qenve të policisë. Ku t'i marrim gjithë këto para, i nderuar zotni? Ne jemi një shtet i varfër dhe, veç kësaj, mbajmë një ushtri të madhe të okupatorit. Me shumë respekt... Mos u zemëroni me ne...

— Me çfarë do të rroj unë? — e pyeti herr Baieri Greifin.

Po ku ta dijë këtë postieri Grejf?

— Të poshtrit! — tha me dëshpërim Baieri. — Kjo është poshtërsi e madhe! — dhe u kollit aq shumë, sa u duk sikur diçka ju shkëput nga mushkëritë. Ai kryqëzoi duart e zbeta, mbi të cilat dukeshin vija-vija damarët mavi, ndërsa fytyra e tij e thatë shprehte dhe zemërim.

Postieri Grejf tundi kokën dhe tha:

— Unë kam pasur një teto në Cincinati, një grua shumë të kulturuar; ajo, siç i ndodh inteligencës, vdiq në varfëri të plotë. Në këto raste, kështu siç ndodhi dhe me ju, ajo thoshte: «C'est la vie!»¹⁾... frëngjishten e dinte.

1) Kështu e ka jeta!

Këto tha postieri Greif, nëpunësi i shtetit, që kishte frikë se mos humbiste pozitën e tij.

Herr Baieri i dëgjoji për një kohë të gjatë hapat e postierit, që zbriste shkallët, zorrët në bark po merrnin valle nga uria.

Postieri Greif, duke zbritur shkallët, takoi me nën-tëvjeçarin Johan Shtraus. Ky ishte një fëmijë, ashtu sikurse të gjithë fëmijët e tjerë. Ai nuk i duronte dot vajzat e vogla, luante futboll, luante me cingla dhe mbledhte pulla. Ai po e priste postierin të shkallët, që ta pyeste se kush nga banorët e rrugës së Artë ka marrë letra me pulla të jashtme.

— Nderimet e mia, herr Greif, — belbëzoi Johani.

— Më lër të qetë, — ju përgjegj Greifi. — Sot nuk kam qejf të bisedoj! — dhe psherëtiti me vete:

— I gjori Baier! Mbaroi fare!

Johan Shtrausi i dëgjoji të gjitha dhe i mbajti mend të tëra, sepse këto kishin lidhje me herr Baierin, me të cilin Johani kishte marrëdhënje të veçanta.

Për herë të parë me Baierin ishte takuar një mesdite, në parkun e Vedingut. Nuk mund të themi se sjellja e këtij djali në këtë takim përputhej me rregullat e edukatës. Ishte një ditë dimri.

Adashi i muzikantit të famshëm, Johan Shtraus, po luante me topa dëbore dhe një top bore i madh, i hedhur prej tij, qëlloi në kasketën e Baierit, e cila fluturoi e ra në tokë. Baieri e ngriti kasketën, shkundi dëborën dhe vësh-troi fajtorin me buzën në gaz, i cili, nga frika, qëndronte i gatshëm për të bërë një tërheqje strategjike, po ta lypte nevoja.

— Ç'bëre kështu, mor djalë, — tha herr Baieri, — kasketa ime rrinte mbi kokë dhe s'të pengonte... Pa eja këtu, more djalë.

Johan Shtrausi ju afrua.

— Do të më zini për veshi? — e pyeti ai.

— Jo, — u përgjegj Baieri, — nuk do të zë për veshi.

Pasi mësoi nga bisedimi që patën se Johani mbledh pulla poste, ai i dhuroi një pullë të blertë me gji-rafë. E ku mund ta gjente Johani një pullë aq të rra-

llë?! Johan Shtrausi, për herë të parë në jetën e tij, ndjeu një diçka, që quhet të vrarët e ndërgjegjes. Ai dëshironte ta ndreqte këtë faj përpara plakut Baier.

... Që prej asaj kohe, ai e përshëndeste me nderim të madh herr Baierin dhe filloi t'i sillte qumësht dhe simite. Këtu, ndoshta, ka luajtur një rol edhe dëshira për t'u treguar se ai di të blejë sende ushqimore dhe të kthejë të hollat që mbeten. Po, sido që të jetë, duhet të pranohet se kjo është një sakrificë e madhe që bënte djali nëntëvjeçar, duke u ngritur një gjysmë ore më parë se zakonisht dhe duke vrapuar në bulmetore për qumësht dhe në dyqan për simite... Në pranverë, në verë dhe vjeshtë ai me herr Baierin qëndronte për një kohë të gjatë nën gështenjën e blertë; këtu Johan Shtrausi merrte plot njohuri për ngjarjet më të largëta dhe më interesante: se si herr Baieri kishte qenë marinar dhe sillte kafe prej ishullit Java në Hamburg, se si ai e njohu të vërtetën, se si ai luftoi për lirinë në vitin e lavdishëm 1918, se si ai kishte qenë flamurtar dhe se sa e kishte dashur gruan e tij, Luizën.

Në mënyrë më të hollësishme ne do t'jua tregojmë këto biseda një herë tjetër, për to do të mund të fliste vetëm gështenja e blertë, po gështeniat nuk dinë të flasin. Po një ditë të bukur, drejtori i shkollës Nr.5 thirri të jatin e Johan Shtrausit, i cili ishte një qytetar me karakter të shëndoshë, dhe i bëri vërejtje se nuk kujdesej për djalin. Nën portretin e presidentit Truman, mbi një qilim të mirë, qëndronte në këmbë babai i Shtrausit. Drejtori i tregonte se djali i tij një ditë kishte ngulur një flamur të vogël të kuq mbi katedrën e mësuesit. Drejtori akuzonte në këtë mes gjithë familjen. Babai i Shtrausit nuk mundi të provonte se ai ishte i pafajshëm. Që prej asaj kohe atë e futën në listat e komisionit të Berlinit përëndimor si element që, nga pikëpamja politike, është si i dyshimtë. Ju, natyrisht, e kuptoni se fryma prej «rebeli» e Johan Shtrausit e ka burimin e saj te bisëdimet nën hijen e gështenjës së vjetër.

Dhe ja një ditë të bukur, Johan Shtrausin e përjash-tuan nga shkolla. Atë e rrahën në shtëpi. Ai qëndroi si

burrë dhe, duke heshtur, mbytte lotët dhe nuk ju përgjegj prindërvet, bile as në të tilla pyetje, që në thelb janë serioze, si pyetja: «Çfarë ke ndërmend të bësh ti?».

Johan Shtrausi e dinte mirë se ç'do të bënte. Ai do të sjellë kafe nga ishulli Java në Hamburg, pastaj do të përleshet në barikada. Në qoftëse e filloi kështu Eduard Baieri, atëhere pse të mos bënte kështu dhe Johan Shtrausi? Atë e caktuan në një shkollë tjetër. Ju mendoni se atje ai u përmirësua? Ai edhe këtu e ngriti flamurin e kuq, po në këtë çështje ndërhyri edhe plaku Baier, i cili bëri të largohet një disfatë e re, me paçoja shumë më e rrezikshme.

— Flamuri i kuq a nuk është flamuri i së vërtetës? — e pyeti Johan Shtrausi, kur Baieri po i mbushte mendjen të mos vente në shkollë flamurë të kuq.

— Po, — ju përgjegj Baieri, — këtë e di ti!

— Po, meqë është flamuri i së vërtetës, pse nuk mund ta vë sa herë dua?

— Mos u nxito, — i tha Baieri. — Prit, do të vijë koha edhe për këtë. — Ai e mësonte mikun e tij të vogël të jetë i durueshëm dhe të qëndrojë si burrë.

Sipas këshillave të Baierit, Johan Shtrausi filloi të frekuentojë shtëpinë e pionierëvet në Lihtenberg, në sektorin demokratik të Eerl'nit. Johan Shtrausi që i pari që kaloi kufirin e sektorit të tij. Ai mori pjesë në tri rrethe: në atë të fotografisë, të historisë dhe të zdruckthtarisë. «Sa më shumë të dijë njeriu, aq herë më tepër vlen si njeri», — i thoshte Baieri.

Kjo ishte shumë sekrete. Ndërsa babai i Shtrausit, që vetë ishte këpucar, ishte i sigurtë se i biri do të bëhej avokat. Dhe sa avokat i mirë do të ishte ai!.

Një ditë, pas vizitës tragjike të postierit, i ranë ziles në derën e Baierit dhe ky shkoi ta hapte. Ishte Johan Shtrausi. Si e përshëndeti në mënyrë shumë të sjellshme i tha:

— Mos u zemëroni, herr Baier... unë nuk desha t'ju zgjoj, po ju kenj harruar t'i lini paratë në atë vend, ku i vendosni gjithmonë.

— Nuk kam harruar, mik i dashur, — foli Baieri, — po nuk kam se ç'të vë.

Pastaj ai i dha mikut të tij të vogël të lexojë letrën me nënshkrimin e palexueshëm, dhe djali, i turbulluar, thirri me të madhe.

— Sa keni vuajtur ju... dhe keni luftuar... Kurse ata befas... përnjëherë...

Herr Baieri i lëmoi mikut të vogël balluket e djer-situra, po ai nuk duhej ta bënte këtë, sepse Johan Shtrausi u dëshpërua menjëherë dhe një çurk lotësh të hidhur i rrodhën nga sytë.

— Si do të bëni? — e pyeti ai Baierin, pasi e mori pak veten.

— Nuk e di, — ju përgjegj plaku. — Unë jam plak, mua tani po më afrohen ditët. Tani unë për asgjë nuk... po ti të mësosh mirë... Sa më shumë njeriu të dijë, aq më i madh bëhet. — Fytyra e tij shndriti, drejtoi trupin dhe hodhi vështrimin jashtë dritares, larg...

Fëmijët nëntëvjeçar nuk kanë para. Kjo është një gjë e natyrshme, dhe ne po e përmendim këtë për të kuptuar gjendjen pasurore të Johan Shtrausit të vogël. Është e vërtetë se ai kishte një brisk xhepi me një mëru fildishi me fosfor, një orë - muzikë me një shkurtabiq, që kishte vetëm gjysmën e mjekrës, dhe dy libra që kishte lexuar: njëri pa fillim dhe tjetri pa mbarim. Ja, kjo ishte tërë pasuria e Johan Shtrausit, përveç asaj, që as mund të shitet dhe as mund të blihet.

Ai u nis për në shkollë shumë i turbulluar dhe i hutuar. Në mësimin e këngës këndonte fallso, shenjë kjo që tregonte se djali ishte në një gjendje shpirtërore të rëndë. Në mësimin e gjeografisë rrinte i vrëjtur, duke mbështetur kokën mbi duar, me një vështrim që e kishte drejtuar në thellësinë e errët dhe të pafund të shishes së bojës. Dëshpërimi e kishte kapur krejt dhe nuk mund të ishte ndryshe.

Pas kësaj, ai ishte takuar me ish pensionistin Bäier në park, nën hijen e gështenjës së vjetër. Fytyra e Baierit ishte zbehur disi, po mjekrën e kishte rruar me

kujdes, ndërsa këpucët i kishte pastruar për mrekulli. Johan Shtrausi deshi t'i propozojë Baierit për të ngrënë atë që i kishte pregatitur fshehurazi, po nuk i erdhi mbarë t'i thoshte: «Herr Baier, merreni këtë simite!»

Po sidoqoftë, Baieri nuk do ta merrte.

Ditën e tretë, plaku Baier nuk erdhi. Ai ishte shtrirë në dyshek dhe kollitej. Në kohën e drekës u ngrit e shkoi në një dyqan dhe la peng dy gjërat e tij të vetme: orën e vjetër dhe për më tepër flautin edhe më të vjetër. Ai do të marrë pak të holla, do t'i prishi ato dhe pastaj do të shtrihet në shtrat e do të vdesë. Ai vendosi kështu, sepse nuk pranonte të kërkonte lëmoshë.

Johan Shtrausi mori kurajo, zbriti në vendin ku e ëma mbante ushqimet, gjeti atje një gjysmë buke dhe u drejtua te Baieri. Po ai nuk e mori bukën.

— Ku e ke marrë? — e pyeti ai.

— Jua dërgon mamaja, — ju përgjegj Johan Shtrausi.

— Mos më gjënjesh?

— Gënjej, — ju përgjegj Johani, — unë e mora vetë atje ku mban ushqimet mamaja.

— Atëhere shpejt shko e ktheja... — i tha ish pensionisti Baier. — Si s'ke turp! — dhe shtoi: — Kur të dalësh nga shkolla, eja këtu dhe unë do të tregoj si do të jetë jeta kur të rritesh.

Zemra e Johan Shtrausit u ndez flakë. Dëshira për të ndihmuar mikun e përvëlonte si zjarr dhe ja, ai mendoi diçka fare të thjeshtë. Megjithëse fjala «mendoi» këtu nuk hyn, ky mendim atij i erdhi vetë, ashtu sikurse pas shiut del një rreze dielli, dhe pas natës vjen dita. Të këtilla mendime vijnë befas dhe ndriçojnë rrugën e njeriut. Kjo ndodh ngandonjëherë për shu: në arësye të thjeshta. Në këtë rast si shkak shërbeu ardhja e dy delegacioneve të reja në kampin e fëmijëve «Ernest Telman» — delegacionet e pionierëve të Kinës dhe të pionierëve të Çekosllovakisë. Këtë Johan Shtrausi e dëgjoi me radio dhe zemra e tij zuri të rrihte me vull. Ndërsa zgjidhja erdhi natën vonë, në kohën kur të gjithë njerëzit rreth

e qark po çlodheshin në qetësi dhe vetëm Johanit nuk i flihej.

Në mes të natës, Johan Shtrausi u ngrit dhe doli jashtë.

Berlini Perëndimor është një qytet i madh me shumë zhurmë ditën e natën. Djali dridhej i tëri. Nata të merrte frymën me nxehtësinë e gushtit, qielli ishte mbushur plot me yje. Lëviznin automobilët e gjatë dhe të bukur amerikanë, në rrugët e gjera ndiçonin qartë llambat e bardha elektrike, ndërsa në rrugët e vogla e të këqija një dritë e zbetë ndriçonte plehrat, që ende nuk ishin pastruar. Rrugëve kalonin policët duke ngritur lart topuzet, ndërsa nën tokë gjëmonin trenat. Johan Shtrausi ecte e ecte. Më në fund në mëngjez, duke kaluar territorin e sektorit perëndimor, arriti aty ku dëshironte, deri në liqenin e bukur, i cili praronte me një dritë të argjentë. Përgjatë liqenit ngriheshin një radhë barakash të bardha.

Rreth liqenit fëshfërinte një imshite pylli, ndërsa larg këndonin bilbilat. Këtë ne po e tregojmë për ju, o lexues, sepse Johan Shtrausi as që donte të dinte për ligjërimin e bilbilit. I vetmi zog që i pëlqente, ishte kanarina e zonjës plakë Garb, e cila qukitte kokrat e drithit që nga dora dhe që dinte të cicëronte një këngë mirënjohëse... Asnjëri nuk e ruante derën e kampit dhe Johan Shtrausi hyri te porta dhe mori rrugën përmes plepave drejt liqenit. Plepat fëshfërinin, në mugun para agimit degët e pemëve dukeshin sikur ishin mbuluar me një pëlhurë merimange, era e lehtë e natës i lëvizte ato dhe Johan Shtrausi përnjëherë filloi të pikëllohet. Ai ishte ende një djalë i vogël dhe po e ndjente veten krejt të vetmuar në botën e kësaj nate.

Këtu ai vuri re një fron me mbështetëse, u ul në të dhe sakaq e zuri gjumi. Pa ëndërr sikur rrinte me plakun Baier në park, nën hijen e gështenjës, dhe të dy pinin qumësht dhe hanin bukë të bardhë. Të themi të drejtën, heroin tonë, në udhëtimet e tij të natës, e kishte marrë uria shumë. Po kjo nuk e pengonte ëndërrën të ishte shumë e bukur. Gështenja fëshfërinte dhe plaku Baier nxori flautin dhe filloi t'i binte.

Te pionierët e Vulgeidit ra buria e mëngjezit. Fëmi-jët e gjetën Johan Shtrausin tek po flinte, dielli i ndritte në fytyrë. Kur e pyetën se ç'donte, ai ju pëgjegj:

— Plaku Baier ka vuajur shumë, ai është njeri i mrekullueshëm, atij nuk duhej t'ja hiqnin...

— Çfarë? — e pyetën pionierët dhe, a e besoni, në mes tyre ndodhej një kinez me një xhakëtë blu dhe me një shami të kuqe pionieri.

— Ai ka nevojë për bukë, — vazhdoi Johan Shtrausi. — Ai po dergjet i shtrirë në shtrat. Është ai, i cili ka qenë në Brazil dhe në Peru... Dhe ka luftuar në barikada. Ndërsa tani s'ka se ç'të hajë..

Asnjë nga pionierët nuk dinte se ç'duhej bërë për të dalë nga kjo gjëndje, edhe vetë Johan Shtrausi nuk e dinte. Po megjithatë, pavarësisht nëse ky çast ishte i rëndësishëm dhe vendimtar, ai filloi të pyeste kinezin, a kishte pulla kineze.

— A e ke ti atë të gjelbërën, me diell? — e pyeti atë Johan Shtrausi.

— Nuk kuptoj, — i tha kinezi.

— Shiko, ja ku është dielli, — ju përgjegj Johani, — e shikon atje, përsipër?...

Kinezi i vogël vuri buzën në gaz me mirësjellje, dhe të gjithë ishin shumë të turbulluar. Në të vërtetë, çfarë ka të përbashkët buka me pullën e gjelbër me diell dhe ç'është ky fëmijë i çuditshëm?!

Pastaj Johanin e ftuan të pinte çaj dhe të hante bukë, dhe e bënë mirë. Gjë më të mirë nuk mund të bënin...

Ai u ul në një dhomë të madhe, ku kishte një tryezë, dy karrige, një divan dhe një banak mbi të cilën kishte flamurë të kuq.

Me Johanin po bisedonte një djalë me sy bojëqielli. Sytë e Johanit ishin aq të thellë dhe të ndritshëm, sa që dukej se nëpërmjet tyre, si nëpërmjet një dritareje, mund të shikoje gjithçka që ndodhte në shpirtin e tij.

— Prej nga je ti? — e pyeti djali Johanin.

— Prej Vedingu, — ju përgjegj Johani. — Po ju prej nga jeni?

— Unë jam prej këtu, — tha djali.

— Ju, pra, qenkit si president i «republikës së femijëve?».

— Edhe kështu mund të jetë... A të pëlqen simitja?

— Më pëlqen, — tha Johani, po i erdhi turp: ju kujtua plaku Baier.

— Zoti president, — tha ai duke marrë kurajo, po «presidenti» ja ndërpreu fjalën.

— A, jo, — tha ai, — ti mos më thirr «zoti president»...

Pastaj ata biseduan dhe sqaruan gjithçka. Ata folën edhe për qumështin me simite, edhe për transportimin e kafesë nga plaku Baier prej ishullit Java deri në Hamburg, edhe për luftën e tij nëpër barikadat në Berlin, edhe për kampin e përqëndrimit ku kishte ndenjur Baieri, edhe për shitjen e flautit.

— Po pse erdhe këtu te ne? — e pyeti djali me sy të thellë dhe të ndritshëm. Po nuk priti përgjigje.

— Në orën dymbëdhjetë do të bëhet mbledhja e pionierëve, — tha ai. — Shpërndani rendin e ditës. Lutemi të paraqiteni në kohën e duhur. — Kurse Johan Shtrausin e vuri të flerë në një kanape.

Kur agrepi i madh i sahatit ra përmbi atë të voglin. në numurin dymbëdhjetë, u hapën dyert dhe anëtarët e mbledhjes hynë në dhomë. Ata ishin pesë veta: Jan Gunteri nga Lajpcigu, Moimir Trestiku nga Praga, Alberto Malaparti nga Padova, vajza e vogël Hi Sjao nga Hanjhou dhe Jadviga Zamoiska nga Lodci.

Këta ishin anëtarët e mbledhjes, po ata ende nuk dinin t'i jepnin vetes një pamje serioze. Djali me sy bojëqielli vuri gishtin te buzët dhe tha:

— Qetësi! Do ta zgjoni mikun tonë.

Po megjithatë, ai prapëseprapë u zgjua. Këtë ja ngarkuan vajzës kineze Hi Sjao, e cila i ra me një shami mëndafshi lehtas në fyt Johanit.

— Ju prezantoj Johan Shtrausin nga Berlini Përrëndimor, nga lagja punëtore e Vedingut... — tha «pre-

sidenti». — Ai dëshiron të na thotë diçka... apo jo, Johan?

— Po, — belbëzoi Johani, duke ju dredhur buzët. Po ai nuk ishte aspak frikacak...

Po mbledhja e pionierëvet prapëseprapë mbledhje pionierësh është... Ndërsa Johan Shtrausi ynë është një djalë trim. Ju patët rastin të bindeni për këtë. Dhe ja, ai foli:

— Kur ju ndodh t'i rrëxoni kapelen një të madhi, çfarë ju bën ai? Ju zë për veshi. Po nëqoftëse ai nuk e bën këtë, atëhere çfarë njeriu është ai? Është njeri i mirë! Kurse ata ja prenë pensionin dhe ja hoqën nga goja edhe simiten e fundit.

— Se si i fute të gjitha në një thes, — ja pati një nga anëtarët e mbledhjes.

Po pionierët e kuptuan menjëherë thelbin e kësaj ligjërate të ngatërruar për kapelen dhe simitet dhe një zëri vendosën t'i vinë në ndihmë Baierit.

— Ne çdo ditë do t'i çojmë atij për të ngrënë, — tha Jadviga Zamojska, — po për këtë njeri nuk mjaftojnë vetëm simitet dhe qumështi... këtij njeriu i duhet diçka tjetër, diçka më e mirë.

Jadviga Zamojska e dinte se çfarë i duhej Baierit, po si mund ta thoshte atë në mbledhjen e pionierit? Më e mira nga të gjitha do të ishte sikur plaku Baier të merrte çdo ditë një kotoletë të madhe të pjekur me sallatë. S'do të ishte keq t'i jepje edhe një supë me domate ose me karrota të grira.

— Ai do edhe birrë, — ja pat si me ndrojtje Johan Shtrausi.

— Birra është një pije me shpërto, — belbëzoi Jan Gunteri, kryetari i komisionit shëndetësor në «republikën e fëmijëvet». — A nuk e di ti se alkooli e dëmton shëndetin?

Nuk e zgjatën më fjalën për birrën!

— Ne morëm me vete dhjetë kuti orizi, këtu ne ato nuk i hamë, — tha Hi Siao. — Ne na pëlqen më shumë supa, në të cilën notojnë karavidhet.

Të gjithë u çuditën, sepse asnjëri nuk e dinte se

ç'ishte supa me karavidhe, po pastaj e kuptuan se Hi Sjao e kishte fjalën për supën me kërpudha. Sa u sqarua kjo çështje, Johan Shtrausi arriti t'i marri Moimir Trestikut nga Praga një pullë shumë të bukur, me figurën e një ushtari me helmetë.

Pastaj e mori fjalën «presidenti» me sy bojëqielli. — Duhet, — tha ai, — ta shtrojmë drejt çështjen dhe të merremi me një punë më të rëndësishme. Mos vallë Baieri është i vetmi njeri në Gjermaninë Perëndimore, që ju pre pensioni? Kjo u ka ndodhur të gjithëve ish të burgosurve të kampit të përqëndrimit, dhe të gjithë viktimave të nazizmit.

Pastaj vazhdoi diskutimi, i cili mbaroi me rezolucionin që vijon: «Këshilli i kampit të pionierëvet «Ernest Telman», në mbledhjen e tij të jashtëzakonshme vendosi: të ndihmojë menjëherë viktimat e nazizmit, që jetojnë në Berlinin Perëndimor.

Duke shpërndarë Bashkimin e ish të burgosurve politikë dhe antifashistë, qeveria e Adenaurit ka treguar se ajo ndjek gjurmët e paraardhësve të saj hitlerianë. Ne, luftëtarët e rinj për paqen deklarojmë se do të bëjmë gjithçka për të lehtësuar fatin e rëndë të këtyre luftëtarëve të papërkulur për një të ardhme më të mirë të njerëzimit. Shokë, ne nuk do të lejojmë që ju të vdisni uriel!»

Dhe ja, fushata e ndihmës, e cila do të mbetet për një kohë të gjatë në mendjen e njerëzvet, filloi me një vrull të madh. Plani për organizimin e saj ishte përpunuar nga Jan Gunteri, ndërsa vënja e tij në jetë i ishte ngarkuar kompanisë «Gjergj Dimitrov».

Kompania «Gjergj Dimitrov» brenda tri orëve mbledhi adresat e të gjithë atyre që vuanin dhe krijoi tri stafeta pionierësh, të cilat ishin ngarkuar të siguronin dorëzimin e shpejtë dhe të njëkohshëm të pakove. Pionierët e kompanisë «Gjergj Dimitrov» ishin urdhëruar të hiqnin përkohësisht shamitë e kuqe, për t'u ruajtur nga gjërat e papëlqyera, që mund t'u shkaktonte policia e Berlinit Perëndimor.

Një mbledhje e shkurtër e kompanisë, që ju kush-

tua çështjes së heqjes së shamive, ngjalli papritur zemërim. Jan Gunteri mori fjalën me një zë të ulët basi, dhe pionierët dëgjuan me vëmendje:

— Ju propozoj antarëve të kompanisë «Gjergj Dimitrov» që përkohësisht shamitë e kuqe t'i lënë në kamp. Kujtoj se është e qartë përse e bëjmë këtë!

Po nuk e kishin të gjithë të qartë. Pas fjalëve të Jan Gunterit, një qetësi e madhe mbuloi mbledhjen. Kjo ishte një qetësi përpara stuhisë. Disa pionierë ulën kokën, duke shikuar me dashuri shamitë e tyre, gish-tat e tyre të tronditur lëmonin pëlhurën e kuqe. Ishte vështirë të prisje që pionierët të hiqnin shamitë të qetë. Ja se si ka ngandonjëherë situata, që duken si të thjeshta, po befaf bëhen shumë të ngatërruara.

Jan Gunteri u çua në këmbë:

— U lutemi gjithë anëtarëve të kompanisë «Gjergj Dimitrov» të vendosin shamitë e tyre të pionierit mbi tryezën e kryetarit.

Qetësia mbuloi sallën. Te «presidenti» ishin drejtuar disa dhjetra sy të mbushur plot zemërim dhe në të njëjtën kohë të vendosur.

Pastaj u ngrit një pionier me balluke të lëshuara ballit dhe deklaroi:

— Unë shaminë time nuk e jap!

Të gjithë e duartrokitën.

«Presidenti» u zemërua. Po, kur ai kërkoi fjalën, mbledhja u qetësua pak. Të gjithë e dinin se ai kurrë nuk fliste kot.

— Unë mendoj, — tha «presidenti», — se mosmarrëveshjet që lindën këtu nuk kanë asnjë bazë, pionierët e kompanisë «Gjergj Dimitrov» mund t'i ruajnë shamitë e tyre, duke mos ja dhënë asnjëri, po duhet që ato të vendosen në një vend të sigurtë, në xhepin nga ana e zëmrës. Kryesorja është që ato mos të mbahen në qafë, që ato mos t'i fërfërijë era e Gjermanisë Perëndimore. Kjo bëhet për të larguar rreziqet, po në zëmër ato mund të mbahen.

Po, kjo është një çështje tjetër!..

Shamitë e kuqe u palosën dhe u vendosën në xhepin

nga ana e zemrës. Për të kujtuar këtë, e gjithë fushata e ndihmës mori emrin «Fushata e shamisë së kuqe».

Atë ditë që filloi fushata, në kamp, në një vend të dukshëm, u vu distinktivi i kompanisë «Gjergj Dimitrov», ndërsa orkestra e pionierëve luajti «Këngën e gëzimit-të Bethovenit, «Marsejezën» dhe «Internacionalen».

Johan Shtrausit ju dorëzua në mënyrë solemne distinktivi i pionierit, mbi të cilin flakëronte flamuri i kuq.

Po atë mbrëmje ai u kthye në shtëpi te prindërit e tij. Sa i lumtur ishte ai tani, që arriti të sjellë pakon në derën e Baierit, të cilën e kishte marrë nga «Republika e fëmijëve». Ai i ra ziles për një kohë të gjatë.

Johani priste në këndin e errët të shkallëve, të shikonte se ç'do të bënte Baieri. Plaku për një çast qëndroi i habitur, po u kthye në dhomë për të marrë syzet. Pastaj ai lexoi adresën: «Eduard Baierit, sho-kut dhe luftëtarit, kompania «Gjergj Dimitrov» — dhe qëndroi te dera me pakon në dorë.

Johan Shtrausi, i kënaqur, zbriti me vrap shkallët dhe shkoi në shtëpi, ku e priste dënimi i ashpër i prindërve.

Vetëm në mëngjez heret Johani pati mundësi të shkante te plaku Baier dhe mbeti shumë i habitur, kur pa se pakoja nuk ishte prekur fare. Baieri nuk kishte marrë asgjë: as çokollata, as qumësht, as bis-kota.

— Kush i mblodhi këto? — pyeti Baieri.

— Unë, jo, — tha Johan Shtrausi. — Ku t'i gjeja unë këto? Mos kujtoni se jua solla unë?...

— Po, — ju përgjegj Baieri, — unë kështu mendoj.

— Jo, herr Baier, as mos e mendoni këtë... Ju vazhdoni gjithmonë të mendoni sikur të mos më njih-nit fare. — Dhe shtoi: — Shikoni, ju s'e keni prekur fare...

— Nga e di ti se unë nuk e kam prekur fare? — tha me inat Baieri. — Nëqoftëse nuk e ke sjellë ti pakon, atëhere nuk mund ta dish se ç'ka brenda ajo.

«Ja se si duhet njeriu ta përmbajë gjuhën», — mendoj Johani.

Pastaj Johani i tha plakut të gjithë të vërtetën dhe i tregoi atij distinktivin e pionierëve me flakë të kuqe. Eduard Baieri e vështrroi distinktivin për një kohë të gjatë dhe më në fund e vuri në kraharonin e tij. Pastaj ja ktheu Johan Shtrausit dhe tha:

— Tani ti duhet të më thërrasësh «shok»...

— Si kështu shok? — e pyeti Johan Shtrausi. Po menjëherë e kuptoi se ku qëndronte çështja, dhe tha: — Shoku Baier, ne ju lutemi shumë të merrni këtë çokollatë. Ne ju lutemi shumë. shoku Baier, kini mirësinë...

Dikush i ra ziles. Ishte postjeri Greif. Ai nuk solli asgjë. Ai u kthye vetëm sa për të parë plakun Baier. Po Eduard Baieri bëri një kafe me qumësht, i vuri një filxhan përpara postierit bashkë me disa biskota, dhe filluan të dy të pinë kafënë me kënaqësi.

Greifi tha:

— Ju falemnderit, Baier, nuk mundem më... Ja një gjë e mrekullueshme! Po vija sot në mëngjez te plaku Rainer për të dërguar një letër; ai po hante një supë me oriz. «A doni, Greif, një supë orizi?..» Dola nga shtëpia e Rainerit, kur më thërret plaku Bllank... Edhe ky më gostiti... Erdha te ju, edhe ju më gostitët... Ç'gjë e mrekullueshme!.. Njerëzit po mbarojnë paratë e tyre të fundit, kurse unë, shejtani plak, mbush barkun te ata!

— Dëgjoni, Greif, shokët e rinj nuk na lënë të vdesim urie, — ju përgjegj plaku Baier.

Këtu bisedimi, sipas mendimit të postierit, po merrte ngjyrë politike dhe Greifi deshi të largohet. Ngandonjëherë njeriu e fillon bisedën me supën e orizit, pastaj kushedi se ku mund ta mbarojë.

— Flitet, — tha ai, — se maksimumi i presionit barometrik po drejtohet nga Evropa Lindore, nëpër Evropën Qendrore dhe më tej nga perëndimi.. dhe se koha do të jetë e mirë.

— Pse interesoheni gjithmonë për kohën? — ju përgjegj Baieri. — Kanë më rëndësi njerëzit, dhe jo koha.

PËRMBAJTJA E LENDEË

	Faqe
Një copë mishi	3
Renegati	12
Nënë e bijë	29
Pionieri Ti	39
Karrocëzat e vogla që kushtojnë nga pesë solda	43
Nuk harrojmë	47
Klimë e re	58
Andreshkoja	64
Në shtëpinë tonë ishin kryengritësit	71
Fëmijët e Parmës	78
Në ditët e para të Tetorit	83
Shëtitja	88
Nënë e bijë	91
Guri i nxehtë	109
Fushata e shamisë së kuqe	114

LIBRARI E SHITJE
... ..

53763

(17)